

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I GJASHTË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

WORKS

VI

Editorial board:

Ali Aliu, editor
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I GJASHTË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës

Rexhep Ismajli

Eqrem Basha

Sabri Hamiti

Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013



LITARI I ANK'THIT

poezi e zgjedhur
përgatitur nga Bashkim Kuçuku,
Toena, Tiranë, 2002

MACA E ZEZË

Në udhëtimin tim
një mace e zezë më ndjek

e shpirti më thotë
në gjysmë rruge ke për të mbetur

e kënga më thotë
kurrë s'do t'më këndosh me zë

e drita më thotë
i verbëri i verbër ka mbetur

e ëndrra më thotë
më kërkoi në zhgjendërr

po eja e thuaje atë fjalë
kur s'di kë dashuron apo urren

eja e besoji fytyrës në pasqyrë

një macë e zezë më ndjek
në udhëtimin tim

orën e fatit ajo dikton

ME PERËNDI TË FLAS

A DO TË KETË KOHË

Fati im në duar të mia
dhe vdekja ime në duar të mia
në duar të kujt qeniesia ime
kam shpatën dhe frerët në duar
përtej sime frymë atë le të më shpjerë

a do të ketë kohë

KUR DO TË FLASËSH O ALI PODRIMJA

Në shuplakë fiket ylli
na shikon në sy dhe përbihesh
shpinën pa na kthyer asnjëherë o Ali Podrimja

Rri atje nën qiellin e ftohtë dhe hesht me vjet
beson ende
në njeri

E emri të falsifikohet
mbiemri nënshkrimi datëlindja
emri i nënës i babait i vendlindjes i të parit

përrallat fëmijërore vallet lodrat
heronjtë këngët vajet kremtet

Mbi gjuhën tënde të lashtë mbi fisin
shqirren
dhe derdhen përrrenj të zinj

E ti hesht o Ali Podrimja
beson ende
në njeri

Në hone të errëta në bodrume mesjetare
elaborate emërtime të çuditshme rrënime
mallkime

lehje ndjekje kyçje
gjueti e egër

Ndizen fiken qirinj erë temjani pikojnë fjalët
trupat rezervati
nën sjetull të fatit dheun marrin fëmijët
Gruaja end e shkreh pëlhurën
në Kullë letre

Mbi kokë zgjatet hija sorrat korbat qiellit
kaçurrelat e verdhë kreh
me një grusht dhé në gji
nisesht larg larg

Në Evropën mondane je *albanais*
arbëresh në Itali në Greqi *arvanitas*
arnaut në Turqi hamdurlah
në Amerikë mish konservash
e asgjë tjetër
e asgjë tjetër

kushedi sa gjuhë flet Zoti yt

E ti hesht o Ali Podrimja
beson ende
në njeri

por por
kur do të flasësh o burrë i dheut
apo më parë *dubet të lindësh*

Kulmin tënd ç'e mbulojnë myshqet

Ç'PO NDODH ME MUA

Sime bijë, Donikës

Unë kur këndoj
jeta ime është Pse

unë kur qaj
jeta ime është Pse

unë kur diç kërkoj
jeta ime është Pse

mbi vete kur dorën ngre
jeta ime prapë është Pse

zot o djall
ç'po ndodh me mua

KUR RRJEDH

Unë kur rrjedh
koha ime bjerr

n'gishtat e mi
bie

po s'theret

zë thua
në një asht

e n'syrin tim
mbyllet

po s'mbytet

unë kur rrjedh
vetveten vjell

në pafundësi

PA FOLJE

Dhe prapë vetëm

nën këtë qiell
mbi këtë planet t'zgiebosur

po ky litar
rreth kokës

dhe prapë vetëm

larg botës
afër vetes

diku nën këtë qiell
diku mbi këtë planet
me gurin n'shuplakë

dhe prapë vetëm
rreth flakës

GRI

Kur të vdes
Varrosmëni ku të doni
Stom një burimi
apo nën sjetull të një Mali
Vetëm ku flitet *Shqipja*
Me perëndi të flas
edhe përsëvdekuri
tërë kohën e vdekur

NUK PRANOJ SE KAM JETUAR

po qe se u frikësova të zgjoj rrugën e verbërt
po qe se nuk dita ta kurdis orën në Kullë
po qe se nën hijen time strehohen ujq gjarpërinj
po qe se barin e keq nuk e herra para derës
po qe se nuk dita të lindë e të vdes siç mësova
po qe se dheut brodha dele e zezë
po qe se lë varre e turp
po qe se nuk guxova ta them fjalën
nuk pranoj se kam jetuar

1970

KUSHEDI PREJ KAH

DËFTORE

Kushedi prej kah kish ardhur prej cilës kohë kish pikur i paNjohuri
me një kokë në shpatë
e me një sy qorr
vorr

si mund të jetohet këtu Kish pas pyetur
po si jo Madhëri K'in thënë Ata
po guri
unur K'in shtuar Ata me brincë në duar

dhe guri sa çel e mshel sytë ish çarë nga një rrënjë e padukshme
shtatë dryna shtatë net e shtatë ditë s'in çelur as mbyllur në Kullë
po uji kah rrjedh uji
uji Madhëri K'in qeshur Ata po uji rrit këtë guri mbi kokën mur

i paNjohuri konak e më konak ish endur
me një kokë në shpatë
e më një sy qorr
vorr

një natë me shi kish pas pyetur pastaj për zjarr

s'dimë ç'është zjarri K'in thënë Ata

dhe kish vetëtuar në male
kish djegur
në fusha

kushedi prej kah prej cilit det kish fryrë një stuhi atëherë
shi kish rënë e toka çarë prej thatësisë
copë e grimë bërë qielli prej shpatave prej thundrave
e shi kish rënë ditë e natë

të paNjohurin thonë se juga e kish kapëridirë
thonë se veriu gjurmët ia kish fshirë
një mot me pjalm ia kish behur një udhëtar i çalë me një gomar

prej çfarë sëmundjesh vuajnë
çfarë emra u ngjesin fëmijëve kafshëve
kish pas pyetur gjithçka kish pas pyetur o zot

në një kohë të pakohë Ata i k'in treguar malet

atje ka gjarpërinj Kish pas thënë udhëtari
ka Madhëri po nuk na hanë K'in thënë Ata
po ç'bëni atje lart Kish pas pyetur pastaj udhëtari
rrimë me zogj rrimë me ujë K'in thënë Ata

e te pragu i Kullës kish plasur gomari nga marazi

udhëtarin e çuditshëm
e k'in kërkuar në male e k'in kërkuar në fusha
sot as mot s'e k'in gjetur
as zjarri s'ish shuar ndër prita

pastaj kish ardhur sulltani
oh vdekje si të mban Kulla brendë
sulltani kish shkuar kish ardhur krali
krali kish shkuar kish ardhur i biri i sulltanit

kalit i k'in dhënë emër e dritën e syrit harruar medet

kohët prapë 'in ndërruar në gurë e plakur në mur
dhe dritaret 'in mbyllur
e hapur
në një përrallë

një ditë për një ditë
Ata s'in ngjitur në male s'k'in rënë në fusha
në sy qiellin e k'in fshehur
dheun ndër dhëmbë

pas shumë e shumë vitesh kish pas ardhur një tregtar
gjithçka kish pas shitur e blerë ai i gJORë i padORë
kish pas pyetur pastaj për iks sëmundje për ëndrra emra

Ata k'in qeshur k'in luajtur Rrotën e motmotit

dhe prapë tërmete k'in ndodhur
e mullinjtë
e bluar

k'in kaluar ditë k'in kaluar vite k'in kaluar shekuj
e një verë
një Djalosh me fyell kish çuar Gjakun
peshë kish çuar valën

Brigjet në dorë ju paça

ASKUJT S'I FALEM SA FORCËS SATE

I. GURI

1. (Pesha jote më tërheq kah toka)

Çdo gjë është e përkryer te ti
dhe askujt s'i falem
sa forcës sate

kërkon Hapësirë vazhdimisht kërkon Hapësirë
unë të lëshoj vend hapa ndërroj
pas çdo pushtimi tënd

pesha jote më tërheq kah Toka-drejtpehimi
larg halave-e-valëve-e-fjalëve
që kryet ma kërkojnë

unë sa herë lëviz dorën
në një planet tjetër bie ti
dhe pa frikë hyj në jetë e sillem në Rreth

te ti çdo gjë është e pathënë
kaq e thëna nëpër hënë
gur që fishkëllon-ndriçon cektirave-thellësive

bie në gjunj para teje
dhe lutem për forcën tënde
që Botën mban në shuplakë

2. (Të jesh ti)

Re te Unë
Unë durimin ta fala

gjymtyrët e mia
janë trajtat e tua të derdhura nëpër Histori

re te Unë
a do të ngre Kullë prej teje Urë

ernave në mejdan
a do t'u dal a do t'i turpëroj

prezenti im a do të jesh ti
apo tkurrja ime do të më zbrazë nga gjithçka jotja

re te Unë
Unë heshtjen e mësova të flasë

ja Promete
zjarrin ta kthejnë kopilat

3. (Assesi të mësoj Fshehtësinë)

Vë veshin në botën tënde të çuditshme
çaste epike
në Erën e kozmetikës

vë veshin

kuisjen e bravave ernave të vdekura dëgjoj
shirat e verdha
vërshimat

pastaj nxjerr Shpatën nga kllëfi i kohërave
Formën tënde më të re
fitoj

shaloj at e shaloj shpat

në lindje në perëndim
vida e vida
O At

vë veshin

po assesi të mësoj Fshehtësinë
Fshehtësinë assesi

të mësoj

se ku
se ku gjithë ai durim te ti
guri im

II. GURI

1. (Pres me ditë tres përditë)

Hedh gurin në hapësirë
Sizifi plak me mund

prapë e hedh dhe e hedh
valë e më valë e i gjallë

pres me ditë tres përditë
hapësirë e hapësirë kërkon

rrënjë lëshon në mundësi
në pamundësi erna tremb

hedh gurin në hapësirë
hapësirë çpon e çpon

kohëra e kohëra përgjak
dhe mund Sizifin plak

2. (Ç'guron guri)

Ç'guron guri në gurinë
gur guri ndër gurë më i gurti

gur i gurëzuar pranë gurit
gurth i guruar rreth gurit

guron guri në gurë gurësh
guro guroje gurin në gurinë

ç'gur pranë gurit gur guri
vrimë e parë e fyellit tim

3. (Nga ëndrrat nga ujërat hapësirën ta ruaj)

Nga ëndrrat nga ujërat
hapësirën ta ruaj

nëpër duar më humb
nën këmbë më rrëshqet

më bart e më bart një breshkë
n'udhëkryq më le

ashtin ta fal
syrin tim të madh

thonjtë m'i le në fytyrë
shpirtin ma shprish

dhe prapë kokën time
mbjell për Farë

nga ujërat nga ëndrrat
ta ruaj hapësirën

4. (Merreni këtë gur)

Merreni këtë gur e hidheni
ku të doni

nëse dëshironi

përtej fillimit tim e fisit
përtej nëntë plagëve të Gjergj Elez Alisë

gozhdoni po deshët
Muron

merreni këtë gur

pagëzoni ose lëreni pa emër
kohën ndërroja klimën

pa tokë lëreni pa qiell

merreni këtë gur e hidheni
ku të doni

fortësia e tij na përjetëson

III. GURI

1. (E guri im rrokulliset)

A do të më pranojë gjaku im
apo duhet braktisur

në botë kërpudhash kthyer

bien mbretërit një pas një
e guri im rrokulliset në pakufi

boshësisë fishkëllen fishkëllen e kafshon
njeri apo mi më qëllon

a do të më pranojë gjaku im
apo duhet braktisur

në botë kërpudhash kthyer

KOHA E GURIT

Te bedenat e tua
mbretër e sulltanë
ushtritë lanë

e kohërat sytë
njëra-tjetrës ia nxorrën
me eshtrat tona

te bedenat e tua
emrat tanë
ngrihen në këmbë

e në kohën e karafilave
koha e gurit
fillon

TEKSTI YNË

Guri im ka zënë të humbë peshë
për Mur as për Urë
s'është

era më e lehtë
vendin ia ndërron formën ngjyrën tingullin

sëmundja e gurit tim
mos na u bë sëmundje edhe e tokës

ditenatë rri mbi kokën e tij të gungaftë
prej ëndrrave prej pagjumësisë

temperatura e paNjohur
hijen jetike ia shemb
krenarinë

kot po flas qe sa kohë: teksti ynë sintaksë e fortë

MBRETI IM I VDEKUR DIOKLECIAN

Kur të zgjoj
thellë në lashtësi zë nxjerr
guri im fiton peshë fiton hapësirë

mbreti im i *vdekur* Dioklecian

ballkani nuk m'i ngjan pyllit
deti ma kthen liburnën dashurinë
m'i kthen qytetet e humbura ëndrrat

nuk na ndan vdekja plaku im
na ndan harrimi koha
gjahu i egër i namur

të ishe do t'ia qitnim kulmin kullës
në gjysmë të rrugës nuk do të më zinte terri
as kokëçarje s'do të kisha me piratët me romakët

kur të zgjoj
lulon dhembja
dhe barin e keq herr pas derës

mbreti im i vdekur Dioklecian

A DO TA SHOH SHKODRËN

Për pak hyra në histori

Kisha edhe një copë udhë
edhe pakëz frymë
të shoh Shkodrën

Sa nuk foli Guri
Se në fund të Pusit
dritë e verbër e Çelësit

Mbi kulme mbi shpirtëra mbi ëndrra
Uji i Madh
Pasqyrë e derdhur Drinia

Male fusha ngujuar
Sorrasorrani
ma k'in qitur qarkun

Dhe qielli oh qielli
Vrimë e Zezë
gëlltit gëlltit gëlltit

A do ta shoh Shkodrën

KËNGA E NGRYSUR

Kur ka zi Kosova
Zjarrmia e mundon
edhe gurin

Nën qiellin e zymtë
Gji një nënë i jep
Fëmijës së vdekur

Dhe nga syri im i shqyer
rigon rigon
rigon

Oh zot

1998

VDEKJA E KULLAVE

Plasur kish Guri
te fundi i Dheut

Bëni pakëz zhurmë
A jemi gjallë

Tokë as qiell
nuk 'in parë më

Tej mortjes
i kish bartur

një zog mitik

Gjakovë, 24.12.1999

DROJA

Vajta në gjah

gjuajtja e gjuajtja
etje e etje shuajtja

murova një ëndërr
mbretëri e mbretëri mbretërova

vajta në gjah

lashë asht lashë lëkurë
vura një gur në Kullë

në Kullë mbylla
një yll

ruajna zot
në më tradhtoftë guri

SHQIPTARËT

Zoti nuk u kishte falur as bar
vetëm gjarpërinj
e gurë

por ata kishin diçka
që kurrë s'mund t'ua zbulojë i madhi
jetonin gjatë

dhe kur vdisnin
vdisnin
duke kënduar oi oi oi

te koka
u mbinte
nga një rrap çarë më dysh

Feldafing, 1992

PA TITULL

Më iku jeta
duke ma luajtur gurin

një djalë vajti më ag kushedi se ku
tjetri natës ia ndërron këmishën në bedena

gruaja përkund djepin e zbrazët
nën rreze të hënës aty në kodrinë
dhe shtrydh gjinjte

unë sillem me një sopatë rreth plepit të mbramë
te një mur i rrënuar palmuç bie hija ime

nga burim i largët
ujë me grushta sjell Kostandini

jeta se ç'më iku
pa ia parë kulmin shtëpisë

DRITARJA E HAPUR

E pastaj

Asgjë nuk ka lëvizur
Aty Guri
që nuk na lë ta bëjmë Arbërinë

Pak më tutje
Uji i Madh
dhe Syri i Gastartë që vezullon

E në fund

E në fund të fundit
Varka e Noes
Por nuk e shohim Bregun

Ulqin, korrik 1996

DITA QË MA KUJTON VDEKJEN

Është një ditë
Nuk ka asgjë nga ditët
Ngulitet si gozhdë
Dëgjon dënesët

Je një Gjergj Elez Ali
Kërkon të humburën
E plagë merr nga zotërat

Është një ditë
Vjen më fërflazë me ikje shtërgu
Me shpërthime të mëdha në kujtesë
E dridhmë

Ia pi lotin në sy një nëne

Nuk e përkthekon me jetë
As i bie kush te gjuri
Shkohon kohë e flitet
Si për Atlanditë e Krujë

Është një ditë
I pavdekshëm ta kujton
Nuk është as guri

Falemderës Lumi
Desh më turpëroi
Hija e vdekjes

Ulqianë, 29 shtator 2000

LIVADHI

Diku aty ishte shtëpia jonë
Muri i gjyshit dhe Plepi i babait
Hunjtë rreth hapësisë së kuqe

Diku aty zbritnim te Kroi i Dukagjinasve
Shuanim etjen
Bukë e kripë hanim me perënditë e Pashtrikut

Nën kosë rritet tash bari
Dhe mbledhim dhëmbët e derdhur të ujkut
në shtalbët
E Muri i gjyshit e Plepi i babait e Hunjtë
Lëvizin nëpër kujtime

Unë me duar në xhepa sosi ditën
Duke i rënë hapësisë së shturur
Dhe dëgjoj hingëllimën e egër të kuajve
të shkumuar
Deri natën vonë

Aty midis livadhit ku e kishim shtëpinë tonë

PAZARI I VDEKUR

Shqiptarët
nuk kanë zbritur
mbyt boshllëku e nxin në Vlorë

Dhe çirruni sa të doni
për 'i kore bukë Drinie
për 'i kokërr kripë Ulciniumi

Nuk kanë zbritur shqiptarët

A nuk ju rrëqeth boshllëku
fishkëllimë e tij vajtuese
farë e zezë

Dathur Zotin e pashë
Mbika fara dhe në Gur
Bubullimë qiejsh ata

Paska vdekur pazari
e gjithkund shqiptarët
Çative të zgjuara ngrin vreri mesjetar

Prishtinë, 1.10.1997

UDHA E PANJOHUR MË ÇON

KULLA

1. (Hap derën mbyll peizazhin)

Deri te Kulla ime
udha e panjohur më çon

hap derën mbyll peizazhin
lëshoj grilat ngjyrë gri rreth meje

nën kokë
vë Çelsin dhe Shpatën

dikund në mes meje e botës
tufa kullot ëndrrat

2. (Hija ime shëtiti pa mua)

Në asnjë arkë Fshehtësia

nëpër muret e humbura
hija ime më kërkon

ditë e natë natë e ditë
hija ime shetit pa mua

e në asnjë arkë Fshehtësia

balli im ngrihet e ngrihet
tufën mbulon në një Pyll

dikund në mes meje e botës

3. (Po guri im ç'ka)

Ndez llampën

po ç'ka guri im
që nuk zë vend

lëviz e lëviz
tokë as qiell s'e pranon

e një mbretëri
ndjek një mizë

po guri im ç'ka
që rri pezull mbi botë

GJUHA E NJERIUT TË GOZHDUAR NË SHKËMBË

POEMA E HESHTJES

(Emra ka harruar)

Kanë shkuar kanë ardhur
kanë ardhur kanë shkuar
Njerëzit me pisha në duar
heshtja emra ka harruar

(Në nofulla të një kohe)

S'di pse dhëmbët
m'i le në lëkurën time
kur më the se më do
kur të thashë se të dua

s'di pse

në mes nesh një mot
gjarpri krye qiti
shih në nofulla të një kohe
heshtjen tani përtypim

(Metafora e jetës sime)

Nëse s'flas
jeta ime s'ka qetësi
fjala ime bëhu Unë

heshtja të të mos shtypë
në gurë
mulliri

nëse s'flas
jeta ime s'ka qetësi

fjala ime bëhu Unë

plaga ime
le të marrë
frymë thellë

(Eci rrugës sime ajo më ndjek pas)

I flas më flet
njëri-tjetrin herrim
njëri-tjetrin mbjellim
eci rrugës sime
ajo më ndjek pas
te një krua pritën ma zë
ujin deri në pikë ma pi
ia shkel syrin një kënge të largët
ajo ma grabit pa e kënduar
ja zgjas dorën
s'e do e s'e do
shpëtimin tim

(Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë)

Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë
në majë të Olimpit zotin pshur
veshin e gurit shurdhon një kabanë e vdekshme
sytë gjarpri m'i kërkon edhe në ëndërr

kur dashurohem në fuqinë e rrufesë
jeta gjithfarë formash merr
mbi emrin tim shi bie e bie
dhe zogjtë harrojnë të kthehen në kohën tonë

(Si e harruam njerinë në fushë të bardhë)

Heshtja ka emër ka ngjyrën e vet
damarëve të saj kush bredh pa pishë në dorë
humb rrugën deri te emri i vet
ajo ka Kasaphanët Bunarët
ka Spitalet Çmenditë Kumbonaret
heshtja ka Kohërat Dashuritë
dhembjet ja zbulojnë syrin e fjetur
në fluturim zogjtë ja çokasin kokën e madhe
ditët vitet e shekujt i cicërojnë në vesh
në barkun e saj kurrë s'mejnë

klyshët

derrat

ujqit

qe sa kohë një kavall derdhet në gojën e një sfinksi
heshtja ka Shkallët e veta
nëpër to zbritur kanë Mbretër Gjeneralë të paemër
nëpër to ngjitur janë kasnecë
me këmbë të hekurta
me këmbë të drunjta
ruajna zot prej sëmundjeve të saj trashëguese
nga shurdhimi do të heqë shpirt një ditë
heshtja s'është vetëm e kaluar
s'është vetëm e ardhme
në këtë të bardhë njerinë vallë si e harruam

(Shi në një legjendë)

Po të hedh një gur në lumë
heshtja ka temperaturë

po të këndoj një këngë të moçme
heshtjen e mundon pagjumësia

po ta kërkoj veten në një lojë
heshtja ka dhembje koke

e shiu s'pushon e shiu s'pushon
në një legjendë sot as mot

(Shtat lëshon një lulkuq)

Heshtja ime është më e vjetër
se unë e më e fortë
se vdekja ime

ajo është pamundësia ime

heshtja kur flet
numëroj yjet
luaj me hije luaj me thika

e në fushë të bardhë
shtat lëshon
një lulkuq

se heshtja ime
ka peshën e gurit të mallkuar
dhe gjuhën e njeriut të gozhduar në shkëmb

(Një ditë)

Një ditë heshtja
do të më gjuajë
me eshtra të mia
ose do çmendem duke rrënuar

(Pas rënies pas ngjadhënjimit)

Lavdi djallit

lavdi zotit

LOJA E PAKRYER

EMRAT TANË

Herë nata
i merr nëpër këmbë
herë dita
i kërkon me pishë

BALADË PËR DHËMBIN E UJKUT

Kushedi kush e ngriti
e kujtim na la
atë dhëmb ujku

prej rrapllimës së tij
balli na luajti
e kulmet e varret

prej rrapllimës së tij
vallet tona
i trilluam

e rrahën erërat
e rrahën kohërat
dhe ushtritë

namët tona larg u ndien

dhe s'patëm kohë të vdesim
dhe s'patëm kohë
të jetojmë

kushedi kush e ngriti
e kujtim na la
atë dhëmb ujku

një ditë kur vraponim pas lumit të harlisur

një ditë për një ditë
kur vetëm humbëm
e na gjetën të paemrit

në gjumin e thellë të natës

LOJA E PAKRYER

A. Pashkut

Vras m'vrasin
askush s'varroset

pushkët kobzeza
në thumb ime kokë

sillem sillen
hidhem rrëzohen

askush triumfues

kalon luani i çartur
nuk frikësohem

vjen Njeriu nga larg
në skaj të Botës ik

vras m'vrasin
askush humbës

vetëm shumohem
shumohen

planeti bosh e kokat plot varre

A GJUHEN PËLLUMBAT

Pëllumbat a gjuben bre?

Ulem në rend të dytë
pse shoh më larg
e dëgjoj më mirë
pse kam zë më të fortë

Vetveten s'e ha nga mëria
as shtyhem me brryla
Më shlirë e kam se në rend të parë

Si gjuben pëllumbat bre?

Nga karrigia ime lëvizëse
për mrekulli mat kokat tullace
dhe barqet e fryra

Është rrenë e kulluar
se unë Ali Podrimja
jam qytetar i rendit të dytë
në Planetin Ka Ka

A gjuben pëllumbat bre?

Mos e dhashtë zoti
t'ulem në rend të parë
me gurë varresh
as t'i gjuaj pëllumbat

UNË DO TË KISHA ATDHE

Të kanë rrejtur
se je më i bukuri
ndër trimat më trimi
më i vjetri ndër të moçmit

T'jetër kush do të ishe

Të kanë rrejtur
se nënë ke ulkonjën
krahët e orakullit
se pi ujë në gurra të Drinit

T'jetër kush do të ishe

Të kanë rrejtur
se je Zot i Dheut
se je Zjarr i Fshehur
se mbi Pashtrik hapet Qielli
e pikë terri në pjatë të Djallit

T'jetër kush do të ishe

Dhe unë do të kisha Atdhe.

NJERËZIT E AKULLT

Vetëm shpirti na mbet e dashur
Ç'patëm
Na i mori Mortja

Shikoje Shkretëtirën si na pushton

Degëve të zhveshura
njerëzit e akullt
djerrinave dalin futë

Grimcojnë kokën e përgjumur të Antikës
tmerrshëm grimcojnë
minj gjirizash

Shkarravisin fytyra perëndish të rreme
me degë të thara
me shpuza të zeza mbulojnë sytha

Na duan vdekjen solemne
Teatër antik
kurrë nuk kanë parë
Zbritur s'kanë as në Dodonë

Shikoje Shkretërirën pashë zotin
na i përbin edhe trupat
edhe nishanat

Njerëzit e akullt
veshur në të zeza
flutura të kaltra gjuajnë

Oh e dashur
edhe një pikë ujë
se më doli flaka

DUMVENIO*

Ti i vdekur zatën ishe
përgjithmonë tash të shoh të vdekur

betoni i pafund e i ftohtë hataja
makinat e ndryshkëta qentë e cofur

gjumë i gjithçkajës eklipsi a thua

në derën tënde s'arrita të trokas
të më japësh një pikë ujë s'arrite

as dritaren pakëz të ma hapësh

n'ëndërr dikund takohemi pas sa shekujsh
mbi të qenmen ndërrojmë fjalë mbi të bukurën

e betoni e makinat e qentë e cofur
lojë dramatike në hapësirën e shthurur

ti i vdekur zatën ishe
të vdekur të shoh tash përgjithmonë

* *Lokalitët ilir*

SI TË KËNDOJMË KUR GJITHÇKA LIRUAM

Kaluan kohërat si erdhën plot zhurmë
të paidentifikuar mbetëm sot e atë ditë Unë
dhe këngët e moçme u harruan
o si të këndojmë tani kur gjithçka prej frikës liruam

TË KAM PASË THËNË NJË DITË

Të kam pasë thënë një ditë
kahdo që të nisem do të arrij te ti

të kam pasë thënë një ditë
me ty një hap do ta bëj më larg

po sot e atë ditë veten humba
e n'gjurmë askund s'të rashë

KATRORI MAGJIK

Adem Demaçit

Tani gjendesh
brenda katrorit magjik
dhe kërkon Kosovën në hartën e vezullimeve

Jugu e Lindja Veriu e Perëndimi
katër kapakë të mbyllur
të një ëndrre

Tej grilave përcjell fluturimin e dallëndysheve
se besimi
drejtpeshimi i lirisë

Ciatje gjarpërinjsh
rreth gishtit të ngritur
nga Zoti

Dhe pika e gjakut vizaton Diellin

Katrori magjik
është fatal
po qe se bie brenda tij

Në cilën anë do të zgjohet Kosova

MOLLA E KUQE

Kur ra Toplica
në Kosovë u zgjova

Ndeza pishën
fytyrën t'ia shoh Nënës

Nga Planeti i Humbur ajo
ma hodhi 'i Mollë të Kuqe

E më tha: Mos më harro

'i qind vjet po i lë

E te koka ime
Molla kuqëlohet edhe më

Ç'popull jemi

FAJTOR ËSHTE SHQIPTARI

Fajtor është shqiptari
që merr frymë
e ec në dy këmbë

Unë që pi medikamente për qetësim
e tërë kohën gjuaj miza
në Nevojtores

Fajtor është shqiptari
që shkryen gruan e vet
e familjen time shqetëson

Mollën që s'e arrin dora ime
në degën më të lartë
me fjalë të vdekura që mbush

Fajtor është shqiptari
që s'ekzistojnë më shumë Turqi
më shumë Amerika Norvegji

Gulagu që është aq larg

Që më zgjidhën e më lëshuan
të nuhas pas tij

a nuhatet vdekja

Fajtor është shqiptari
më shumë që nuk ha
e nuk fus gjumë në sy

Kanalizimi ynë që plasi
e Katakombet e Ballkanit
u rrënuan

Fajtor është shqiptari
që vizaton fytyrën e vet nën hënë
e thyen dritare e trazon ujin e ndotë

që flet shqip që ha shqip që dhahet shqip

Fajtor është shqiptari
shqiptari është fajtor
për të gjitha rëniet e mia

Edhe për dhëmbin tim të prishur
edhe për buzëqeshjen time të ngrirë
prandaj prandaj PLUMB

Ha ha ha
ha ha
ha

Falë të qofsha Zoti im

UDHËTIM ME UJQ

Udhëtimi me ujq është më se interesant
Tek kur nisesh Pyllit
zbulon fytyrën tënde të vërtetë

Udha mund të zgjasë më shumë se ke vjet
po ndodh
ta kalosh edhe me një vrap kali

Ai që nuk ka bërë udhë me ta
nuk di ç'është liria
as këmisha e yjeve

Ta kesh të qartë
pa humbur një krah apo një sy
nuk e çel derën lirisht

Nga qielli
s'po pikoka
asgjë

Feldafing, 6.6.1992

ODE ANTEU

Mashtrohesh se mund të bësh çkado me mua
Brenda hijes sime udhëtimi yt mbaron gjithmonë
Çamçakëz pse përtyp s'do të thotë se jam kalama
Kur të dua ta qëlloj mollën majë bajrakut
Në mënyrë fantastike si murtaja hapet kërpudha jote
Mbi gjithçka timen dhe m'i fsheh diell e qiell
 Rrënja ime nëntë herë i bie botës
 brenda njëzet e katër orëve e ti teksa del gëzhhojës
Mbi kulmin e kërrusur kërkoj yllin e mëngjesit
Në titërr të lëndinës vjell shkrumin e ëndrrave
Nga lëkura ime pagane shkund dhëmbët e tu plot dergjë
Pasmesnate bie në ahishte e i laj duart në puse lotësh
 Dal në fushë dhe e hedh farën nëpër hënë
 Shkoj në mal e kthehem pa kal'
Në krye ode vë fotografinë e Nënës
Me muzg bie e ma heq e me terr m'i ndërron rrugë e këngë
Rebelimi të zbutet edhe më ulërin udhës së vdekur
E mbi kokën time lëshohen sorrat e dhjesin e krrokasin
Rrethit të viteve vetëtin fytyra e Nënës
Dhe sytë e shkimbur të fëmijëve të harruar bodrumeve
S'do të thotë se unë jam kalama pse përtyp çamçakëz
Majë bajrakut ta qëlloj mollën kur të dua
Me mua mashtrohesh se luan koc i fortë jam plakush bre

Gurë e dhé lëvizin pas qerres sime të zjarrtë
Hapen udhë bien mure dhe hije dhe merimanga
Shpirtin ma kthejnë fuqinë ma kthejnë
A dëgjon kërmill
Oh zot

MONSTRUMI

Ishte në degë
kur ia zgjata dorën
të hynim në kopsht

Më parë ia mësova emrin alfabetin
pastaj si ndërtohet shtëpia
kur rrënohen muret

Dhe udhëtuam KodraveFushaveDetrave

Shi degën furishëm tash lëviz kthetrat
Tri pëllëmbë rrit ëndrrën mbi varrën time
Majë gjuhe ma ngrin fjalën

Ma ther syrin dashurinë mijëvjeçare
Lakuriq ma zdesht shpirtin
Poezinë

Nga bregu tjetër shqirret
me kokën time
në shtizë

E unë ia zgjata dorën

Në mes Njeriut dhe Bishës
ia shpjegova dallimin
para se të hynim në kopsht

Stamboll, 1980

MINJTË

Midis dhomës sime plasi diçka befasuese
Mbi çdo gjë të gjallë e të vdekur ra terri
Në brendinë trishtuese humba flokëpërgjakur
Në mes minjve që vërtiten kah pika vezulluese
Nga skaji në skaj çmontoj mure të çara
 mbyll vrima me shuplaka të nxira
Ç'është e mundur nga jeta ime të shpëtoj
Biri i botës sa çel e mbyll sytë udhën kalon
Që tërë jetën s'do të mund ta bënte një maraton
Zgërdhohet dhe yjet
 bien strehëve të lodhura nga myshqet
 dhe Shtëpia pikon në të katër anët
Në peizazh gërditës shndërrohen flora dhe fauna
Në pikë verbimi shkrepëtijnë dhëmbët e verdhë
 dhe sytë e mavijosur
Ja edhe në mendim edhe në intimitë edhe në poezi
 arritën të hyjnë këto krijesa të neveritshme
 e kohë qershish është
Nëpër dhomë tash e sa kohë kërkoj Familjen time
 të bërë pikë e pesë
Në lëmë thish na u shndërrua ajo A s'i merr erë bykut
 më shkruan Nëna nga Planeti i Lumturisë

Dhe kot zëri im pirrohet mureve të çara
nga vrima del miu dhe pa fije turpi i ziu
 kërcen mbi këmbën time të shtrirë në arkivol
 pastaj mbi dorën time të gozhduar
 ngjitet kah koka ime e qethur
 dhe grimcon tmerrshëm në pyllin e lebetitjeve
Mos harrova a thua të kurdis orën e babait
E ti vë shulin derës së shtëpisë
Kur rashë të flija

LOJA ME VDEKJEN

Nuk di sa vjet u bënë
por unë u mësova më në fund
edhe me minj e gjarprinj e engjuj

Bie e zgjohem
me nga një therrë të re
në këmbë të majtë

E rreth qafës sime të hollë
vazhdon të trashet
vezullima e tmerrshme e Thikës

Nuk më mashtrojnë më
as fjalët e urithit dhëmbëkali
në vesh që m'i pëshpërit

E shoh
Mall e kam
edhe këmishën e arnuar të Nënës

Tani për tani vetëm di
se jetoj në mënyrë krejtësisht normale
dhe me vdekjen luaj si me kokë maceje

UJI I MADH VJEN

Thuajmë diçka miku im
Thuajmë se prapë
do të shoh Lumin p.sh.
me një trëndafil në dorë

Thuajmë miku im
se do të kemi gjithçka
dhe Lirinë do ta lidhim fort
për rrënjë rrapi

Thuajmë miku im
qershitë janë sytë
e fëmijëve tanë
të helmuar

Thuajmë miku im
na polli kudra
e cofi
Vdekja

Hajt ta pafsha hajrin
Ujë i Madh
vjen
e harron çdo gjë

Prishtinë, korrik, 1990

MAGJIA E KOSOVËS

Dorë e të zotit
në degë e vjel
ose rreth Gardhit
lidh Qenin e Sharrit

MOS ËSHTE NJERIU

Ç'ulërin

Del nëna
Dheut i vë veshin
Del babai
mbështillet shtrëngatës
Del vëllai
Malit i qepet
Del motra
vishet në të bardha
Në të bardha
të dashurit e mi
në të bardha unë
Nuk shihemi
as dëgjohemi më
E Lugut e Kodrës
lëkurën lë
Drini

Dhe ulërin ulërin
Mos është
Njeriu

UNË JAM EGËRSIRË

Unë kam shpinë të fortë Zotëri
Këmbë të forta më të forta se ç'mendon ti
Dhe të shpejta
Sa çil e mbyll sytë kaloj kodrën ku rri zotërota jote
Në dhé deri në gju këmbët e mia zotëri
Njëqind vjet njëmijë vjet mund t'i bart
Mund t'i bart deri atje ku perëndon
dielli yt e nis dita ime

Deri deri
Deri atje te Varri
Shpinë të fortë kam Zotëri
Të forta këmbët të shpejta rrufe
Mund të ndodh e të bie në bërryla në gjunj
Por ty do të bart Zotëri deri te tempujt e tu të mykur
Ushton shtëpia

Nga fjalë të reja formash të vjetra
Dhe droj për shëndetin tënd Zotëri
Për fjalët e tua për refrenet monotone të këngës sate
Për mullinjtë e egjër që bluajnë edhe mut

Droj se do të rrëshqasësh keq Zotëri
Në shpinën time të gungalftë rrëshqitet hatashëm

Dhe do të mund pa hedhur topin në fushë
Me kokën tënde do të lozin futboll
Unë kam shpinë të fortë E sheh
Këmbë të forta thellë në dhé
Deri në fyt jam në dhé Zotëri
Por ty por ty do të bart deri atje deri atje
Deri te Varri i qyqeve
Unë jam egërsirë

1979

NATË AS DITË S'TREGON ORA

RELIKE TË FUNDSHEKULLIT

Kur dhuna
bëhet ligj
liria është afër

Njerëzit rrinë zgjuar
Natë as ditë
s'tregon ora

Rreth qafe me gishtërinj e vesh
e sy fëmijësh
hijet shndërrohen
në varr të gjallë

Liria s'është larg
kur ligji
bëhet dhunë

KJO KA NDODHUR NDOSHTA PARA KRISHTIT

Dikur moti lexoja libra mbi fashizmin
dhe shumë pak u besoja
Para Krishtit ndoshta ka ndodhur kjo
ose kur kthehesha nga Nazareti
Në Llap atje kur u ndamë nga Ylfetja¹
dhe kur fëmijët e helmuar i mbuluam me çarçafë
m'u kujtuan librat e pluhurosur
gati të grisur nën trenj
Ana Frank Ganimetja Persefoni
Deri kur deri kur njeriu t'i ndjekë
xhindet nëpër shtëpi
e hënë ta gjuajë gardhiqeve
Dikur moti kjo ka ndodhur para Krishtit
ndoshta shumë më herët
se kur kthehesha nga Nazareti

¹ Ylfete Humolli, nxënëse e vrarë nga policët serbë në Kosovë

KUR TË PRAJNË

Kur të prajnë avionët tanket çizmet
edhe lehjet edhe sharjet edhe rrahjet

Kur të prajnë helmimet mallkimet rrethimet
edhe klithjet edhe ndjekjet edhe vajet

Kur të prajnë muret çelësat mikrofonat
edhe hatatë edhe trillimet edhe ëndrrat

Kur të prajnë fëmijët nënat trimat
edhe varret edhe lugetërit edhe gjakrat

Populli im do të këndojë apo vajtojë

PROMOVIMI I SATANIT

Gjithsesi të trillohet një ebre i verdhë
një popull ebre
pa atdhe

Ndryshe nuk mund të ndërrohet asgjë
as të bluajë Rrota e Hekurt

Të ngrihet pastaj një fabrikë
aman vetëm një fabrikë
për ëndrra të larme
tevona një Gulag dhe
varri i madh i elefantëve të Afrikës

Ndryshe-nuk mund të arrijë paqja në
shpirtin tuaj
as të përjetohet Simfonia e nëntë
e Bethovenit
ekzekutuar nga Çerdhja e fëmijëve
Gjejeni patjetër një vrasës një fajtor
rrënues tempujsh varrezash
një rebel trashaman
dhunues anadollak

Dhe e paqena të niset nga lagjja e varfanjakëve
Ndryshe nuk mund të ndërrohet asgjë
as të promovohet Lartmadhëria e tij
me fytyrë prej ëngjëlli
me dhëmbë prej gjarpri

Po ku të gjendet ai ebre i verdhë
ai popull endacak
ai varr i madh elefantësh
ajo fabrikë për ëndrra të larme

Ku të gjendet ai vrasës ai fajtor
ai rebel ai dhunues
kur asgjë më nuk frymon
as pidhi i maces.

XHIRIMI I NJË FILMI SEKRET

Mungonin rrënjë degë lisa vrarë rrufeje
ujëra myshqe shtresore qetësia shurdhuese
bari malarik thatësi vërshime tropikale
Mungonin shpella katakombe qytete
të nëndheshme tërmete e sëmundje
kaktuse luleshpata ndonjë vjollcë e stinës së pestë
lozë kungujsh farë të zbrazëta
oaza të vetmuara me hëna të përgjakura
mbi shatorre mavi
e përreth zalli i gjallë që vetëm gëlltit

Mungonin vendime ligje urdhëresa
në pikë dite eskadrila
në pikë nate ose
në pikë ëndrre

Ndonjë qytet i rrënuar apo fshat i djegur
me gjelin e fundit mbi hu gardhi
Puse të pafundme e kapakë të artë mungonin

Se ishin dinozaurët kentaurët minotaurët
gjarpërinjtë nga të gjitha llojet
hijenat ujqërit korbat e bardhë

dhelperat minjtë
e kuajt e famshëm nga Troja që kishin ikur

Dikur kishin arritur dhe katallanjtë
në përcjellje të sirenave vajtuese
dhe klounët me fanfara e zjarre te thika
matësit e tokave e pastruesit nga Hadi
pastaj kasapët më në zë të Sorranisë

Në fund të skenës së errësuar ishin
aty dikund edhe aktorët
zgjedhur nga regjisori i padukshëm
Gati ishin edhe maskat kamerat reflektorët
e tërë makineria e hekurt
Obobo krejt ç’duhet për një projekt
madhështor
ku është derdhur
tërë mendja gjeniale e liliputanëve

Por ky film
por ky film nuk do të shfaqet kurrë

Se Mungonin Se Ishin Se Filmi
në bunkerë të Satanit të Sorranisë
ishte kyçur veç
kur vrapoja të lajmëroja botën
për një hata që kishte ndodhur
dikund atje në bisht Evropë.

NË MESNATË

Në dritare ra një zog i zi
e më tha: Mos shko! Të pret Djalli!
(Fragment i harruar nga Stina e Armëve)

Në orën dymbëdhjetë në mesnatë
në gjunjë do të biesh
të fshish në Pasqyrë
Pikën e Zezë

Dhe mes xhenazeve
nuk do ta pranosh kurrë
se gjakun ta kanë pirë
me pambuk njerëzit e akullt

Në orën dymbëdhjetë në mesnatë
Po nuk këndove
do të çelë zogj
Qyqja

Dhe Hënën do kërkojnë
në fund të Pusit hienat

NJË I VDEKUR I ZAKONSHËM

Një i vdekur i zakonshëm
Thyen dritare vazhdimisht
Në këmbë mban një shtet
Vrapon shkallëve hyrjeve
Mbledh dhe pikën e fundit të ujit
Llampa e lë galuc mbi tryezë
Një i vdekur i zakonshëm
Dhunues e vrasës bezdisës
I ndjekur e i vrarë vazhdimisht
Publikisht shpallet prishës rendi
Në ballkonin nga qielli
E lakuriquar një vashë
Ngacmon moralin qytetar
E përflakje e mbyllje rrethi
 Po çelësi
Një dele fushës e shetit njeriun
I lumtur se jeton thotë
 i gjithëpushtetshmi
Një i vdekur i zakonshëm

DRITHMË

Në Kosovë
vetëm vdekja
nuk vonon

Munih, 1999

KLITHJE NË SHKRETËTIRË

Nga liria ika
të grindem më
nuk desha se
e tmerrshme ajo

Në kullë vetëtimash
fjalë e fundit:
Heshtni ju lutem
Këtu vdiset

Dhe shoh se jam
vetëm
një klithmë
në shkretëtirën e kuqe

Greva e urisë, 1.6.1993, Prishtinë

FUNDI I LOJËS

Ne do të vdesim
secili në mënyrë të vet

Dhe me vete do t'i marrim
edhe vrasësit tanë

Por triumfi
është edhe fundi i lojës

NJË DITË TEPËR SHUMË

Një ditë më herët ose më vonë
nuk do të thotë kurrgjë
për Evropën

Ndërkaq për Kosovën
tepër shumë
Më tepër se një dhembje
më pak se një dashuri

Sa larg më le
nga bregu i ëndrrës
Nënë

Feldafing, 14.5.1992

PËRDITSHMËRIA IME

Nadje herët më zgjon polici me automatik
dhe rrëmihja e fqiut që hap varrin tim
diku nën rrapin e çarë përgjysmë
pikërisht në dymbëdhjetë pa pesë minuta
në dritaren time bie një zog qiejsh
rreth shtëpisë bëj vrapimin e fundit ndoshta
kokën e gungfaltë ma qethin
m'i presin thonjtë plot dhé
ma përgatisin ujin e së Premtes së Madhe
kah ora njëzet në përcjellje të avionëve supersonikë
theqafjes vrapojnë tanket e përhirta
për ta qitur në gjumë antikën e sakatosur
në rezervat ku unë me durim ujis
lulediellin e natës së qyqeve
pranë meje diku fqiu i zbehtë vazhdon të hapë
varrin tim
edhe për nja 13 cm
e të flasë me gishtërinj
nën kujdesin e policit me automatik

LIRIA ËSHTË E TMERRSHME

Liria është e tmerrshme

Nuk më flihet
se nuk më zgjohet

Nuk më rrihet
se nuk më lëvizet

Nuk më jetohet
se nuk më vdiset

Liria është e tmerrshme

Ora ime bie
Tmerri im është ajo

ATO NUK JANË VARRE

Nuk vdiset në Kosovë
vetëm njerëzit shndërrohen
në rrënjë në degë të një peme
Kur të shfaqet Djalli
të përgjaket
ose të bjerë

Ato nuk janë varre

POEZINË QË NUK DO TA KRYEJ KURRË

Dhe do të vijë dita
kur do të thonë
aty ka rënë Albana
atje Shpendi
atje ka ekzistuar filan shkolle
atje bozhuristët
kanë helmuar fëmijët

Në periferi na ishte
Ulpiana Dardania
Ç'u bë kështu me fisin tonë

Dhe do të vijë dita
kur do të thonë
hordhitë serbe kur kanë kaluar
dhe asgjë nuk do të besohet

Prandaj këtë poezi
nuk do ta kryej kurrë
është i tmerrshëm fundi i saj

1986

LAMENT PËR LIRINË E NJERIUT

Falënderoj
Evropën Demokratike
Apartheidin Kosova që krijoi

Ja Afrika ime e bardhë
imazh neveritës
qytetërimi

Dorë të çojë dhe Zoti

Falënderoj qeverinë serbe
që ma mëson
gjuhën e hazarëve

Dhe gjumë të rehatshëm i uroj popullit tim
Që më bën të vuaj
për Lirinë e Njeriut

Greva e Urisë, 29.5.1993

FRIKA I

Unë kam sy
Por frikësohem të kallëzoj
Se ç'shoh tej

A kam të drejtë
E kuptoni kur të flasin
Dy gropa në ballin tim

Ku fiket dhe dielli

1998

FRIKA II

Duke rrënuar
Nuk ngrihet Kulla
Edhe pse para heçamës
Së zbrztësisë
Nuk shihet Taraboshi
As Buna
Një shpend terron horizontin
E unë grimcoj thonjtë
Ku fillon e ku mbaron
Kujtesa
 Im zot

1998

EKLIPSI

As kjo ditë pa kordel
Dhe kjo natë
Pa hënë E Kosova

Nuk na zë hapësira
Kjo bimë ç'duhet ulërijnë
Vetveten kur e zhbijnë

As ky mot pa zjarre
Tatëpjetës guri djersin
Fluturimi i ngatërrohet shqipes

Në të zeza shfaqet dielli
Herr e err gjaku
Po Kosova

Shumohemi ne apo vdekja

DJALOSHI NË KËMISHË TË GOSTIVARIT

Arsimi i kishte 23 vjet

Kur e përjetoi Gostivarin
djalosh nuk ishte më
Ngusht i binte çdo gjë

Qerrja hermetike e policisë
 prodhimi më i ri i mortit
 Made in Macedonia
Vinte nga Shkupi i përhënë

Oh Vilajeti i Errët i Kujtesës
 së një populli

Shenjat ishin ogurzeza

Se gjithkund frymonte Gostivari
 edhe në lëkurë edhe në fjalë
 edhe në ulërimë
 edhe në lëvizje të pakontrolluara
 edhe në flakë bubullimash

Poshtëruese ishte
gjimnastika e akullt
nën ritmin e askushëve

Në tavernën “Arbri” në Tetovë
një poet i sojit të rebelëve
lidhte plagët e fjalëve qafëlejkësh

Nuk mund t’ia çartte imazhin e Manjolës
Prapa kafkës së Malit të borërave
Nuk mund t’i shkruante
Se mungonte shpirti zjarri

E në pano hataje të territ
Lulëzim Haziri
rokeri i fundit i Iliridës
me dhëmbë ujku qep embleme
veshin e kafshuar të Evropës
Trëndafil i Zi

Bixhozxhinjtë e fateve makabre
do bëjnë gjumë të këndshëm në ishuj vetmie
apo roletët do shkrepin katakombeve ballkanase

Kodrave të zhveshura shfaqen Vajtojat e Rekës
mbi hone ato perëndi të rralla
Britmat t'u dëgjojë
a ka kush

23 vjet ka Arsimi

Ditën kur veshi Këmishën e Gostivarit
të luluar në vegjën *Made in Macedonia*
dathur e k'in parë Sharrin mbështjellë në vetëtima

Hija e mortit në Qerren hermetike
bridhte Iliridës

Ëndërr e ligë e kishte trandur një popull

Korrik 1997

SHIKIMI NGA DRITARJA

Asnjë pikë loti
Nëse shkuam apo
Vetëm këndonani
E përjetuam lirinë
edhe nga brenda

Greva e urisë, Prishtinë, 27.5.1993

DRENICA

Gjumë në sy nuk futëm tërë natën
Ajo duke kërkuar vend për të më shtruar
Unë duke ia mbuluar plagët

Kullat 'in shndërruar në varre
Në hone përrallash të fundshekullit

Fëmijë të vdekur linden
Nënat flasin me shpirtëra me engjëj
flasin me perëndi
Vit për vit bëjnë nga një luftë burrat
Tej horizontit ndjekin Ujkun e Çalë

Unë kam problem me kujtesën me pagjumësinë
Nuk mund ta gjej shtëpinë e mikut
E kaq shpesh kam dalë në Drenicë

Asgjë nuk është në vendin e vet
Edhe varret kanë lëvizur

Thonë se atë e kanë marrë me vete
Azemët Ademët kapedanët
Fshehur e kanë diku nga thika e hasmit
derisa të rriten fëmijët

Unë bredh fjalëve baladave ëndrrave
Nuk lënë korbat ta shoh qiellin
Në vetëtima ngujuar rri Ajo

Drenicë, 1998

REÇAKU

Na vrasin të na bëjnë të pavdekshëm
Ku të kesh fat
Një herë në njëqind vjet
Ndodh të krahasohesh me zot

Ulpianë, 15 janar 1999

MARSHI

Nuk ka plumba
sa jemi ne
as ka me pasë

Ne vijmë vazhdimisht
dhe shtohemi
pas kositjeve bubullimave

Me vjet bartim tmerrin
terrin e dheut
dhe të gjakut

Na frikësohen Evropë Amerikë
se zgjimi i trupit të copëtuar
lament njerëzor

Plumba nuk ka
sa jemi ne
as ka me pasë

Udhën na lëshon edhe vdekja

1998

FRIKË E MALL

Kam frikë
Frikë e mall Nëno
Kam frikë se turpërohem

Shkund e na shkul
Majë pikëllimës
Na hedh shpirt i fyer

Kam frikë
Mall e frikë Nëno
Mund e bëj burrërisht vdekjen

Dherave të Arbërisë
Kalëron e shkretëron
Kalë i mortit

As në Shkodër
Tynzot
Nuk na buzëqesh

Mall kam
e frikë
Nëno

Nën bekimin
tënd
asgjë vdekja

Mars, 1997

DO TË IK ME ZHIG PA E PARË NJË FILM

Do të vdes pa e parë një film
deri në fund një film pa e parë
Do i mbyll sytë e do ik me zhig

Nuk do e shohë askush
se nuk dihet kur përfundon

Mbi një ide projekti grandioz

Të çmësohemi nga përrallat e fëmijëve
ne burrat e dheut
Të lozin aktorët edhe role nga antika
në Teatrin Kombëtar
Pak gjëra ndërruan nga gazi i palaços

Pa e parë një film do ik
Shoh se mungon edhe guximi njerëzor
Në hapësirë i gozhduar ja si Krishti

Kapoja na i kyçi të gjitha portat
Nuk na i kthen çelësat
të shohim filmin si përfundon

Por vështirë se do kënaqet kush
Rolet janë ndarë gabimisht
dhe barinjte shtohen
po Grigja

Në premierën e tij nëse kryhet
edhe fundin ata që e shohin
do i kërkojnë nëpër shkundullima

Filmin mbi kibucin e fundit në B
do të vdes pa e parë
T'u duartrokitja bile rrënuesve
të turpit botëror

20.I.1999

NË MBRETËRINË E HAZARËVE

Një fletë e zezë
Pushton edhe Majën e Shenjtë
 Faqen tjetër të dheut
 Pastaj anën e Diellit
Njeriu hamendet të ndezë pishën
Të lexohet shpatull e pulës
Grykës shkon gjëma
Në një letër të zezë
Humbet njeriu pa nam e nishan
Në shuplakë mban Planetin
Urith i përqyrravtë
Nuk prajnë tërmetet
As nuk zbardhet
Një fletë e zezë
Vazhdon marshimin
Në Mbretërinë e Hazarëve

SHKËLQIMI VERBUES

Për pikë të qejfit qëllova Mollën
Nuk mund ta duroja shkëlqimin e saj
Në pjatë dheu të tim zoti
Gjumë në sy nuk futy thikë e grykësit
Derisa përshkoi universin ajo
Në vathë para se të zbres kopeja
Gurin e hedhur qiejve tej
Engjëlli im mbrojtës ma kthen
Shkëlqimi verbues seç më nxori
jashtë vetes
Ku dashuri çoja me vdekjen
As në ëndërr nuk e shoh më degën
Ra në teh thike ose kohë ndërroi
Fuqi mortore çelës i harrimit

REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË

TE GURI E PREVEZËS

Në Nikopol kish pas jetuar Joni i bukur
Joni kish pasur një nënë fort vetmitare
Pas shtatë konaqesh Nëna ia kish gjetur Nusen
Nusja kish udhëtuar e udhëtuar
Joni kish bërë dasmë e krushq të parë Boçarët
Dhe Nusja na kish qenë perri
Dhe k'in filuar fëmijët
Dhe ish pirë verë e shtruar sofrë deri në More
Po gëzimi na qe i shkurtër e Mortaja kish rënë
Pastaj k'in filluar luftërat gjaqet hasmëritë
Dhe Joni kish marrë male kish marrë fusha
E kish humbur Nënë e kish humbur Nuse
E kish humbur dhë e kish humbur qiell
Larg larg ish nisur me një Fyell me shtatë vrima
Dhe një nga një kish shkelur vise qytete
Peshë kish çuar gurë e dru
Te Urë e Artës zotrat ia k'in zënë pritën një mot
Copë-copë ia k'in bërë trupin
Në degë të një rrapi ia k'in tharë gjuhën
Në hone të maleve ia k'in shterrur zërin
Te një ullishte e te një krua ia k'in nxjerrë sytë
Në midis udhe e k'in hedhur

Vdekje e gjallë në mes erërave
Dhe kushedi pas sa vjetësh atypari kish pas
kaluar një udhëtar
Lëshuar kish një namë të madhe
Rrufe e kish shkrepur
E ish dridhur gjithë Epiri e Suli
Konop kish rënë shiu
E Jonin na e kish marrë në gji një valë
Aty te Nikopoli
Po syri i tij na ish shndërruar në një copë qielli
Po gjaku i tij na ish shndërruar në një copë dielli
Aty ku ra Joni tregojnë tash
Dielli nxen më shumë
Aty qielli të ruan nga të ligat nga magjitë
E një valë bonjare të humb nëpër guaska
ëndrrash
Ç'më la ai vrapi
Oh ç'm'u këput litari te Guri i Prevezës
Joni ynë
Mjerë
U

Prevezë, 1986

URA E ARTËS

Ti na qenke ajo ura që në heshtje të vdekshme
të kohëve të sërta kënduar të ka im atë
Bjeshkëve të Namuna e krahasuar me Urë të Shenjtë
Urë moj Urë e Artës

Deri te guri yt i latuar nga mjeshtri epirotas
Udhë bëra vite e vite
Po Hamzë Podrimja nga Gjakova ku arriti
Urë moj Urë e Artës

Lumit tim sa vjet i duhen
Nëpër ty të kalojë me një lulekuqe në dorë
Apo historia jonë shtangu në sqep korbi
Urë moj Urë e Artës

Me një krah në qiell me tjetrin në mishin tim

Artë, 1986

BOÇARËT

Anton Belushit

S'e k'in 'i burrë për vatër
'i vashë s'e k'in për krua
Të gjithë 'in për mejdan

Atikë e Sul e More
Brendë e jashtë bedenave
Gjuhë pleqërishte arbërishtja

Kiço Noti Marko vat
Nëpër degë të ullishtave
Fustanella e britma latë

Boçarët dhe Lleshi i Zi
Mbi shpatë nxin Atika
Epirit mbijnë qiparisë

Nuk i zë asnjë kangjele
Asnjë vaj s'i nxjerr fushe
Të paktë e k'in 'i nënë

Kokat ua mori i madhi lavd
Po hije u bëjnë fjalët shqipe
Të thellat të Epirit rrënjë

Boçarët fis kapedanësh

Misolongji, 1986

REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË

Në Janinë hyra
Kur gjethet k'in rënë
Dhe drunjtë zhveshur rreth Kështjellës
Jani në oh Janinë e Ali Pashës
Si nuk arrita të të shoh
Pyll të ri

Janinë, 1986

FLUTURIM I PËRGJAKUR

Panajot Xhebelikos

Ra këtu A ra
Këtu u ngrit A e pa
Fluturimin e përgjakur të shqipes
Nën Lisin e vrrarë të Dodonës
Mbështillet Gjarpri
Trupit të Çamërisë
E një fëmijë zgjon gurin me lebetitje

Pargë, 1986

VAJTOJCAT E REKËS

Josif Bagerit

Kur vjen e diela
oh kur vjen e diela
në të zeza veshet Reka

Gozhdave varin
Gjuhën e Dhunës
dhe Zotin e huaj

Nga Mali i Thatë
në Malin e Shenjtë
fluturon Qyqja

Kur vjen e diela
oh kur vjen e diela
e diela kur vjen moreee

Vajtojcat e Rekës
zbresin te varret
e qajnë shqip

Gostivar, 17.3.1993

FUSHA E ATIKËS

Idriz Ajetit

Një nga një i mblodhën fjalët
Dhe e thanë një fjali të rëndë
Për pikëllimin e madh arvanitas
Pastaj u mbyllën në Fushën gëlltitëse të Atikës

Shpatë-Athinë, 1986

KTHIMI NË ANTIKË

Mensur Raiçit

Ëndërrova një këngë
Ma ngulfati hija ime
Vazhdova të shkruaj një të re
 Në lëvoren e një druri
Pas njëmijë vjetësh po e zëmë
 Kur mori fund udhëtimi i Ulksit
 Dhe kur Homeri hynte në Bibliotekë
 Me libër nën sqetull
Hija ime
Mbylli veshët qepi sytë
Me dhëmbë të zinj
Vdekjen e vet
Përtyp
 Dhe mua më përzunë
 Nga Morea
 Është e pasigurt hyrja në antikë

MOREJA

Qiparisë qiparisë qiparisë
dhe qiparisët
emra njerëzish

Kiço	Marko	Noti
Bubulina		Xhavella
	Mjauli	

Vis i çuditshëm i poezisë sime

Patra, 1986

DINOZAURËT

Në Janinën e Frashërenjve
qiellit zbresin
perënditë e metropoleve

Te Ura e Artës
Marko Boçar Suliotin
ç'na e zgjon 'i ëndërr

Në katër shtiza
të katër kalorësve mavi
kokë e Ali Pashait
del Dheut

Në Janinën e Frashërenjve
Lis i Konicajve
britmat mbyt me shushurimë

E në Dodonë sezoni dimëror
mbyllet me shfaqjen
Dinozaurët nuk kanë ç'të hanë më

DRITARE E VETMUAR DHE E HAPUR PËRHERË

A JU DËGJON HARRIMI

Poetëve arbëreshë

Assesi s'e pranoni humbjen
e kaq vjet erret
dilni prapë te bregu i detit
vetëtoni derisa bubullon në botë
mblidhni ato të rralla fjalë
ose i krijoni nga hiri i ëndrrave
për një çast ndalni kohën pastaj
kaltroni e zbardhjeni si De Rada
mbyllni një rreth mërgim derdhni
po a ju dëgjon harrimi deti
dikur vonë ktheheni në kangjela
dhe pritni kohërat t'ju çelin
ose t'ju lindë ndonjë zjarr i fshehtë
i Motit të Madh
po humbjen s'e pranoni assesi
e kaq vjet (sht)erret

ARBËRESHI DHE DETI

Det o det
Ti je i thellë
Por mua nuk më bie
as në gju

Det o det
Ti je i tmerrshëm
Por unë do të të shaloj

Det o det
Ti je hata
Por unë dua të jetoj

... Dhe deti na ish çarë
Nga klithjet
Dhe tmerri

TE DE RADA NË MAKI

Për kokë të Lumit vetë e pashë me këta dy sy të mi të gjallë De Radën
Aspak nuk ish mplakur

Bëmë edhe një fotografi para Kolegjit të Shën Adrianit

Dëshmitarë kam shokët e mi të fjalës

Priste e përcillte te ajo dritare e vetmuar:

Moj More e bukura More

Më njohu edhe me Rinën e Milosaon një Lule mbillnin

(Ata kishin ndërruar *vetëm* kohë dhe hapësirë)

Bukë e kripë e zemër më shtruan dhe më përcollën në besë

Te një plep vra reje pushova pak ujë piva në një gurrë

Tepër isha lodhur pluhurosur nga udhë e largët

Pastaj trokita te një kangjele

Aty natën kalova

Ç'shoh: një det i tërë lotgjak ish mbyllur në të

Ngadalë e mora dhe e shfletova

Droja se e lëndoj

Klithjeve fjalëve mall pikonte

E De Rada atje në kodër të përhanë

Vazhdimisht hapte atë dritare të vetmuar

Moj More e bukura More

Kodrave luginave ktheva te Lama: luhej vallja e burrave

Në të zeza gratë këndonin: Kur ta shoh martinën var

Një vogëlush sa Lumi im më tregonte se si gjyshi i tij Serembe
Kaherë kish shkuar atje në Malet Arbëreshe
Për t'ia sjellë atë Mot të Madh
Buzëdetit syçelur i varrosin të vdekurit prapë
Me kangjele i mbulojnë me copa qielli me valëdeti me kripë
Në ëndrra ç'do 'i qind vjet ndodh nga 'i tërmet katastrofal
Njerëz të mirë mund t'ju flasë edhe shumëçka e kur të doni
Të gjallë De Radën e pashë me këta dy sy të mi
Aspak nuk ishte plakur bëmë edhe një fotografi
Dëshmitarët kam shokët e mi të fjalës
Për kokë të Lumit nuk është e vërtetë se ai ka vdekur
Siç shkruan në *Historinë e letërsisë shqipe*
Moj More e bukura More
Këlthet ende ajo dritare e vetmuar dhe e hapur përherë

Maki, 1.XI.1980

ZEFI YNË

Zefi ynë dy herë kyç derën e shtëpisë
Një herë për ujkun
Të dytën për Gjahtarin

Në kulm hap baxhën e tymosur
Pështyn Zotin në fytyrë
Bubulinën Xhavellën përgjon

Në More
Mes trungjeve në dhé
Dy bojë njeri

Zefi ynë natën e kalon më tepër
Duke vrapuar nëpër shtëpi
Sesa duke i qitur fëmijët në gjumë

Po qe se dera thyhet thotë Zefi ynë
Të mos braktiset shtëpia
Çelësi të ndërrohet patjetër

Frasnitë, 2.XI.1980

IDILË

Për shkak të një arbëresheje
Do të vete në gjueti ujqish

Fjalë kangjele nishane do t'i lidh nyje për brez
Nuk do të më mashtorjë selvi e huaj

Skaj 'i udhe në vetminë më të madhe
Do ta lexoj Bukurinë e Naimit

Për shkak të një arbëresheje
Do të bie në gjak e lak e koka në prag

Me valëdeti me erëmali do të shoqërohem
Me jugun përcëllues të ëndrrave

De Radës Serembes e Maurit e Gramshit
Do t'ua shtroj udhën me lule atdheu

Anës malit do të shfaqet ajo faqekuqe mollëohrie
Bregut detit do të dal unë rrënjëilirie

Nënë e Lumit do e tradhëtoj qe besa
Për shkak të një arbëresheje

FSHATRAT ARBËRESHE

Fshatra arbëreshe s'ju gjeta si në poezitë e De Radës
Të Serembes si në kangjelet popullore
si në fjalë të urta të Maurit

Lugjeve të vdekura gjembore kodrave të vetmuara
Larg vetes e botës gjithnjë buzë malit-detit
të derdhura

Asfalti i zi ju sillet si gjarpër rreth kokës së lodhur
ju ha mërgimi TV radio makina ju prishin drejtpeshimin shekullor
qytetërimi i egër xhez muzika tamtamet e largëta ju therrin ëndrrat

Ndryshe pak e kuptoni fjalorin e gjuhës shqipe
ndryshe pak i këndon i këngët shqipe
në një mijë variante brezave u tregoni për Motin e madh

Megjithatë arbëreshë mbetet

Gadishullit të Apenineve atje poshtë ka sa shekuj
që ia keni vënë shpinën
të mos rrëshqasë në detin e kobshëm të verbër Mesdhe

Fshatra arbëreshe të shkapërderdhura nëpër harresën italiane

Hora Arbëreshe, 3.XI.1980

VALLE ARBËRESHE

Nuk bën
Gratë të mos kenë rroba të zeza
Tokën rëndë të mos e rrahin burrat

Nuk bën
Fëmijët të mos bezdisin për Motin e Madh
'i vrap të mos e bëjnë rreth shtëpisë
 Para se të burrërohen

Ndryshe
Kënga nuk pikon gjak
Erë mërgimi s'u vjen fjalëve

Frasnitë, 2.XI.1980

KUSH DO TA VRASË UJKUN

F. Altimarit

Dhe lëtini tha

Po qe se takon
Arbëreshin dhe ujkun
Vraje Arbëreshin

Dhe kur fjala i ra në vesh
Arbëreshi buzëqeshi
Dhe drodhi një cigare

Po qe se më vret mua
 more i gjorë
Kush do ta vrasë
Ujkun

Mjerë kopeja

Koçencë, 1988

HORA E ARBËRESHËVE

Skiro di Maxbhos

E largët
dhe
E lartë

Ku njerëzit
bëjnë
punë zotërash

Hora e Arbëreshëve, 1988

DUKE LEXUAR PIKËLLIMIN E HANA D.¹

Iku Gjyshja
Një ditë hataje pastaj
shëndenë na e la edhe Nëna
Ujit dhe Bukës dhe Kripës
nisa t'u them ndryshe
Tani botën dhe veten
artikuloj në gjuhë të Njerkës
dhe në mua zhduket
diçka përrallore
Edhe lindja edhe vdekja
peshë tjetër kanë
dhe vazhdimisht më bëhet
se Zoti im
është i zi
Zot mos i thashin

¹ *Shqiptare që shkruan në gjuhë tjetër.*

ÇELËSI NË PERLAT E TUA

SI E KEMI ZBULUAR DETIN

A ju kujtohet detin e zbuluam
kur dhëmbët na u ndërruan

Dhelpra kur harroi udhën
në Pyll të kthejë a ju kujtohet

atë mrekulli tërë jetën e kërkuam
nëpër njëfarë uji të zi notuam

dhe tërë jetën na kërkuam me pishë
a ju kujtohet

atlantida atlantida atlantidaaa

a ju kujtohet për në Iliri
për në Albanopol udhëtuam

mbi Rozafa megjulla erëra
brigjet të humbura deri në një
a ju kujtohet

harroni gjithçka harroni
edhe veten e sosur edhe ëndrrën

harroni edhe rënien tatëpjetë
golgotës

detin e zbuluam kur ngritëm
shkollat tona
kur vjershën e parë shkruam
për lirinë Skënderbenë

e Dhelpra harroi të kthejë në Pyll
a ju kujtohet

atlantida atlantida atlantidaaa

ITAKA

Në Itakë

Arrihet në mbarim të udhëtimit

Dhe ora gjithmonë bie dymbëdhjetë

Ata që nisen pa fanar

Nuk do të mund ta lexojnë kurrë

Librin e shkruar dymijë vjet

Për çuditë e oborrit

Të keni kujdes

Itaka

Megjithatë

Libër i grisur

ISHULLI

Humbja të zbulojë
fshehtësi e madhe

heq e le tani në valë
halë e gjallë në zall

ç'po të rrahin detrat
durimi po të rrit

kep i tretur në re
rrënjë e thellë në gorre

ditenatë Varka shket
kah ti tokë e gjakimit

e të zdeshe e të vesh
kaltria e mbytur në sy

A JU KUJTOHET

KONSTANDINI

1. Nuk më përzunë
Për të gjallët më mori malli

2. Nën dritën e nurit tim
Parmakë baladash theva

3. Shumë kohë paskam qenë larg shtëpisë
Qenkan rrëzbitur muret gati shterur kroi

Lëmë e paskan bërë minjtë
As në tokë as në qiell oxhaku

4. Nëntë vëllezër ishim
Kopil s'isha oj Nënë

5. Të rruhem e të qethem
Në pasqyrë njerëzore t'i qesh fytyrës sime

Dhëmbët t'i laj sytë
Lëkurën e puçëraftë thonjtë plot dhé

Natën ta hedh nga krahët
Shpirtin ta shkund zërin

6. E pamundur kaq pluhur mbi mua

7. T'i kreh kaçurrelat e verdha
Rrobat e martesës t'i vesh

8. Ka sa vjet që më pret Bubulina

9. Lulen e Nënës ta vë te zemra
Me vete ta marr buzëqeshjen
e Doruntinës

Të shkund pemën në kopshtin e shkretë
T'i mbush xhepat plot me mollë

Deri te Pragu i Shtëpisë
Të ngrehi këmbën zhag

10. Fyellit t'i bie
E t'i bëj kafshët
Të lozin rreth muranave

11. Atin ta shaloj
Livadhit të Kositur t'i dal në fund

Po të munden
Le të ma shkelin hijen

12. Për të gjallë as për të vdekur
Kush të mos ma qesë këngën

13. Duke u endur baladave
Më ranë këmbët
Më dolën flatrat

14. A do të më njohë
A do ta njoh

Trupin e kam prej dheut
Sytë i kam prej ujit

15. Ç'është kjo ushtimë Nëno
Mos doli tërë Përdrinia
Të më presë

Apo Nusen ma sjellin

Ç'janë Nëno
Shira – Vërshimë pastaj
Bubullimë-Thatësi-Korba

16. Mos qenka shkruar prapë të endem baladave
Unë Kostandin Arbni i lindur diku në Perëndim

17. Qebesa nuk më përzunë
Për të gjallët më mori malli

1979

E NATA I KA MBULUAR GJURMËT DHE KLITHJET

Je shtrirë buzë lumit i sëmurë
lumit i ke folur në veshin guaskë
ai të ka bartur
kah vetja
e ti i ke folur me zemër
e dhimbë e të rëna ke ndier
në shpirt
në trup

e ti i ke folur lumit të thellë
për 'i tokë për 'i qiell i ke folur
për shtatë vëllezërit e tu
e asnjë fjalë s'e ke thënë për Rrushën në malësi
ai ka ikur kah brigjet e humbura
prej sëmundjes sate ka ikur

e ti je shtrirë buzë lumit të gufuar
lumi ka përgjuar jetën tënde tërë kohën
të ka pushtuar si magjia të ka mashtruar pastaj
lumi të ka vënë në gjumë pas nëntëdhjetenëntë vjet pagjumësie

dhe ka ikur kah brigjet e humbura

ti ashtu me shpirt në hava i shtrirë
ke soditur sytë e zgurdulluar të heshtjes

e nata i ka mbuluar gjurmët dhe klithjet

ROZAFATI

Secili i fali nga diçka
kush emrin
kush eshtrat i la

nga gjaku
nga zjarri
koha sa herë eksplodoi

rreth diellit tonë
sytë shpella i bëmë
në bjeshkë s'pushuan tupanët

se secili i falim nga diçka

armikut ia shtruam rrugën
me kufoma
deri te zemrat tona

e ai kurrë s'i shkeli
perënditë tona
kurrë s'mund i arriti

se secili i fali nga diçka
kush emrin
kush eshtrat i la

NDJENJA

Fatos Arapit

Deti Jon ik nga unë s'di pse
në hapësirë në kaltri më kërkon

valë e tij kurrë veriun pa e harruar
në jugun e të folmes sime udhëton

e ka diçka të unë që kohëra mposht ka
që Detit Jon i përngjan përrallës

e s'di pse
më kërkon në kaltri në hapësirë

Vlorë, 1971

KRUJA

Krejt ç'është jotja
nuk mund ta them kurrë
Krejt ç'është jotja
fillon e mbaron në një mur

E lart shumë lart
ngritur të paskan eshtrat e mia

Fluturon Korbi e shtanget
ngas e t'arrij në kohëra
se krejt ç'është jotja
në mua e zbulova n'ëndrra

E lart shumë lart
ngritur të paskan eshtrat e mia

Krejt ç'është jotja
e fisit besimi-amshimi
Krej ç'është jotja
zjarmi-udhëtimi-zgjimi

E lart shumë lart
ngritur të paskan eshtrat e mia

Krujë, 1971

SKËNDERBEU

Bëja roje Nuk e pashë
Zbriti bjeshkës
Apo fushës erdhi

Në krah kish një shqiponjë
Të cilën mes nesh
Na e la amanet

Gjergj i Gjonit më thonë
Po më thërrasin edhe Skënderbe
Kur hëna përgjaket

Mori udhë larg e larg nami

Bëja roje Nuk e pashë
U ngjit bjeshkës
Apo rrjedhës së lumit vajti

Kohëve bredh dherave
Në Kështjellë thonë zgjuar rri
Unë besoj: Mbi kokë të Njeriut

Dritë bën Ai

HAPJA E NJË POEZIE NË KOHË TRISHTIMI

F.

Na përzunë nga qyteti
Taverna hotele porta na mbyllën
Na ndoqën forca të blinduara policia sekrete
Tjetërku kërkoheni fatin thanë
U përbirua nëpër sytë ëndërrues të Naim Frashërit
Malit të borërave i ramë poshtelartë
Me shpirtin tënd unë në shuplakë
Ti me fyellin magjik në buzë të luluara
Askund kasollë e perëndive të Sharrit
Pas shumë vitesh
nuk di cila kohë a perandori ishte
Na gjetën në një poezi inxhi
Dhe na thyen heshta dritare kulme
Njëri-tjetrin tani shikojmë atje në sfond
të zënë nga objektivi vezullues i Marubit
Dhe dëgjojmë shiun
Si na zgjon nga harrimi trishtues

UJKANI

Ditën e mërkurë sollën lajmin
Ujkan Ujkani vdiq

Ditën e enjte morën letër nga ai
kurrkujt asgjë për mua mos i besoni

Ditën e premte hyri xhenazja në shtëpi

Pikërisht në orën dymbëdhjetë
Ujkan Ujkanin e varrosën

Atje poshtë
në udhëkryq

ATDHEU, DHEMBJE

E pas Kosovës
Saharja me siguri
se dhembje pikon Atdheu

Schwalenberg, 15.X.1993

BETEJA E KOSOVËS

Hap syrin
dhe nuk mundem pa klithur
Hija e vdekjes
ma paska mbuluar Kullën

NËSE

Nëse 'i popull
Nuk i ka poetët
Dhe poezinë e vet
Për një Antologji Kombëtare
Mjaftojnë edhe tradhtitë
E lehjet

RRËNIMI I PËRMENDORES SË TURPIT¹

Nëse nuk duan ta bëjnë publikisht
unë kam forcë
natën ta zgjas dyzet e tetë orë
ose sa lypset për ta rrënuar
një përmendore
që s'i ka hije shqipes
të shihni atëherë
një Popull e një Kryeqytet
si lirohet nga ankthi
Dhe në vendin e atij aziati
Tribunin²
tëm popullor
nëse nuk duan ta kthejnë
unë kam forcë ta bëj edhe atë
Do të bindeni atëherë
se një Popull e një Kryeqytet
mund të bëjë shumëçka
për namin e vet të dikurshëm

¹ Fjala është për përmendoren e Stalinit në Tiranë. Poezia është shkruar një vit para se të rrënohej ajo.

² Tribuni popullor, Bajram Curri, luftëtar për çështjen shqiptare.

FOTOGRAFIA JONË, ETNIA

Gjymtimi yt pikëllon edhe në ëndërr
Zogun ma tremb në dritare të hijesuar
dhe ma kujton cungun në pyll rrufesh
Me katër faqe drite të dua të plotë
Dielli kur të dalë majë Tomorrit
 apo tehut të Pashtrikut
të ma ndritë Fytyrën skaj më skaj
 Gjuhës së Nënës
 deri në Dodonë
Nyje t'i lidh Dri e Jon rreth Dheut
Pesha e fatit më është më e lehtë
Fotografinë tonë të verdhë e dashur
hajmali ta kenë fëmijët
në gjah kur të venë
 Brenda zhgjëndrrës
 prore zgjohet Atdheu

Feldafing, 12.6.1992

REVOLTA E ROKERIT TË DHEUT TË SHQIPEVE

Nuk u paguaka as të vdiset
Pazarin e Grave
cipërdoncullak e paska zhveshur Zhak Preveri
 me stafin e tij
 Po ku Barbara

Disa paga
një litar për varje majë rrokaqiellit
E guximi nga Ura e Shenjtë
mesazh i Mulliqit në “Udhëtimin drejt të panjohurës”
shikoj Tiranën si zgjohet
 nga Gropat e Zeza

Mes zotërave të rinj
shfaqet drita hyjnore
Përrallë a është kjo për fëmijë zoti Pound
Se shihet preket e përjetohet
nën zërin pushtues të Manjola Nallbanit
Buzëqeshjen time të ftohtë i fal botës
Kush (mund) luan koqe me një popull shtet
Nuk e vlejka të vdiset
Duhet paguar edhe Qerrja e Zezë Mbretërore dy-tri metra qefin
një pëllëmbë tokë
taksa shtetërore për gurin te koka e pafjetur

e hijen e qiparisit
Dënimin pse e si ke vdekur
aksidentalisht apo në shtrat të ndonjë konteshe
dëshminë nga policia në çfarë gjendjeje ke qenë
dhe pse prish Projektin e infrastrukturës së Atdheut
pastaj miqtë për heshtje e guxim intelektual
ndonjë agjent a lavire nga planeti i kuq
që ndez llambat në fund të mëhallës qorr
e vadit një lule me ibrik antikiteti
Po unë nuk jam Faik Konicë
të siguroj patriotizmin tim ballkanik
në një frigorifer amerikan
Kushtuaka shtrenjë çdo gjë
edhe vdekja me dashje
Më mirë t'i dal para Rrotës
të shkëputur atje nga Grigja Botërore
derisa Bariu bënte një sy gjumë
në pendla shqipesh
në firaje ohrie
Le të dalë ku të dalë
Gjësënd nuk paguaj bile
për shpirtin e shndërruar
në shi

në një sy vashe
E ajo nuk shpie në Thertore
Vlen të vdiset

KULLA E BALSHAJVE

I rri afër zotit
se nuk u zihet besë
as njerëzve

Kur dielli godet në kokë
bie në gjunj para Ujit të Madh
Sytë i lan në shuplaka të engjëjve

E një zog i qëmotshëm ngrin në ajër
përderisa të zgjohet Bindi
erërat vdektare t'i lidhë për rrënjë ulliri

Kush u ngjit aty
harroi diçka të marrë
dhe Zotin nuk e troi kurrë më

Ulqin, qershor 1997

NË MAJË TË TOMORRIT

Nuk na u nda një shqiponjë
Udhë e lartësive udhë e Abazalisë

Tërë frymë e të papritura o i uruar
sa harrova Lumin dhe Kosovën

Qenka vështirë të jesh perëndi
Njerëzit t'i shikosh nga Maja

Uji i Zi, Tomorr, 1993

ATDHEU I MBËRTHYER NË ARKË

Martin Camajt

Del në mëngjes Evropës
për një lutje fisi
Shpirtin asgjë nuk ta qetëson

Në mbrëmje kthehesh dikur vonë
dhe kur zonja Evropë
mbyll dhe syrin tjetër

Nxjerr nga arka atDheun
dhe në dritë të hënës
e peshon në shuplakë

Damar pas damari e shpalon
kushedi për të satën herë
duke i gjetur kuptime të reja

Të bëhet se të thërret ndoj zot i harruar
të bëhet se kush ikën
nga përqaqimi i llahtarshëm

Vë veshin pastaj dhe dëgjon trokun
mes Drinit të Bardhë e të Zi
që vetëm ti e kupton

Me ferk mbërthen atDheun në arkë
dhe merr Evropën në sy
i bindur se asgjë nuk peshon më rëndë

Në hall na qite Burrë Malsie
me ata zëra paganë bubullimë Dheu
me ato ethe Arbërie

1991

PËRMENDORJA E VIÇIT

Viçi ynë më në fund
Meriton një përmendore
Kasabanë na hijeshon

Do e puthni e shastrisni
Në Shesh diku të Nënës Terezë
I bukur e përrallor

Dhe pse të mos e kemi
Kur Evropa ka përmendore
Dhe për mikimaus e qen

Dhe pse zoti President
Para Teatrit Kombëtar
Pëllëmbë toke nuk ndan
Për viçin tonë

Nëse ngrihet ndonjëherë
Mjeshtrit me nam i kërkoni
Gjuhën t'ia lërë përjashta

Na shurdhoptë i pagoji
Me rrënjë ia shkullim
E bëjmë gjumë të rehatshëm

Mes gjinjve të një rrospie

Maj, 2000

TROKU MORTAR

As Shkodër as Gjakovë

Bisht i Sorrës
fsheh
udhë e kafka

Se shkuma na mbuloi
deri në majë
britme

Po Shkodra

BETEJA E ASKUJT

I. Kadaresë

Pasi e kishte lëshuar zogun e zi nga kafazi
vasko popa shkroi poezinë më të fortë thanë
se tërë krijuesit sllavë

ajo që frymonte në fjalë në vargje në libra
ajo që hijonte në legjenda në magjizezën
bënte sfidë, se ulërinte ujku i çalë

lexuesi Mitin e Kosovës e kuptoi prandaj
si e ndiente në të vërtetë
dhe si e shihte në pasqyrën e së nesërmes

u desh kohë e gjatë të shkundullojë mali
e të shpaloset fjalë e grisur
mbi betejën e askujt

dhe rastësisht krej rastësisht u shfaq kadareja
në rozë veshur përderisa kthehej nga një shëti
nëpër kohë të errëta e plot nerva popujsh

1980

ALETË E KORÇËS

Aleve të pafund të Korçës
si aleve të harruara të Ilirisë
ç'm'u shfaq harta e humbjeve të mia

Vaji i thekshëm i një flauti të vetmuar
aty në hijen e Orakullit të Dodonës
thyen heshtjen e çatave mijëvjeçare

E në shuplakën e shtrirë të territ
pikëlonin yje
nga qiejt e padukshëm

Yje Kosove
as Çamërie
nuk ishin ata

Po klithma të një flauti trishtues
që më zgjonte aleve të Korçës
mbi hartën e humbjeve të mia

Mbi ballin tim flakë
flad i Ohsisë
dorë perëndie

A e gjeta udhën për në Iliri Nëno

Korçë, 1993

KORBI

Po ku u shfaq ai shpend i hijeve
në ekranin tim
Kur verbon bardhësia e Bjeshkëve të Namuna
Krrrokamë e tij e lemerishme
të vdekurit frikëson gjarpërinjtë
derdh bjeshkë ujërave ua ndërron rrjedhën
Nuk pipëtin asgjë
nën krahun e tij të rrëmbyeshëm
I urtë mbret i Shkretëtirës Kukunënë
Lejomë të dal në Sukën time
të kullos Grigjën
ujqit pa zbritur nga gërmadha të vetmisë
shtizën e flakët i thashë tek hidhja
në rrathë të panumërt rreth frymës sime
Por në ekranin planetar vetëm një pikë
Nuk është e bardhë
E u përbe në tokë e qiell
se shpend nate nuk është
kur ra në supe të njerëzve të shndërruar
në kaktusë gjigantë
rreth Ishullit *Albania*
ajo hije e mistershme
Kep Pikëllime

TATËPJETË GOLGOTËS

Njerëz të gabuar
më dënuan

Tatëpjetë Golgotës
Ja pse luhatem në Litar

SHTËPIA PA ZOT

Vdiq pa çelur një dritare

Shtëpia mbet
edhe pa Derë
se na u ndryshk Çelësi

Oxhaku u shndërrua
në një lejlek
të zgjebosur

Në fund të Livadhit të Kositur
me gishtërinjtë në gojë
presim
se kur do të tymoje

A jetohet me ëndrra

KUR U ZGJUAM

Kur u zgjuam
ishim vishkull
fshiheshim nga vetvetja

Ujërat na i k'in bartur edhe ëndrrat
dhe lëshuar na i k'in qentë
dhe rrëzuar na i k'in gardhiqet

Deri në Majë të Majës kundërmonte bar minjsh

Kur u zgjuam
plojë i kishte bërë vathët
Ujk i Çalë

E fluturimin e zogut
e buzëqeshejn e fëmijës
e fytyrën e Nënës i kishim relike

Tani shikojmë Qiellin e Verdhë kah hapet
dhe në shpinë bartim Malin e Ulërimave
derisa të na harrojnë të vdekurit

ISHULLI ALBANIA

Këtu e në fund të ëndrrës
ujë e ujë e ujë
Një tokë e djegur
Nga Zoti braktisur dhe Robi i vet
Bregun kërkon Hijen e shpendit
Në mes valëve të verbra
shpëlon gjymtyrët e mavijosura
humbet duket
Gëlltëtës të çartur përreth
Oh engjëlli im
qëllomë në mes vetullave
të më mbulojë hiri i Tokës së djegur
Këtu e në fund të ëndrrës

Ulqin, qershor 1997

VARRI NËN ULLINJ

Ra nata e vdekshme
Gjamët e mbyti
deti

Era e shkrumuar bredh pa krye
plisa tirqe opinga
shkund

Plasarinave përbihet vdekja
dhe korbon
Pëllumbi

E therrur ra nata
Trupa të coptuar
fsheh

Nga një copë qiell të vendlindjes
bartnin në sy
të ndezur

Dhe kur morën udhë
i bardhë ishte
Pëllumbi

Nën kurora të ullinjve
zbathur një vashë flokëprerë
qan të dashurin që nuk është më

E mua ka vjet
nuk më zë gjumi
nuk më zë gjumi
nuk më zë gjumi

Tivar, 1986

ME QENË

Të jesh shqiptar
e vdekja të mos të gjejë
edhe në skaj të botës
e pamundur është

Të jesh shqiptar
e ndonjë qen të mos të ndjekë
deri në varr
e pamundur është

Shqiptar të jesh
botën varr të mos e kesh
e pamundur është
e pamundur

Në trupin tim
plaga më e thellë
sa më afër
Bregut

VDEKJES IA LUAJ SYRIN

Më mirë që nuk jam ai në fotografi
Mall do e kisha moshën e Lasgushit
Dhe revolucionet botërore të njerëzve të mi
Do hidhesha prapë nga Ura e Shenjtë
Të njëjtin gur që e kam dhe tani
Me të njëjtin emër i Ali Taljanit
Do e kisha aty mbi urën e mbërthyer në re
Kokëçarje do i sillja Gjakovës
E tërë Drinisë së përndezur nga vetëtimat
Të shkrep ndonjë pushkë pritave
Valëve të Drinit shalqinj të kopshtijeve
të Zefujkanpalgjonit
Para se t'i vinin nën thika tinxherët
Nga kepi i mbretërisë sime do i arrija
Më mirë që nuk jam ai në fotografi
Në petka të purpurta prej përrallash
Në portën qiellore një shtyllë
Gishtërinj do thyeja e bërryla
Zjarri tej hapësirës së kërcënuar
Në fusha të Bajram Pashës të shfaqesha
si një profet lashtësie
Qafës së Diellit të më ndiqnin hijet
Pse e paskam zdashur hënën gardhiqeve

E pse kaq probleme shkakton zjarri im
Me një valë deti do e lidhja Liburnën
Në Ulcinium të Bindit mbi Kulla të Balshajve
Zogun mavi ta kapja në hava
Në tingull violine para se të shndërrohej
Ai që isha më mirë që nuk jam
Detin Jon do e thaja të shkilja në Çamëri
Te Bilal Xhaferri të kaloja natën
Vdekjen ta ndaja si bukën si kripën
Një perandori të bezdisja e një planet
Për miqtë e mi të mbetur ku bën qyqja ve
Nëpër sy të shkruar të engjëjve
Buzëqeshjen e Lumit të përfytyroja
Malit të Thatë gjarpërinj do gjuaja e sorra
Bajraktarëve t'ua prishja gjumin në kulla
Më mirë që nuk jam ai në fotografi
Rebelimin do e paralajmëroja prapë
Kosova është gjaku im që nuk falet
Në bela do bija me vrasës e diktatorë
Asnjë trimi nuk do i merrja dorë
Nga invadimet barbare të shpëtoja
Edhe gjysmën tjetër të Arbërisë
Fundi i një zjarmie shekullore

Është fillimi i amshueshmërisë
Ja vdekjen e zgjoj nga shtrati prej rëre
Ia kafshoj veshin lapoç ia luaj syrin
Në më xhelozoftë e dashura
Murit të vajit nuk do i shkoqem aty
te Biblioteka Kombëtare
Çfarë trimi jam betejën e fundit
Nëse nuk e mbyll me rrapllimë fryme

PASQYRA E THYER

Pasi çelësat e vetmisë i kishte hedhur në një hon Robinson Kruso nga Oqëania kishte braktisur Ishullin për shkak të *Shqipërisë* që e kishte zbuluar rastësisht tek lexonte një pergamenë Dhe në mbyllje të mileniumit të sertë sapo kishte shkelur aty ishte mahnitur me fluturimin e lartë të shqipeve:

Po si jetonit

Ne bënim se vepronim
Ata bënëin se na shpërblenin
Ashtu jetonim As në tokë as në qiell

A shihnit ëndrra

Të ëndërronim nuk guxonim
As të flinim
Nuk kishim gjumë

Varur rrinim për një fije merimange

Herë na hidhnin tej Gropave të Zeza
Herë na mbyllnin
Këndeji Ujit të Madh

Vetë ne ato i çelnim vetë ne ato i mbyllnim

Lesh arapi kjo Shqipëria

As punonin

As ëndërronin

E jetonin

Dhe zotëria veshur në xhins nga Oqëania që e njihnin si
Robinson Kruso nga lektyra e vetmisë njerëzore ishte parë për
herë të fundit në tavernën *Iliria* duke pirë uiski me rebeluesin e
quajtur F. Konica. Nuk dihet pastaj ç'kishte ndodhur Ishulli
Albania vazhdon të mbetet i rrethuar nga shqiptarët trimë. Më
vonë nuk lajmëruan as agjenturat e Fuqive të Mëdha për të çarat
katastrofale mbi Majën e Tomorrit në drejtim të së cilës notonte
në ajrin e dendur *Varka* e Krusosë.

REK'TIMË

S'di pse më merr malli të shoh Shkupin
E atje s'është Lumi
As Bac Bajrami nuk zdirgjet Grykës së Kaçanikut

S'di pse
N'ujëra të Vardarit i fus thellë duart
E më terrohen sytë

S'di pse hapat më ngatërrohen
E shiu më ndjek pas
Derisa të kyçem në shtëpi

S'di pse
Për një mend s'di pse
Shkupi më dhemb në shpirt

1980

ROBI I ZOTIT

Zoti është i madh
dhe i rëndë dënimi i tij
Por pëshurr lirinë
që ma ofron Robi i Zotit
Nga varri im i quajtur Sistem
të përshëndes Kep i Djallit
me një gjeth pelini

KRIJESË E VERDHË

Ndërron përditë ngapak
Brenda meje gdhin apo perëndon
Tërë kohën në pishë të diellit
E nuk u poqe ende
Kund nuk lidh loza jote
as mureve të larta të Trojës
Unë nuk di ç'të bëj me ty
të pres ujin mbi vijën e mullirit shtatë gurësh
Të ndërroj farën me një qime ariu
çatinë e Kullës
Ta shndërroj në një kapelë magjike
Janinë e Shkodër t'i lidh në një kërthizë
Më bezdise me gjithëfarë formash krijesë e verdhë
me ato përralla që nuk kryhen dot
me atë qiell të frikshëm që s'mbyllet
as në syrin e përgjakur të korbit
Më nxore jashtë vetes
Po lëkura ime
E paktë për një gunë Arbërie

ISHUJ TË VEGJËL ËNDRRASH

E ku brigjet
I rashë ndore Drinit
Uji i Madh ma kish zënë udhën
Nata e zjarrmisë pikon çative
Mbi dhera ohrie
Bekimi i tim zot
Frymëmarrja e gurit të latuar
Nga mjeshtrit dibranë
Çudira ç'bën në lëkurën e përcëlluar
Deri në asht shpëlohet bukuria
Në lule të ballit më godet pastaj
Ku unë, Gjergj Elez Alia
Qiejt kërkon një nosit
Në sy të mi të uritur
Nën plepa të harlisur
Përthajnë plagë
Diell e ujë

E brigje brigje brigje
Kokëqethje të çuditshme nga brisku

Oh ishuj të vegjël ëndrrash

Strugë, 26 gusht 2000

VDEKJA E NJERIUT APO E ULLIRIT

Rrapllimë e shiut e flatrave
Gjak Njeriu apo Ulliri
në shuplakën time
Nga qiej të padukshëm nga dherat
Mijëveçarët dalin cungje pavdeksie
Përthajnë plagë buzë Ujit të Madh
E këmishat u ndërrojnë nënat
Mbi kokë të gjeneral Boletinit
Qiellin fsheh një krah sorre
Imazh trishtimi
Ç'ma prishi harmoninë
Njeriun varrosin apo Ullirin
Mortin ta vrafsha Vlorë
Rashë mbi një bunker dashurie shpirtërash

Shas, korrik, 1997

EVROPA PËRMES GRILAVE

Ludwig Hartingerit

në dhomën akustike hyn Evropa përmes grilave
dhe më del ëndrra
pëshpëris vitet: 1878, 1813, 1924, 1945
kujtoj Mollën e Kuqe
hingëllimën e vrançit
kur shurdhonte Toplicë e Artë

ja erdhi edhe viti 1992
kongreset e anktheve e pabesive
po unë ende marr frymë
mas hijen me pëllëmbë rrjepacake
deri në skaj të horizontit

a kam më kohë për korigjime

atje larg shoqërohesh miku im
me tingujt e Mocartit
letrat m'i nis që kurrë s'arrijnë
e asht e lëkurë zbres unë
në rrethin e nëntë të Ferrit
tjerr terrin verbues
mësoj veshin me vetminë e fjalëve të shkronjave

me shushurimën e ujërave
dhe shpitrave të fikur

këtu çdo gjë miku im paguhet me kokë
edhe ninulla për carrokë

shoh Evropën përmes grilave duke shpallur trupin
në breg të erërave

mos lypset ta kafshoj në dy faqet kuqaloshë
nën lëkurën e djegur ta fsheh pushin e saj
nga era e verdhë

forma kentaurësh po qe se marrin grilat
gjak i ri i duhet Evropës miku im
dhe një zot kokëfortë

DO TË SHALOJ ATIN, VDEKJEN

Të ëndërrova pas shumë e shumë vitesh.
do të shaloj atin do të shaloj vdekjen
deri te guaska jote e harruar në një det.
koha është të pushtoj time rrënjë.

GJUMË TË MIRË E DASHUR

Çelësi nuk është tek unë
Çelësi gjendet tek ti e dashur
Shtëpia prandaj na u mbush
 minj gjarpërinj ujq
Po qe se ke guxim
Çil kapexhikun ta shoh fytyrën
 hënë të rrumbullakët
Murin e rrënoj unë
Dhe minjtë dhe gjarpërinjtë dhe ujqit
 nuk do t'i zërë vrimë e zezë e Dheut
Vetëm Çelësi është tek ti
 Në perlat e tua dikund
 gjumë të mirë e dashur
 Të lodhi kolla

SHPIRTIN E HUMBUR KËRKOJ

NJË DRU DIGJET NË FUSHË TË SHURDHËT

(MN)

Ti je një bishë e vogël e llastuar e llahtarshme
Një macë e egër që vetëm grith në murin e padukshëm
Ti je një tmerr që të ka dërguar djalli në planetin tim
të rri zgjuar unë mbi të keqen mbi ferrin
Fatkeqësi që mund të ketë edhe emër
Ajo që nuk bën të jeshë
Nëpër malin tim të prerë kërkoj udhën time të humbur
ku do të vritem apo dal fitues
Por ti ori je një bishë e urtë dukat
Nën këmbët e dathura mban edhe malin nën frerë
dhe gjahtarët i shastris
me zërin tënd
që bashkon ujë e zjarr
në një shuplakë të gurtë
Dëgjo, bishë e maleve të Arbërisë je Ti
ku sëpata e mjeshtrit
nuk di ç'pret e ç'ndërton nga trupi yt i qelibartë
nuk di ç'mbledh e hedh
se gjithçka fillon e përfundon me ritmin tënd që dikton
Udhëtimi yt mbyllet me klithma me ardhjevajtje marramendëse
me humbje

Kur prishet harmonia jote
dora ime shtanget
se këmbë të reja më qite
hije që robëron një planet që shkakton katastrofa
E sheh digjet një dru në fushën e shurdhët të dëborës
së Bjeshkëve të Namuna
e lutje për Kosovën apo nën lëkurën tënde të tejdukshme
ajo që vdes në mes brigjeve pikëlluese
Bishë e vogël e llastuar e llahtarshme mbyllesh në fundin
tim të marrë
pret Ujin e Dekës të na shpëtojë
me të gjitha këngët e uratat për zotin tonë që nuk e patëm

DO T'I THEM TË NJËJTAT FJALË

Kur kufjen s'e ngrejme
më mirë kuptohemi e dashur
Jemi një shpirt e një trup

E di se Ti rri atëherë
pranë Dritares së zymtë
e më kërkon mes yjesh mes valësh

Ndërkaq unë në dhomën 2 me 2
larg teje njëqind vjet dritë
shtrydh edhe pikën e fundit të gjakut

Nëpër mure të grithura
vizatoj: fytyrën sytë
flokët e tu detin

Edhe pa u dëgjuar edhe pa u parë
ne dëgjohe mi e dashur
dhe shihemi aq bukur në fund të Pusit

Le të mbesin fshehtësi edhe dashuria
edhe shpirti
edhe pëshpëritjet

Policia e fshehtë
përderisa t'i deshifrojë ëndrrat
Gjarpri shndërrohet në Lule

Më mirë mos e ngre kufjen e dashur
Edhe pas një mijë vjetësh
do t'i them të njëjtat fjalë.

NJË FYELL E NJË YLL NË NJË PYLL

Në Pyll
'i fy'll

në fy'll
'i yll

ç'yll zot
vulli 'i Pyll

kall 'i fy'll

GJARPRI, BUKURIA

Mbyta gjarprin që të hy në kohën tënde

ç'po më dendëson zbraztësia jote nëpër huqet e mia

NËNAT

Të gjitha nënat kanë diçka

Të Nënës Terezë

Apo

Nëna Terezë ka ngapak

Nga të gjitha nënat

Unë bredharaku i dritës

Kërkoj Majën

Në Malin e Frymës

Të vë një karafil

BUKURIA

Zgjata dorën në livadh lulen me këputë
“Mos – fqiu im i dashur më bërtiti –
do të vyshket!
unë qava saksinë time të thatë.

qita hapin, kalin e bardhë me mbërri –
vashën e ëndërruar kaherë.
“Mos! – përsëri m’u gjegj fqiu.
unë qava me mall edhe atëherë.

hodha dorën në gjithësi me pikëllim –
çel e mshel sytë dritë m’u bë.
“I lumi ti!” – dikush më bërtiti në përqaqim
e kurr gjë tjetër s’pashë as ndjeva më.

sot e atë ditë kudo e kërkoj fqijun tim të mirë.

1960

DASHURIA E HUMBUR

Vogëlush
në këtë qytet
a banon Dea

Butrint, 1971

E PANJOHURA

Ç'zog i bukur
po gjahtari

i verbër
dhe i pagojë

PËRFLAKJA E TRUPAVE

Ne ishim krejtësisht të verbër
kur buzë e trupa na u dogjën
dhe vizatonim ëndrrën me prekjet tona
Në mes udhës pëshpëriti ajo
Minuti të ishte një jetë
Kurrë të mos hapej ashensori
Por lumturia tepër e shkurtër
Në mbarim të udhëtimit
kur drita nga kishte zbuluar
ne ishim krejtësisht të huaj
Buzë e trupa na kishin mbetur diku

Mars, 1999

ËNDËRRIMTARËT

Shikohemi
Ledhatohemi
Pastaj kafshohemi buzëve
Dikur lakuriqohemi deri në asht
e digjemi shkrumb nën hënë
Ndanë udhe mbledh hirin tonë
një udhëtar
Dy engjëj qiellorë
në një shishe e mbyllin
dhe e hedhin në Ujin e Madh
nga Kepi i Rodonit
Ne turpërohemi
nga gjymtyrët tona të derdhura
Vishemi monotonshëm
Te këmbët tona
Vaterloja tymon ende
Dhe krejt kjo ndodh
përmes shikimit të dyshimtë
në mes një perrie
e një kaçaku të dalë nga zgura
me një gjarpër ndër dhëmbë

ZOTI NUK ËSHTË MACE

Dashuria nuk vjetërohet
Përsoset vazhdimisht
Por Zoti nuk është mace
Të na grithë rreth qafe
Na hedh nganjëherë edhe
Tej Lumit të verdhë ku
Shndërrohemi në pluhur
E një stërkeqje na shpërndan
Dherave të shpopulluara
Zoti nuk është mace
As nuk vjetërohet dashuria

GAZELA

Shërimi im
trupi yt, oj grua –
livadh i bleruar.

shëndeti im
trupi yt, oj grua –
mesditë e pjekur në rremb.

urrejtja ime
trupi yt, oj grua –
mbrëmje e rrëzuar në gjunj.

oj, grua, oj grua, det i thellë.

GRUAJA

Nuk është prej gjakut
Prej zjarri është prej drite
Ndriçim i brendshëm i shpirtit

Nuk është prej gjumit
Nga rëra është nga uji
Humbet nëpër gishtërinj

Ëndërr më tepër perëndi
Si libër i lashtë hapet
Dot t'i lëxohet fundi

Nuk është prej fjalëve
Dhé tërmetesh është misterësh
Nga trajtat drithëruese shket

Kohë në kohë diku shpaloset
Nga temperatura e trupit
Drejt peshimin humb nën hije të Njeriut

1970

SHPIRTI I HUMBUR

Vetëm një herë
më zuri gjumi
në mes gjinjve të saj
qiellin s'e pashë më

Vetëm një herë
trupit të saj u mbështolla
si fluskë bore më shkriu
aty në mbarim të lojës

Vetëm një herë
më puthi në ballë
Më shitoi Zanë e Malit të Prerë
mua trimin e Arbërisë me nam

Në shuplakë të saj
Pluhur tani zgjohem
Frymë e t'vdekurve më shpërndan
Shpirtin e humbur kërkoj

FJALË PËR DASHURINË

Krejt ç'është e bukur
për dashurinë
ende s'është thënë

(prore mbetet diçka të thuhet
n'emër të një kohe
në jetë

herët ose vonë)

ajo gjithmonë vjen
sapo harrojmë të dashurojmë
dhe kurrë s'është vetëm e sotme

krejt ç'është e bukur
mbetet përherë e pathënë,
e kërkuar në jetë

UNIVERSI I PIKËS

Lehtë të kalosh detin
Provo pikën e ujit
Të duhen vite ta mundësh
Pikën provo atlet
Ujërat shterren në sy të perrisë
Na përthau thatësi e zezë
As fjalët as ëndrrat
Ta lëvizin dot gurin
Ke pas kaluar dete
E ke pas lënë nam
Pikën e munde atlet?
Në Urë të Shenjtë të dukesh
Kah qielli mbi vetull të perrisë
Ta harruam edhe hijen
Koha prapë nga zeroja

DHEMBJA

Të bukur jeni
kalorësit e mi
të bukur jeni

në këtë pyll
pranë këtij uji
nën këtë hënë

të bukur jeni
kalorësit e mi
të bukur jeni

po sytë
po sytë në ballë
si ju lanë

FORMAT, ORIGJINA

Ç'u ranë dhëmbët

Botën si e mbani
të rralluarat fjalë
drejtpeshimin e Diellit

në pusin e ëndrrave
zbret Njeriu
gërmon origjinën kohët

në zenit
relievi i fitoreve
dhe mitet moderne

ç'po na lënë format

DASHURIA, FJALËT

Trimëria ime më e madhe:
Dashurinë ta shpëtoj nga Fjalët
Duhet dhëmbët t'ia ndërroj
dhe kohë tjetër t'i krijoj

ZOTI I LAKURIQUAR

Edi Ramës

As në Pyll
nuk është më vetëm Njeriu
Shtohen cungjet gjitharë formash

Nuk di a ka nevojë më
për përsosjen e tyre
nga dorë e Mjeshtrit

Pylli rrallohet
se Njeriu kërkon të jetë zot i lakuriquar
ose t'i ngjajë pakëz atij

Të shoh Evën
kur bie në Krua *tetë sylynjarësh*
për të pirë ujë

Këln, 1994

DUKE NDJEKUR ENGJËLLIN E ZI

NUK KAM BËRË KURRGJË PËR LUMIN

E pranoj nuk kam qenë i qetë asnjëherë
kam bërë njëmijenjë të zeza për të jetuar
e di Lagjja e Bajram Currit e di Lagjja e Cullakëve
e kam prishur qetësinë kur nuk është pritur
kam thyer dritare kam tharë drunj kam shterur kroje
në *Pusa të Drinit* kam kërcyer nga Urë e Shenjtë
(Mjerë ai që s'ka pasur kurrë në jetë ndonjë Urë të Shenjtë)
Në fyt kohës i kam mbetur shikoni si shkumon
dëgjoni si turfullon
për shkak të mirësjelljes plehin asnjëherë nuk
e kam nxjerrë jashtë
Lumin kurrë nuk e kam dëgjuar deri në fund
Fjalën këngën vajin s'e kam lënë ta kryejë
shpirtin ia kam prurë në majë të hundës
me shantazhe me kërcënime ia kam helmuar fëmijërinë
nënë ia kam sharë ia kam sharë fisin zotin
për veshi e kam nxjerrë nga shkolla nga loja
nëpër shtëpi e kam ndjekur si i çmendur

E pranoj Lumi ka shkuar më larg: nuk ka pasur
komplekse fare
askujt nuk i është përrulur vetë zotynë ka qenë

ka thyer dritare më shumë se unë lule e ka
bërë lagjen Ulpianën
më mirë e njeh asfalti i nxehtë
Kurrë një rrugë nuk është kthyer shtegut të ri
për të bota nuk ka filluar as nuk ka mbaruar në Gjakovë
ka qenë më kokëfortë se unë disa herë është përgjakur
(Për të vërtetën u zura or baba më thoshte
dhe nuk e shihja sa kohë)
nuk ka qenë i kënaqur me qetësi në shtëpi
të rrijë një dritare çel vazhdimisht ka kërkuar
pa i rënë në fund kurrë nuk ka pasur për zakon
ta mbyllë përrallën
as ç'sheh n'ëndërr të shkruajë të vizatojë
aq shumë e ka ëndërruar bukëndoren sa
dhëmbët i ka thyer nëpër vjershat kosovarçe
më ka dashur më shumë se unë atë
nuk më ka denoncuar për mall të botës
ajo që flitet për të nuk është e vërtetë
në bixhoz asgjë nuk ka lënë
ndryshe nga Evropa kohën-hapësirën ai e ka kuptuar
nuk e ka kaluar si xhaxhi Ramiz duke parë filma porno
apo në gjueti zhure orgji si ai fqiu ynë tralala
jeta nuk është vetëm lakuriqhane sekshane leshhane

Nuk është e vërtetë se ai nuk do të kthejë më
 do ta shihni një mëngjes
 prej zërit prej hijes një mbrëmje do ta njihni
 më kanë thënë ende kokën e bart në shpinë
 në Hadë e kanë parë e kanë parë në Albulenë
 E pranoj nuk kam bërë mirë që kam folur haptas
 për sëmundjen e Lumit
 që jam marrë aq shumë me të duke i rënë në qafë
 Evropës Stepës së gjorë
 diagnoza ka qenë e rëndë: *Sarcoma* dr. Ervin Ginsberg d.v.
 Nga një dritare dikun në një qytet të tmerrshëm një vashëz
 Ujanën tërë kohën e ka mbushur me LuleLumi
 prej askujt nuk kam mundur ta fsheh
 sëmundja e Lumit nuk është vetëm sëmundje e Lumit
 Djali im i madh Dreni tash ma përplas derën
 vajza ime Donika ma kthen shpinën
 gruaja më thotë: a do të bësh diç për Lumin burro
 veç shpirti i ka mbetur
 Lumi ngre vetëm dorën e zhveshur të tharë
 unë vazhdoj të prishë qetësinë në shtëpi duke
 ndjekur engjëllin e zi
 të gjallëve të vdekurve u telefonoj
 theyej dritare kërkoj hapësi më të madhe për shpirtin tim

kaloj natën me mullacakë me monstrumë
me mure të vdekura
ende po u shkruaka poezia
ende po u fshehkan sendet nga vetvetja
ende Evropa po jetuaka nga instinkti
shtëpia ndiej si dridhet nga shurdhimi i qetësisë
shoh: kati im i katërt herë kat i parë herë kat i trembëdhjetë
hyj në shtëpi të huaj
Një karrige luhatet para dritares së gozhduar
gruaja e paNjohur
tri net pa i kaluar me mua
aborton
në ajër vizatohet koka
koka e Lumit tim
në ajër në hobe
Atje poshtë Evropa shikohet në pasqyrë dhëmbët pastron
ha me qen fle me qen dëbohet me qen vdes për qen
flet për humanitet arte defilozofim
te një krua gjak i pikojnë duart
dhëmbët prapë i shkëlqejnë e një vazhëz mbyll dritaren
Ujana nuk shikohej prej LuleLumit
Evropa lakuriqohet
nëpër syze rafteve gozhdave ndryshket logjika

nga trupi i tij i Gjergjelezhalisë
shkëputet hija ime
varr i gjallë

një grusht dhë një grusht dhë ju lutem amin
amin

Dikush ndez llampën dhe shoh pastruesen si e lan
edhe shkallën e fundit

më në fund Dreni e paska qëlluar miun e kuzhinës

E pranoj nuk kam bërë kurrgjë për Lumi

bile as sa të zitë e thonit

vazhdimisht e kam ngacmuar:

Lumi a ta bëjmë këtë Lumi a ta bëjmë atë

a t'i

por Lumi Lumiii

Pse moj grua e vë atë shami të zezë

kur i kemi fëmijët e tjerë *Pse*

Lexoj në shtyp: një vashëz u mbyt në Ujanë

nga pikëllimi i madh i brigjeve

Për besë nuk është e vërtetë se nuk e kam dashur Njerinë

vetëm kam dëshiruar të ndryshoj

mënyrën e jetesës sime e asgjë tjetër

më mirë këtë le ta thotë vetë Lumi im

kur të kthejë një mëngjes

kur të duket një mbrëmje
me sy plot QiellTokëBleruarKaltruar
më kanë thënë prapë e bart kokën në shpinë
në Had e kanë parë e kanë parë në Albulenë
Vetëm njëri sy të më mbet çel'
nuk mund të besoj Lumi
se ti se ti...

KËRKON ATË QË NUK MUND TA GJEJ

Lumi
Ti kërkon diçka
që kurrë nuk mund ta gjej

Ti kërkon diçka që moti e kam humbur

Pse Lumi
gjithmonë kërkon atë që nuk mund ta gjej
kur e di
jashtë lëkure nuk mund të dal

Mirë e ke Lumi
vetëm vazhdo me tënden ti
unë megjithatë deri në vdekje
do ta kërktoj atë që e humb

DERISA S'E KA ZËNË NATA

Fitores, sime shoqe

Ajo kthen nga beteja që nuk e njeh historia

Mban mend të gjitha datat stinët kohët
Kur filloi Si filloi
Krizat Lëvizjet Frymëmarrjet
Rëniet Ngritjet

Është nënë

Lëreni ta përfundojë udhëtimin rreth asaj krijese
derisa i ka të gjalla kujtimet
derisa s'e ka zënë nata

Kohë i duhet të harrojë gjithë ç'ka parë e përjetuar

Mos e trazoni
tërë jetën u përcjell
hija e saj

Ajo kthen dhe di ç'do të thotë të humbësh betejën

Nënë është

31 dhjetor 1981, Ulpianë

ME JETUE

Tim bir, Lumit

Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më larg se Unë

Prandaj:

Bukën ta pjekësh dy herë nën saç
Ujin ta ziesh deri në shkallën 99
Derisa të mbetesh ti i vetmi kërthi në ajër në kohë
në kosmos

Ti dhe Uji
Diellin ta shikosh nga hija e plepit
dhe ta masësh
kur hijen tënde s'mund ta kapërcesh më
Qenit ruaju se të kafshon ajo kafshë shtëpiake
besnik i madh i Njeriut
Nga kafshimi i gjarprit mund të shpëtosh
Macen nxirre nga fjalori yt gjithsesi
Ajo s'është simbol i kohës sate as i artit tënd

(Unë gjithmonë ia kam frikën edhe Lules edhe Femrës)

Kur të flasësh fol të dëgjohesh në bjeshkë
të dëgjohesh në shkretëtirë
Për të dytën herë mbetesh pa kokë ose kush nuk të beson:
Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: I pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam Unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrame
për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë të natës
në pikë të vapës
Asgjë mos rrit asgjë mos krijo me dhunë
Rasti i humbur nuk je edhe pse pylli
dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë

dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
e saj e zezë

Bashkudhëtari im

Ta provojmë vetveten derisa kemi frymë

1979

VISHKULL

Kam vetëm
vetëm kam
dhe kam vetëm
vishkull jam
Zot nëse je

PARISI, VENDLINDJA

Do të hyjmë në paris
gurin tonë aty do ta ngulim
nuk do të na presë teuta genti
nuk do të na presë hordhi e egër romake
nuk do të na presë njeri i gjallë
në paris do të hyjmë
ëndrrat do t'i varim në krahë të lejlekëve
te një krua do t'i lajmë sytë duart lythore
do t'i lëmë netët ballkanike pas shpine
 vallet këngët baladat përrallat
vetëm fyellin do ta marrim
t'i biem kur të na rrokë malli
 kur humbim në grumbullin e klosharëve
 të hijeve
 të minjve
deri vonë rrugëve të parisit në metro marramenthi
do t'i marrim erë ftoit të vendlindjes
për kohët pis do të flasim me gishta
nuk do të shkelim asnjë mizë
nuk do të trembim asnjë zog
nuk do të derdhim zjarr vrerë
 mbi kokë të njeriut

Evropës së përgjumur s'do t'i përulemi
as perëndive të krisura
ma jep besën Lum Lumi
se nuk do ta harrojmë vendlindjen

Paris, maj 1981

NËN DRITARE DIGJEJ PARISI

Net të tëra nuk flija
nën dritare digjej parisi
shanselize sheshi konkord opera
kulla e Ejfelit harku triumfal orli notër dam
shpërnguleshin në nëntokë mjerë romantika
iknin me trenin e parë me trenin e mbramë
të verbër topallë gërrbana qyrrana tullacë
mullacakë
të rralluar të krisur idiotë gjeni gjysmëgjeni
shkrimtarë
muzikanë piktorë varrtarë disidentë pederë
fauna flora e paparë në asnjë kopsht zoobotanik
nga degët saltomortalet më të çuditshme të majmunëve
binin pa krye
dikund

art i madh francez evropian panair ndërkombëtar

mbyllja sytë hundët veshët shtrëngoja dhëmbët
bërtisja në ankth
por gjithçka ishte e shurdhët memece

megjithëse parisi varrosej përsëgjalli
me tërë bërlllogun parfumerinë neverinë
grua e lëshuar
ti flije thellë në gjumin ballkanik këmbekrye bashkë
asgjë s'të pengonte as zëri tmerrues i nëntokës
as mjeshtria e çollakëve në zë
ç'ëndërroje vallë
athua ëndrra jote i ngjante ëndrrës sime
a ishte e bardhë o zot a kishte diçka të Kosovës

vështroja qiellin e rëndë të ftohtë: asnjë zog
qielli thua për inat më shtypte palmuç më bënte
frymën ma prente
më përplaste për mure derisa llastik bëhesha
mos isha send i harruar në udhë

e nën dritare digjej parisi
thellë në natë në qenie trenat rrapllonin
bartnin ëndrra gjithfarë ngjyrash këmbë të djegura
të përgjakura duar të sakatosura koka të çara
sy të zgurdulluar
sy pa bebza të errët dhëmbë të grirë në havan
mijëvjeçarë

zorrë të copëtuara për qejf bodrumeve
kasaphaneve mesjetare
zemra të kafshuara-helmuara brinjëmushkri
mëlçi kanceroze
dhe
nuk mbaj mend një kohë të ketë pasur aq
shumë xhenaze
mbi dhé të pavarrosura

ti ngriheshe mbi re e unë thosha: Lumi është
i thellë
i pashtershëm
i pakapërcyeshëm
dhe përplasesha për mure korridoreve të
ftohta të errta të panfundta
ikja prej vërshimave ëndrrave zjarrit
kohë e gjimnastikës antikë na ish
në fytyrën time të verdhë të përgjumur pështyja
vizatoja fytyrën e vendlindjes
shkelja hijen time të shalakatur

shaja në zot shaja në nënë

hapësia e kuqe vetëm vilzhyifi

e ti Lum Lumi s'u përngjaje aspak lumenjeve të maleve tona
më tepër një krijese fantastike
dali shagali ç'do gjë të kërkonin më shumë nga një
lëvizje jote mahnitëse
në qiellin e lodhur të parisit

në ashtin tënd më e thellë ishte dhembja jote shëtitëse
se çdo gjë misterioze e senës
më e rëndë se ngjyra e zezë e trenave që bartnin
parisin e metastazuar shtatzaninë e shekullit

dhe besoja në bukurinë tënde se do të mundë çdo gjë

por ç'bukuri është ajo lum vogëlushi
kur edhe nuk vyshket

ti ishe njeri i gjallë prej gjaku prej mishi
net të tëra nuk flija
zhantiji i humbur në hapësirën gëlltitëse
të tmerrshme të vdekur

e nën dritare digjej parisi

Paris, 5.IX.1981

TË DUAN LUMI

Të duan Lumi
kur ti hesht
kur ti nuk kërkon asgjë

kënga jote e pakapshme
për veshin e trashë
të tmerrshme shkronjat e tua
dhe poeti yt dhe vrapi yt

sapo harron
dy herë dy
mund të bëjnë edhe katër
ta luajnë gurin në hapësirë

dhe të duartrokasin
kur ti humb
Lumi

TE SHKOSH NË BEJRUT

Në vitin njëmijëntëqindekatërdhjetenjë
Dikund në fusha të djegura të Sremit
Dikund në pyje të errta të Sharrit
Ra luftëtari ynë i lirisë

Ti heq shpirt me kokë në jastëk
turp vogëlushi
Im

Ke mundur tekefundit të ngjeshësh armët
e Asimit
E të shkosh në Bejrut
Të vdesësh për Palestinën

Korrik, 1982

VDEKJA ISHTE MË E SHPEJTË SE UNË

Ishe larg shumë larg Lumi
këmbët më ranë bërrylat m'u përgjakën
duke të ndjekur

Tash je larg tepër larg
vdekja ishte më e shpejtë se unë

Ulpianë, tetor, 1982

FLETË E BARDHË

Mbi tavolinë
fletë e bardhë aty do shkruar:

Lum Podrimja vdiq më 29 shtator 1982

por unë nuk mund ta nënshkruaj vdekjen tënde
në qenie të ndiej si lëviz si merr frymë
të shoh në jetë
gjithkund

vdekjen tënde nuk mund ta nënshkruaj vogëlush

varrëmihësit le ta qesin emrin
ose bardhësia le të më mbulojë edhe mua
të tërin

Ulpianë, tetor, 1982

E TI I VDEKUR

Ishte verë
Mbi kokë dielli
Hije ti rreth Evrope

Nga ai udhëtim i tmerrshëm
Ktheve 'i ditë syzgurdulluar
Në poezinë e babit hyre pa trokitur

Aty je më i sigurt Lumi
Për besë nuk të gjen
Asnjë e zezë

Verë ishte
Dielli në perëndim
E ti i vdekur dhé

PIKËLLIMË

Unë nuk qaj
shi bie vogëlushi im
shkundet plepi i shtëpisë

Unë nuk këlthas
nën dritare vogëlushi im
coft ra korbi i Edgar Allan Posë

Unë nuk luaj vendit
muret lëvizin sendet vogëlushi im
vjeshtë e keqe mori

Re e zezë shtëpinë tonë mbështoll.

Sharr, 1981

UNË NUK JAM AI

Ai pranë dritares
nuk jam unë
është jot ëmë
që të kërkon në turmë

ai në fund të dhomës së errët
nuk jam unë
është yt vëlla
që përmallshëm fyellit i bie

ai para pasqyrës
nuk jam unë
është jot motër
që flokët shkurton

Lum Lumi
unë jam ai që derën hap

FILLIKAT VETËM

Shkove një bregu që ndante
jetën dhe vdekjen

ishe i vetëm dhe i qetë
kur të afrohej zjarri

në mbarim të verës mbylla derën
mos ta vrasë kush ëndrrën

fillikat vetëm ishe
tmerri i Zotit

FRAGMENT

Ike
Por
të gjallët
ende s'i lë të qetë

MYSHKU, EMRI

Në Bregun tim nuk dukesh
as nuk të lag më
valë e Lumit tim

Sorra të dergjura
grimcojnë
ëndrrën

dhe myshku ha emrin në gurë

E KLITH NË ËNDËRR

I bukur vetë Zoti
Ku tërë kjo hijeshi
Paska rënë nga qiejt
a dalë fundit të dheut
Ku tërë kjo frikë
Në sytë e tu Lumi
Errësi e ujërave
Ftohtësi e Hadit
Bie pranë meje e s'di
Zgjohet kush E fryma jote
Thyen e rrapllon mureve
Edhe Zotit ia shkove
Të paNjohurës i afrohesh
Unë mbyllem në dhimbje
E klith në ëndërr
Dëgjon vogëlush?

29 shtator 1982

NJERIU ME PLAGË NË KOKË

UJI I MADH

Rrëshqiti edhe Bregu
Qeni cofi duke lehur
pas Qiellit pas Tokës
ujë i madh e i zi
rrënjë rrjeta
dhe gjumë

koha e notuesve a perëndoi

DALJE NGA RRETHI

Gjarprin qëlloje në kokë
Bishti është vdekjeprurës
Peshojë atëherë lirinë
Nuk ka gjë që të zhduk

HARRIMI

Dele dele dele

e

Tufën kërkon

Bariu

ZARI

Të bëhet
Se je fitues
Veç ti ke hyrë në lojë

Të bëhet
Se dole në breg
Uji të ka bartur kushedi se ku

Të bëhet
Se jeton më në fund
Ti i harruar tashmë nën bli

Zari është art
Ai që e hedh
Ndan edhe humbjen

SHENJA

E shënove cakun
mos e le
pa e rrëzuar

Shkrehe derisa ta qëllosh

Nuk të shkrep
fatkob je
qyqe

Nuk kanë me të k'nue

VETMIA

Bota mbet
planet i mërguar

lule e heshtjes

maja e shpatës
në bebëz të dritës

vetëton

SHOFERËT E VDEKJES

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

Unë shoh kthesën që vështirë ta kaloni
Shoh engjëllin e zi që nuk mund ta mundni
Shoh çka nuk mund të vëreni nga timoni

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

I ndieni çarjet si ju kapërdijnë vazhdimisht
Forca si ju mashtron para cakut
E ndieni lëvizjen si ju nxjerr jashtë vrapimit

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

Në ankth mbani botën
dhe kohën teheve vezulluese
që pushoi kaherë në orën time

1978

VAPA

U nisa drejt diellit ora binte dymbëdhjetë
më parë nisa t'i humb gishtat e këmbëve të duarve krahët
pastaj rëra zu të ma mbulojë trupin fjalët ëndrrat
për pak kohë i humba të gjitha: drejtimet betejat qytetet
vetëm ora e thyer mbet dhe syri im çel'
buzë ujit të madh
dhe diellit
në zenit

FLAKA E VJEDHUR

Si e kafshoi gjarpri?

e Luanit i tha: hesht!
Luani ra në gjunj para shpatës së tij.

një mot thanë: kahmot s'kemi parë
një shfaqje kaq të çuditshme në cirkun tonë.

po vallë si e kafshoi gjarpri?

në qytetin tonë tregojnë tash fëmijët
se Ai shkoi të sjellë flakën
që një ditë me shi ia vodhën njerëzit

e si e kafshoi gjarpri?

Luanit i tha: hesht!
e Luani ra në gjunj para syrit të tij t'errët

VDEKJA

Ishe një copë akull
Të vija në kokë
kur më digjej balli
Por me vite e vite
Ma vodhe Zjarrin
Më preve në besë
Mërdhi tani
nën flakën tënde të kaltër
mbyllur në një klithmë njerëzore

DALLIMI

Dallimi në mes
Deles së Zezë dhe
Deles së Bardhë
është se

Delja e Zezë
hetohet nga larg
dhe hyn e para
në kasaphanë

Kurse Delja e Bardhë
lutet të ketë
pjellë të mbarë

Dhe të kthehet Gjahtari
nga Pylli i lebetitjeve
me Lëkurën e Ujikut

HIJA IME

Hija ime më mashtron
herë me orë nuk e mbërrij
herë fare nuk e hetoj

Ç'po ndodh me mua zotynë

Në horizont dielli sapo duket
zë në thua e bie diku
përtej hapësirës së bardhë

Unë sillem rreth vetvetes
po hijes sime besën nuk ia kam
Ta marr apo ta lë

HAPËSIRA

Gjithnjë e më shumë ndiej të rënat e hapësirës në brinjë

kaq shumë mullinj rrokaqitej përçues

fshatra qytete shtete

kaq shumë bardhësi rrënjë për një natë për një ditë imzot

djathtas majtas

më sulmon vazhdimisht më shtyp

shpërngulje prapë nga lart poshtë nëpër vapë ngricë

përbihet në mua e nëpër mua majat shemb

jashtë meje e kohës

pëlhura ngjyrash end

po frymë do të mbesë

në brinjë ndiej të rënat e hapësirës gjithnjë e më shumë

Bregut i afrohem

apo e paNjohura

më pushton

NJERIU ME PLAGË NË KOKË

Ka ditë ka vite ka shekuj
që njeriu me plagë në kokë
qëndron mbi tavolinën e bardhë të Spitalit

unë thaj lumenj liqenj dete
të arrij në fillimin e Plagës
kapërcej kobe zjarre

fundi thonë se i gjendet pas horizontit

ndal hovin e rrufesë
në shuplakën time
mushkëria e sëmurë të marrë frymë

liroj zogun e kuq nga plaga e tij

nxjerr thika
gjarpërinj
errësira

ka ditë ka vite ka shekuj
që njeriu me plagë në kokë
qëndron mbi tavolinën e bardhë të Spitalit

Plaga e thellë
sa çdo gjë humb
në hijen e saj.

FËMIJA VDES NË BODRUM

do të zbres njëherë atje poshtë
me pishë në dorë

fëmija vdes në bodrum
a dëgjon njeri

bukë e kripë do t'i ndajmë bashkë
duart e nxira këmbët e akullta
trupin e mavijosur
do t'i marr ngrykë

me hukamë e urata do t'i mbështjell

në bodrum vdes heroi i shekullit tim

do të zbres njëherë atje poshtë
me pishë në dorë

me minj me terr me shpirtra të shoqërohem
shoku im i vogël vdes
a dëgjon njeri

e perënditë e rrjedhëm grinden
kush do të ketë
hapësirë më të madhe për varr

VETËM PARA VETES

MORA UDHËN TË TAKOJ NJË NJERI

Mora udhën
të takoj një Njeri në grumbull
në Chams Elise bie fjala
apo në Kremlin
sa për të kaluar kohën
po vite u bënë që e kërkoj
dhe që s'flas

Paris, 1981

PËR DASHURI TË REJA
JETA ËSHTË TEPËR E VJETËR

Fjalët e humbën fuqinë magjike
për dashuri të reja
jeta është tepër e vjetër
kur kurrkush më s'mendon me kokë të vet

NË MBARIM TË SHEKULLIT

Në midis të Evropës
Në midis të midisit
Në hotelin Marriot të Frankfurtit
ku asgjë nuk mungon
dhe ku veten sheh në të gjitha pasqyrat
shkruan poezi për lirinë
i bindur për të satën herë
se në jetë megjithatë
diçka po munguaka
Natën e mirë Kosovë
Vdekja vazhdon të këndojë në Sarajevë
dhe kokë të prera njerëzish
t'i vijë peshqesh Evropës së fjetur

2.X.1992, Frankfurt

TORZO

Gjithkund kaloj e kurrkund s'jam

në ndonjë kohë po më takuat ndonjëherë
ju lutem mos më lini pa emër

BALADË PËR NJË QEN

Leh
vetëm leh
dhe sheh
vetëm një dru
e vite ka
që humb në Pyll
pas zërit të vet

NDJESË

Nuk janë yje vogëlushi im
kokarda janë sy të shqyer
vrer e terr majë thikash

nuk janë lodra vogëlushi im
tanke janë çizme hataje
Marshojnë nga ti rëndë o zot

Nuk janë sheqerka vogëlushi im
helme janë Dorë e Zezë
nateditë mbi ty i derdh
e temjan

Në këtë haklitje shpirti
ndjesë të kërkoj vogëlushi im
nëse ndonjëherë të kam rrejtur
se iku fashizmi

NGA “CUNGU”

(Formë ndërron, peizazh)

Cung i vetëm në pyll

a të zgjon era e jugut
mbi kokën tënde a fluturon zogu

të la qielli
dheu e blerimi

në mes të djeshmes e të nesërmes
formë ndërron peizazh

cung i vetëm në pyll

a i ndien vitet mordjen
ujin e zi në rrënjë

rri varr në kaltri
e syri të zmadhohet

cung i vetëm në pyll

RËNIA S'ËSHTË HUMBJE

S'është
rënia
humbje

humbje
s'është
me ra

s'është

cung
i vetëm
në Pyll

MIDIS XHUNGLËS SË BETONIT

As djalë as vajzë

Një mace shëtisin
ose një qen

Në sy të tyre të xhamtë
fotografojnë vdekjen

tinëzisht që i vjedh
midis xhunglës së betonit

Feldafing, 22.4.1992

NE TEATRIN E RI

Hans J. Lanksbit

Nuk bën të vdiset i uritur
Ushqeni njerëzit sa më mirë
Plumbi i kap më lehtë
Se Evropën e mbyti gjumi

Në metropole nuk shfaqet më
Shekspiri as Eskili
Ndizni TV dhe Sarajeva dhe Kosova
A nuk meritojnë duartrokitje frenetike

Në kasaphanë nuk shkohet
I zdashur i dathur i ligështuar
Lëndoni sedrën e Satanit me nam
Se Evropën e mbyti gjumi

Vdiset vetëm njëherë e Zoti
nuk i pranon viktimat të zymta
Përndryshe publik as xhelatë
nuk do të ketë në teatrin e ri

Feldafing, 10.7.1992

NGA “KALI I TROJËS”

Kthehu në vargun e Homerit

Kthehu në vargun e Homerit
kthehu atje prej nga erdhe
koha jote s’është kjo kthehu
liroji njerëzit prej vetvetes
e hijeve liroji prej maskave
e ikjeve liroji prej pagjumësisë
e heshtjeve liroji prej etheve
e shirave koha jote s’është kjo
kthehu në vargun e Homerit
Troja ra e marsejezën
kahmot s’e këndojnë njerëzit

VETËM OSE HAMLET I SËMURË

Pak po më jep jeta ime
e tepër po lyp nga Unë

të të jap s'mundem më tepër
se sa të të ngre në këmbë

s'mundem më tepër se sa të të jap emër
se sa të të mësoj të ecësh njerëzisht

se sa kohën time për ta falur
durimin e guri-zjarrin kaltrinë

s'mundem më tepër të të jap
e ti tepër po lyp nga Unë

në mes të verbërve vetëm jam
në mes të minjve perëndive

vetëm para vetvetes e ujit e murit
para dashurisë e urrejtjes vetëm

po ti tepër po lyp nga Unë
e pak po më jep jeta ime

o hamlet o hamlet po vijnë
mjekët me mantela të bardhë

me mantela të zezë po vijnë
për të të shëruar kokë e pafjetur e botës

HIJA E TOKËS

*Bajram Currit, Asim Vokshit, Ganimete Tërbeshit,
Emin Durakut, Mustafa Bakiut*

EPIKA

Me shekuj kam shitur gjakun
e rritur jam me gjakun e shitur –
me shekuj kam hëngër veten
e ditur s'kam të qesh me veten e tepruar...

Miq,
Kosova është gjaku im që nuk falet!

1. (Unë biri yt)

Unë biri yt, Kosovë, t'i njoh dëshirat e heshtura,
t'i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj,

t'i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet,
t'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua të kallura;

ta di gjakun që të vlon në gji,
dallgën kur të rreh netëve t'pagjumta
e të shpërthejë do si vullkan –

më mirë se kushdo tjetër të njoh, Kosovë,
Unë, biri yt.

2. (Shtëpia pa qetësi)

Shtëpia ime prej kashte, prej balte;
shtëpia ime prej vuajtjeje;
shtëpia ime prej gëzimi;
shtëpia ime me një bisht dhie.

Gjel, kur ti kërcen tra e m'tra
thonë – moti ndërron
gjeli im i untë
kur ti kërcen tra e m'tra.

Shtëpia ime prej kashte, prej balte;
shtëpia ime prej vuajtjeje;
shtëpia ime prej gëzimi –
shtëpia ime pa qetësi.

3. (Hija e tokës)

Ara e misrit është kallur

(nata si kalë hamshor vrapuar ka
jashtë e brendë shtëpisë sime,
me mua vrapuar ka
e ara e misrit kallur është)

dhe livadhi rrëzë shtëpisë
dhe vreshta ime e vogël
dhe plepi –

gjithë natën e lume kallur janë
me sytë e mi të përgjakur.

Ara e misrit është herrur,
plepi ka rënë
dhe zogu im i mbramë.

Unë kam kafshuar heshtjen
derisa vdekje pikoi.

- O, si ta ndjell atë zog të bardhë,
si të bëhem dritë, o vëlla, mbi varrin tënd?

Medet, blerimi na i dogji krejt
fushat e bukës
dhe livadhet tona.

4. (Përtej dhembjes)

Kam rënë degë e thyer prej reje në trupin tënd
të shituar, Kosovë.

Konaqet e tua deri në themel po rrënohen,
e përtej dhembjes do britje shemben me ballin tim
me krahët e zogut tim të vrarë, me dashurinë
e njerëzve të mi të kallur etjeje.

Rreth trupit tënd si gjarpër mbështjellë jam
vatrat e shkimbura për t'i përflakur,
duar e këmbë t'i lidh me lëmshin e përrallave të tua –
se s'të lëshoj gjallë me gjak pa të larë pëllëmbë për
pëllëmbë, eshtra e jetë në ty pa i lënë,
konak e më konak pa të ndezur flakë...

Kam rënë degë e thyer prej reje në trupin tënd të
shituar – prej pushkës kobzezë, prej pushkës
së padukshme...

Cila do të jetë kënga ime e mbrame dhe fjala e fisit tim?
Plepi i shtëpisë sime u dogj, ku t'i preh sytë,
ku ta shuaj flakën e ujës për ty, Kosovë?

5. (Ardhësi)

Dikush trenisht nget ta shkimbë shkëndijën e ballit tim
dhe sytë e tu,
dikush trenisht m'i kall rrembat e trupit e
një nga një m'i vret zogitë,

dikush prej agimit n'agim, prej muzgut në muzg
veten kapërdin buzë një uji të madh –

unë, e unë ende emrin s'ia mësova e një ditë me
bubullimë hyri në Kullën tonë...

6. (Rrëfimi)

Nëna ime vdiq,
n'drit' të syve duke u betuar, në kryen tim e të vëllait,
në koren e bukës e kripë –
nëna ime e dashur.

Babai im u vra në mexhë të arës me fqiuin grabitës,
vadën duke e ndalur për livadhin tonë, për arën –
për bukën e motmotit,
e vëllai im kurrë s'u kthye prej mërgimit.

Motra ime nëntë ditë rrugë larg u dha,
atje kullën e gëzimit ngrehu –
këngën e vajit kalli.
E unë çdo ditë prita atë ditë të vonuar.

Nëna ime, babai im, motra ime, vëllai im pa emër.

7. (Një natë nga netët pa gjumë)

Zgjoju, Kosovë! Zgjoju, nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur –
zgjoju, oj! A po e ndien vajin tim?
A po sheh si t'i kam ngulur sytë
mu në zemër, mu në shpirt,
si t'i kam hedhur duart rreth belit
për të përqaftuar, unë – ashti yt?
Zgjoju, Kosovë!

Nga degët e mia të thyera kush po bahet,
këtë vatër kush po e le?
Ç'janë këto gjurmë gjaku që po shtohen
nëpër fytyrën tënde,
këto varre e murana që po sillen vërdallë
rreth shtëpisë sime?..
Zgjoju, Kosovë! Zgjoju, nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur –
zgjoju, Kosovë!...

Sonte vetëm mbeta e –
në derë t'oborrit askush më s'po më troket,
askush më, thua vdekur jam e harruar
në këto troje e suka gjaku;

thua më është shkimbur hisja
e mbyllur dera e konakut..
Zgjohe, Kosovë – flakë e hershme e ashtit tim
t'pëlcitur,
Bota në ty le të kallet!

8. (Kah rridhte gjaku)

Toka jonë orë e kohërave.

Në mënyrë të Çuditshme
jetonim ne të ndjekurit,
ne të vrrarët
nëpër shekuj e ëndrra.

Dhe sa mendonim se hijonim
shkilte gjaksori në tokën tonë,
na i digjte flakë bajraqet,
shkilte – natë ujku ...

Ne shkilnim gjurmëve të një kalorësi
pas një nuseje të plakur në përrallat tona,
ne dasmorët e dasmave të mallkuara,
shtegtonim kah rridhte gjaku –

Se toka jonë orë e kohërave.

9. (Varre lanë pas)

Një ditë më thanë:

Ndërroje ngjyrën e syve,
sytë e tu ngjyrën e gjakut kanë,

- ndërroje, shi do të bjerë
e toka do të kallet prej etjes...

Dhe kaluan mbretër,
sulltanë, kaluan gjeneralë –

në bukën e kripën time
pështynë e shkelën rëndë,

varre lanë pas
varrë lanë pas

dhe
shi

Unë hodha një gur në hapësirë.

10. (Dua të jem)

Nganjëherë dua të jem lumë –
të rrjedh nëpër damarët e tu,

gemb ëndrre dua të jem nganjëherë –
dita e nata jote të pushojnë n'mua,

nganjëherë dua të jem ti oj –
heshtjet e shirat e kohërave t'i ndiej,

dua të jem etje nganjëherë –
ujërat e tua deri n'pikë t'i pi.

KURRKUSHI JAM PA TY

LITARI I ANKTHIT

E lirë Kosova dhe e pavarur
Me një litar rreth qafe
Kërkon degën më të lartë

Si dele nuk dilet në pazar
Nëpër fjalë se ç'dridhet
E zënë midis dy qytetërimeve

Nuk e mban litari as e lëshon
Si përrallë kallëzohet
Në konferenca ndërkombëtare

E s'e lëshon as e mban një litar

Ulqianë, 9.10.2000

ETYD PËR SHQIPËRINË

Xhuxhe je
Xhuxhe je moj
Pa mua

Dhe kurrkushi jam moj
Jam kurrkushi
Pa ty

Frymë e trup
Kush na i nami
Nën kupë të gastartë

Shqipëri moj
Pikë uji
Në shuplakë të t'eturit

SHQIPËRIA NUK ËSHTË FJALË GOJE

Shqipëria nuk është or zotëri
Nga Presidenca e Mejdanit
Te Kulla blu e Berishës
Po ç'kap syri e ledhaton dora
Zallishteve ku e dashura ime
Ndërron lëkurë pas fluturave të diellit
E flad i bjeshkëve e këndell
Në Fushë të Mëllenjave
Shqipëria nuk është or zotëri
Fjalë goje
Prizrenit rrjedhës së Drinit të Bardhë
E te Uji i Madh
Nga lashtësia ç'bën të udhëtojë
Te Presidenca e Kulla blu
Të bësh dashuri paske harruar e dashur

KOHA MOS ËSHTË ME SHKUE ENGJËLLI IM

Ka mundur të ndodhë Atlantida Shqiptare
Në kujtesë imazhe trishtuese
Krujë e Shkodër e Drini
Të mbyllet çështja e Kosovës
As për UÇK-në të flitet gjë
Të dihet për Bllacë as për varreza masive
Mes shkundullimave tokë e shkretë
Të kërkojë Krijuesin e vet
E pabesueshmja të mbretërojë
 Kaos (ndër)kombëtar
 Vezullimë e syrit muranave
Mali i Pikëllimës ka mundur
Të derdhet deri te Uji i Madh
Të ngryset Atdheu pa u zgjuar
Morti të mbështjellë qiell e tokë
Si hata biblike të kallëzohet
Po të ishte vonuar një njeri
Të gjitha i cili i di e nadjepërndaje
Pi kafënë në ballkonin kah qielli
Të planetit të varur në një litar
Puth vetminë në lule të ballit

I lumtur se ka bërë diçka për Atdhe
Një këngë të moçme ia thonë dikur
Në murin e djersitur kurdis orën
Koha mos është me shkue engjëlli im

Cyrih, maj, 1998, Ulpianë, 2000

SHQIPËRITË

Dr. Pandeli Çinës

Na tmerruan shqipëritë
Edhe tej e tej e tej
Vare e nishana pikëllues

Në ëndrra pikëlojnë sy
Një asnjëherë o perëndi
Të ketë 'i kërthizë guri

Të dridhen tokeqiell
Kur të dëgjohet në log
At e bir e i shenjtë të betohen
Nadjembrëmje

Na bënë pikepesë shqipëritë
Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen
Vaji na është këngë

Frymë bëhemi e nga 'i grusht dhé
Duke i kërkuar të uruarat
Nëpër harta tragjike

Tiranë, nëntor, 2001

NË KOHË KAOSI

Pastroni shpirtin
se pastroni fjalët

Pastroni sytë
në univers zbuloni vrimën

Ngujohuni në brendi
derisa palaçot të lozin zotat

Dhe binduni pastaj
se u jetuaka edhe në litar

2001

GUASKA

Dikur ishte shfaqur Shkretëria dhe kisha dëgjuar vajin e Burrit të Dheut. Kisha përvjelë pantallonat dhe isha nisur pas zërit të Fyellit, Uji i Madh kishte nxjerrë një guaskë nga fundi i mistershëm. Fillova ta hap. E pamundur. Guaskë pas guaske zbuloja fatkeqësitë e dherave të Arbërisë...

Vlorë, 1992

SHPREHJA MODERNE E ETNISË

Thellësitë e vetëdijes

Zëri poetik i Ali Podrimjes ka qenë një bubullimë e vërtetë në poezinë shqipe bashkëkohore, si me lëndën sublime dhe tragjiko-heroike që mbart ashtu dhe me ushtrimën e madhe që sjell nga zgafellat më të thella të vetëdijes kombëtare. Dhe si një bubullimë që lajmëron motin e mirë në mes të acarit, zëri i tij jo vetëm e ka parathënë, por edhe e ka përgatitur ditën e etnisë, ditën e madhe të kombit shqiptar.

Poezia e Ali Podrimjes në qendër të saj ka emblemën e etnisë shqiptare, megjithëse është krijuar në Kosovë nën censurën nacionaliste serbe. Poezia shqipe që shkruhej në atë periudhë, sidomos në Shqipërinë shtetërore, por edhe në trojet etnike në ish-Jugosllavi, rrallë e kapërcente kufirin politik që i ndante shqiptarët, pasi ai ishte edhe caku i fundit i lirisë dhe i horizontit të krijimit. Disa autorë nuk e kapërcenin atë për shkak të censurës dhe disa të tjerë për shkak të vetëdijes së tyre të gjymtë. Ndërkaq, vetëdija e Ali Podrimjes nuk ka njohur kurrë as kufij politikë dhe as kufij krahinorë brenda hapësirës shqiptare, por i ka rrafshuar ato për të rikrijuar dhe plotësuar etninë shqiptare, tërësinë e kombit në krejt shtrirjen e tij historike dhe gjeografike. Asgjë e rëndësishme prej gjeohistorisë së etnisë shqiptare nuk ka qenë e largët dhe aq më pak e huaj për poezinë e tij, përkundrazi, tiparet më përcaktuese të saj, bëmat e lavdishme, ngjarjet dramatike dhe tragjike janë shndërruar në sisteme origjinale

metonimike, metaforike dhe simbolike që kanë pasuruar poezinë shqipe.

Dhe dihet se poetët që krijojnë dhe rikrijojnë shëmbëlltyrën e kombit në një poezi origjinale dhe të nivelit më të lartë, sikurse është edhe vepra e tij, fitojnë meritueshëm aureolën e poetit kombëtar. Rilindësit krijuan shëmbëlltyrën ideale të atdheut, kur formohej kombi shqiptar. Ali Podrimja ka rikrijuar shëmbëlltyrën e shenjtëruar të etnisë dhe të kombit shqiptar kur ato ishin të copëtuara politikisht dhe mjaft të mjegulluara ideologjikisht, prandaj poezia e tij në mendime është vizionare, paraprijëse, tepër ndikuese dhe e popullarizuar në të gjitha trevat shqiptare.

Metonimia simbolike etni-atdhe

1. Harta poetike e historisë

Shëmbëlltyra poetike e etnisë shqiptare është ndërtuar mbi *hartën* e saj historike, jo vetëm për të pohuar të vërtetën, por edhe për të kundërshtuar hartën politike të copëtimit të saj në bashkëkohësi. Në këtë shëmbëlltyrë njësohet *etnia* me *atdheun* dhe *atdheu* me *etninë*, që ndërsjelltas janë metonimi të njëra-tjetrës. Këto metonimi të pandashme janë themeloret. Me to ndërtohen sistemet kryesore metaforiko-simbolike të kësaj poezie. Kështu, Ali Podrimja përtërin hartën poetike të etnisë-atdhe që patën krijuar Naim Frashëri, Gjergj Fishta, etj. Megjithëse vetëm e përtërirë, *harta poetike e etnisë-atdhe* përbën një risi të madhe në poezinë shqipe bashkëkohore, sepse ka thyer skemën e atëhershme letrare, që edhe si temë, etninë e shëmbëllente të copëtuara, veç Shqipërinë shtetërore, dhe veç Kosovën me trojet e tjera shqiptare në ish- Jugosllavi. Ishte vetëdija e tij kombëtare që shkelte tabunë politike më të rrezikshme, por ishte edhe një guxim jo i zakonshëm që, për hir të vetëdijes kombëtare, merrte parasysht çdo sakrificë.

Mbasi të marrët ma derdhën etninë, thotë Ali Podrimja në një bisedë më 1999, nuk më ka mbetur tjetër veç të krijoj gjeografinë time poetike. Çdo skaj i etnisë është pikëmbështetja e ekzistencës sime si krijues e njeri.¹

Etnia-atdhe dhe atdheu-etni nuk paraqitet në trajta rrëfimtare e përshkruese, siç është paraqitur në poezinë e mëparshme, por në mënyrë metonimike dhe metaforiko-simbolike, prandaj shëmbëlltyra e saj është tepër e përmbledhur dhe sintetizuese, vetëm me shënjat kryesore dalluese.

2. Bukuria e idealizuar

Te cikli *Guri* (në këtë libër është me titullin *Askujt s'i falem sa forcës satë*), ndër më të arrirët në poezinë e Ali Podrimjes, fjala *gur* përbën një sistem të madh metonimik dhe metaforiko-simbolik më vete, të rëndësishëm e të ndërlidhur fort, po edhe aq të pavarur sa, me të drejtë, cikli mund të cilësohet një poemë moderne, e përmbyllur në vetvete. Megjithatë, ky sistem original dhe i pavarur funksionon si pjesë përbërëse dhe brenda sistemit të përgjithshëm figurativ të etnisë-atdhe. Më e veçanta e tij është se mbart ngjyresat e mbijetesës, të qëndrësës dhe kundërshtimit të heshtur të asaj pjese të etnisë-atdhe, Kosovës, që ishte nën rrezikun e tjetërsimit prej kozmopolitizmit jugosllav. Etnia apo përkatësia kombëtare përmes simbolit metonimik është *gur*, sepse është tepër e qëndrueshme, e përjetshme, e rëndë, e palëvizshme, dhe, e pandryshueshme nga gërryerjet e motit të kohrave. Brenda këtij sistemi metonimiko-simbolik, *Koha e gurit* (poezia *Koha e gurit*) është koha e vetë etnisë, sikurse bedenat prej guri të kështjellave mbrojtëse janë bedenat e vetë etnisë:

*Te bedenat e tu
mbretër e sulltanë
ushtritë lanë*

*e kobërat sytë
njëra-tjetrës ia nxorrën
me eshtrat tona*

¹ Revista *Universi shiptar i librit*, 1999/1 (9), Bisedë me B. Kuçukun.

*te bedenat e tu
emrat tanë
ngrihen në këmbë*

Edhe koha e etnisë është tepër e lashtë, që prej kohëve parake dhe tejparake. Këtë e thekson vetë titulli *Koha e gurit*, që, për analogji gjuhësore përngjason me *epokën e gurit*, epoka më e lashtë në historinë e njerëzimit. Në një mënyrë krejt origjinale, me një metaforë simbolike rishprehet mendimi rilindës i poetizuar prej Naim Frashërit:

*Bota që kur është zënë
Shqipëria gjall ka qënë.*

Etnia, e shndërruar metaforikisht në *gur*, te *Pesha jote më tërheq kah toka*, është *forca*, është *drejtpeshimi* i qenies së saj, është *pesha e rëndesës* e bashkësisë shqiptare dhe e secilit. Ajo i tërheq dhe i mban të lidhur fort pas tokës së tyre, metonimikisht i tërheq dhe i mban të lidhur fort pas atdheut:

Pesha jote më tërheq kah toka-drejtpeshimi

Etnia me shëmbëlltyrën metaforike të gurit është edhe *përsosmëria, përkryerja, bukuria absolute: çdo gjë është e përkryer te ti.*

Ky është sublimim dhe *idealizim* i saj. Edhe pse guri-etni, me rëndomtësinë e tij apo në përditshmërinë e tij mundet të mos duket i bukur, në vështrimin e atdhetarizmit, në vështrimin e qenies së bashkësisë shqiptare është bukuria absolute, bukuria dhe përkryerja më e lartë, çka do të thotë se pikërisht ky është kulmi i përjetimeve, përgjërimeve, përkushtimeve dhe i vlerësimeve në poezinë e Ali Podrimjes.

Etnia në metaforën gur, në një nivel të dytë simbolik, te *Ç'guron guri*, është *vrimë e parë e fyellit tim*. Zëri i parë apo zëri kryesor i këngës së vet është *zëri i etnisë*.

Etnia ka njëherësh disa trajta simbolike: *gur* dhe *fyell*, që metonimikisht mbart radhazi edhe *melodi, këngë, shpirt, kulturë*, etj. *Fyelli,*

simbol i instrumentit muzikor më të lashtë, kohën e kulturës, të shpirtit, këngës dhe melodisë e njëjtëson me kohën e qenies së etnisë; kulturën, shpirtin, këngën, melodinë i shpie deri në zanafillën parake të vetë etnisë.

E, natyrisht, kënga-melodi e fyellit është e magjishme. Melodia e fyellit të Orfeut në lashtësi magjepste edhe drerët, zogjtë dhe kafshët. Fyelli është mjete muzikor për njerëzit dhe natyrën, për gjithçka që përbën etninë-atdhe.

Familja, fisi, gjaku janë, gjithashtu, metonimi të etnisë-atdhe. Ndërsa atdheu personifikohet me *nënë*, që është personifikimi më i pëlqyer në poezinë shqipe për atdheun dhe, herë-herë, personifikohet me të *dashurën*. Atdheu personifikohet në trajtat më intime me *nënë* ose me të *dashurën*, kur subjekti lirik shënon atin e fëmijëve, që metonimikisht është ati i brezave të shqiptarëve. *Nënë* dhe *e dashur* është mbarë Shqipëria, por, në radhë të parë, është Kosova, dhe, herë-herë, vendlinja e poetit, Gjakova.

3. Rizgjimi i lashtësisë

Nëpërmjet etnisë, që është abstrakte dhe historike, më shpesh rikrijohet atdheu konkret dhe i plotë në bashkëkohësi, me të gjitha gjymtyrët që i mungojnë, sikurse rikrijohet te *Fotografia jonë, etnia*:

*Me katër faqe drite të dua të plotë
Dielli kur të dalë majë Tomorit
apo tebut të Pashtrikut
të ma ndritë fytirën skaj më skaj
Gjuhës së Mëmës
deri në Dodonë*

Nyje t'i lidh Dri e Jon rreth Dheut

Nyje ka edhe kuptimin *komb* dhe anasjelltas. *Nyje t'i lidh Dri e Jon rreth Dheut*, subjekti lirik shprehet haptas për të njësuar (lidhur) Drinin dhe Jonin në një *nyje-komb*. Harta e etnisë-atdhe është rikrijuar me numeracionin metonimik të toponimeve: *Tomor, Pashtrik, Dodonë* si

dhe të hidronimeve *Dri* dhe *Jon*. *Tomorri* – mal në mes të *Shqipërisë* shtetërore, *Pashtriku* – mal në *Kosovë*, *Dodona* në *Çamëri*, *Drini* në *Veri* dhe *Joni* në *Jug* piketojnë kufijtë e hartës shqiptare, dhe metonimikisht formojnë Shqipërinë e vërtetë gjeografike. *Dodona*, tempulli i pellazgëve dhe më i lashti në Ballkan, si simbol i historisë dhe i kulturës, hartën gjeografike e shndërron në hartë historike, duke rizgjuar lashtësinë e thellë të etnisë. Kështu, numeracioni metonimik i simbolizuar nëpërmjet *Dodonës*, mbart njëherësh kumtumin gjeografik dhe historik.

Edhe te *Krijesë e verdhë*, nëpërmjet dy toponimeve, rikrijohet harta e etnisë-atdhe; këtë herë jo në histori, por në idealitet: *Janinë e Shkodër t'i lidh në një kërbhizë*. *Janina* dhe *Shkodra*, që metonimikisht mbartin *Jugun* dhe *Veriun*, përftojnë një kuptim më të madh e më të rëndësishëm si simbole të historisë, pasi, njëra ka qenë kryeqendra e *Jugut*, kurse tjetra ka qenë kryeqendra e *Veriut* para *Pavarësisë*. *T'i lidh në një kërbhizë* nuk është vetëm një dëshirë, por më tepër një qëllim, një ideal i apostrofuar. *Kërbhiza*, që është qendra e trupit njerëzor dhe organi i të ushqyerit embrional, në këtë poezi, është *kërbhiza e atdheut* të personifikuar. Subjekti lirik nuk pranon sot dy kryeqendra – *kërbhiza*, si në histori, kur *Jugu* dhe *Veriu* ishin të ndarë, por kërkon një kërbhizë kryeqendër, madje një kërbhizë-kryeqendër ideale që të jetë njëherësh *Janinë* dhe *Shkodër*, *Jug* e *Veri*.

4. Simbole të gjeohistorisë

Shëmbëlltyra etni-atdhe përftohet me ndërthurjen e dy lloj simbolesh. Një lloj simbolesh shestohet me *toponimet dhe hidronimet* kryesore të trevave shqiptare, sidomos të trevave të skajshme. Toponimet dhe hidronimet, që, në radhë të parë, janë metonimi, mbartin krejt trevat përkatëse. Por këto toponime dhe hidronime, duke qenë edhe shenja gjeografike karakteristike dhe përfaqësuese të këtyre trevave, janë edhe simbole, natyrisht, simbole metonimike. Toponime dhe hidronime të tilla simbolizuese janë: *Pashtriku* (*Kosovë*), *Ulciniumi*, *Toplica* (*Kufiri* i fundit shqiptar në *Veri*), *Drini*, *Shkupi*, *Tomorri*, *Ohri*, *Buna*, *Joni*, *Janina*, *Dodona*, etj.

Një lloj simbolesh, që është edhe më shprehës, shetohet me *toponime historike* diku dhe *legendare*, ku janë zhvilluar ngjarje kulmore të historisë apo janë shfaqur bëmat më të lavdishme, por edhe ku kanë ndodhur tragjeditë dhe humbjet, të cilat mbartin porosinë e tyre. Toponime historike simbolizuese janë: Shkodra ilire, Albanopoli, Kruja, Prizreni, Janina, Arta, Preveza (Çamëria), Vlora, Shkupi, etj, kurse legendare Rozafa apo Tomorri.

Kështu, shëmbëlltyra etni-atdhe ndërtohet si me simbole toponimesh, që sjellin hartën gjeografike, ashtu dhe me simbole toponimesh që sjellin hartën e fushëbetëve të lavdisë dhe të humbjeve, të qëndresës heroike dhe të tragjikës në histori. Shkurt, shëmbëlltyra e saj është shëmbëlltyrë simbolike e gjeohistorisë së shqiptarëve, sepse ndërthur simbole të gjeografisë me simbole të historisë, prandaj është tepër përfshirëse. Në pak vargje përmblihet edhe *koha* tepër e gjatë, që nga zanafilla e deri në ditët e sotme, edhe krejt *hapësira* e qenies së shqiptarëve. Këto simbole më tepër se nëpërmjet tekstit poetik zërthehen me anë të historisë së shqiptarëve, me anë të rrethanave dhe të ngjarjeve, të shkaqeve dhe të pasojave të tyre.

Subjekti lirik të *Shpirti i humbur* nuk shënon as banorin e Kosovës, prej nga është vetë autori, as banorin e Shqipërisë shtetërore, që janë hapësirat kryesore të atdheut të coptuar në bashkëkohësi, por shënon *trimin e Arbërisë me nam*, që i përket historisë:

*Vetëm një herë
më putbi në ballë
Më shitoi Zanë e Malit të Prerë
Mua trimin e Arbërisë me nam*

Arbëria, duke qenë principata në të cilën u formua shteti i parë shqiptar, është simbol i Arbërisë mesjetare, kur trojet nuk ishin copëtuar nga të huajt, prandaj *trimi i Arbërisë me nam* shënon përkatësinë kombëtare dhe administrative të shqiptarit bashkëkohës kudoqoftë, të banorit të Shqipërisë historike që nënkupton Shqipërinë e vërtetë. Për të shmangur thyerjen (copëtimin fizik) e shëmbëlltyrës

etni-atdhe nuk përdoren si simbole as Tirana dhe as Prishtina, pasi hapësira shqiptare ka qenë e copëtuar, kur këto janë bërë kryeqytete.

5. Rigjetja e vetvetes

Copëtimi i etnisë-atdhe, si dukuria më tronditëse dhe më tragjike e saj shprehet në mënyra të ndryshme, por shprehet edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me fjalët *gjymtim, cung* (*Fotografia jonë, etnia*) ose me përcaktimin *gjysma tjetër e Arbërisë (Vdekjes ia luaj syrin)*. Madje te *Marshi* përdoret përcaktori: *copëtuar* për t'u kuptuar prej çdo lexuesi: *Zgjimi i trupit të copëtuar*. Copëtimi në shkallën e parë figurative shprehet me metaforën e personifikuar të *tkurrjes së trupit*, me metaforën e *humbjeve*, të *qyteteve të humbura* ose *të hartës së humbjeve* apo me simbolin e një *rapi të çarë më dysh*, që mbin te koka e shqiptarit kur vdes, etj. Edhe kur emërtimet dhe përcaktimet janë me kuptimin e tyre të drejtëpërdrejtë, poezitë, në tërësi, janë metonimike dhe metaforiko-simbolike. Shprehja e drejtëpërdrejtë është e rrallë dhe, zakonisht, në vargje të veçantë, sa për të dhënë *çelësat* e hapjes së sistemeve kryesore metaforike dhe simbolike.

Edhe pse fjala *gjymtim* te *Fotografia jonë, etnia*, është në kuptimin e drejtëpërdrejtë, poezia përbëhet prej një sistemi të pasur metonimiko-metaforik dhe simboliko-personifikues:

*Gjymtimi yt pikëllon edhe në ëndërr
dhe na kujton cungun në pyll rrufesh*

Në poezi jepet *shkak-gjymtimi*, por nuk përcaktohen përmasat e tij, sa është, si është, ç'fuqi goditëse ka pasur, etj. Përmasat e gjymtimit, d.m.th. të shkakut mund të përfytyrohen metonimikisht nëpërmjet përmasave të *pasojave* të tij. *Pikëllon edhe në ëndërr* metonimikisht nënkupton një shkak me *përmasa të jashtëzakonshme*, me përmasa tepër tronditëse në psikologjinë e etnisë. *Ëndrra e pikëlluar, pikëllon edhe në ëndërr* është pasojë e një trazimi të thellë, që ka përfshirë jo vetëm vetëdijen, por edhe pafundësitë e nënvetëdijes, pra, pikëllimi është i jashtëzakonshëm, zotëron ditën dhe natën, përderisa shfaqet edhe në ëndërr.

Ndarja mëdysh e etnisë-atdhe te poezia *Si e kemi zbuluar detin* shprehet fuqishëm nëpërmjet simbolit të *Atlantidës së përmblytur dhe të humbur*. *Si e kemi zbuluar detin* është një poezi antologjike e kërkimit dhe e gjetjes së vetvetes që quhet etni-atdhe. Poezia ka gjithsej 25 vargje, por në to janë ndryrë shumë mendime dhe gjendje emocionale. Sistemi metaforiko-simbolik i saj përfton edhe rrethanat tepër të vështira që kanë përjetuar shqiptarët, të cilat nënkuptohen në mënyrë eliptike, sepse janë rrethana të njohura historikisht. Këto rrethana janë në disa nivele:

1) Rrezikimi i humbjes së përrjetshme; 2) Atmosfera e mungesës së lidhjes dhe ndërlidhjes mes vetes apo mes pjesëve të copëtura të etnisë-atdhe; 3) Zbulimi i vetvetes; 4) Gëzimi kolombian i zbulimit të detit dhe të Atlantidës vetvete; 5) Tragjedia e apokalipsit të shkëputjes së pjesëve të vetvetes.

1) Kërkimi dhe gjetja e etnisë-atdhe shëmbëllet metaforikisht me zbulimin e detit të humbur dhe të ishullit të Atlantidës, ndërsa *humbja* është simbol i copëtimit, i ndarjes së saj. Zbulimi i tyre ka qenë një përpjekje mbinjerëzore kolombiane, sepse udhëtimi ishte me shumë rreziqe. Mbi *Rozafat*, anës detit, metonimikisht në Shqipërinë shtetërore, kishte *mjegulla* propagande, që mbulonin të gjitha brigjet, duke rrezikuar ta çdrejtonin anijen e kërkimit-ideal, por kishte edhe *erëra* dhune që rrezikonin ta përmbysnin atë. *Mjegullat*, *erërat* janë metafora dhe simbole të asaj politike dhe propagande komuniste internacionaliste që mbuloi me terr e çoroditje trevat e vetëdijes shqiptare për një gjysmë shekulli. Komunizmi në Shqipërinë shtetërore me internacionalizmin e skajshëm dhe titizmi në Kosovë dhe në treva të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, me politikën e ashtuquajtur bashkim-vëllazërim me popujt sllavë kanë qenë disa lloj *mjegullash*, madje kanë qenë të dendura shtëllunga-shtëllunga. Këto lloj *mjegullash* jo vetëm errësonin vetëdijen kombëtare, por ato krijoheshin për përjetësimin e ndarjes, d.m.th. për humbjen e vetvetes.

2) Poezia vetëm me dy vage mbart rrethanën tepër të vështirë që kanë përjetuar shqiptarët pas ndarjes, pas humbjes, dmth pas copëtimit, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur u ndërpre çdo lidhje dhe ndërlidhje mes Shqipërisë shtetërore dhe trojeve shqiptare

jashtë shtetit amë. Secila pjesë, andej dhe këtej kufirit, kërkonte mendërisht e shpirtërisht gjysmën tjetër:

*atë mrekulli tërë jetën e kërkuam
dhe tërë jetën na kërkuan me pishë.*

Na kërkuan me pishë thekson pasaçërisht një dhembje dhe një vuajtje të gjatë, sepse nuk është vetëm metaforë e kërkimit mes territ të *mjegullave*, por edhe e kërkimit të pabesueshëm, legjendar me këmbëngulje dhe vuajtje diogjeniane. Të dyja palët me cilitje pambarim, *tërë jetën*, d.m.th. qysh kur *humbën*, kanë kërkuar njëra-tjetrën, kanë kërkuar vetveten e plotë.

3) Subjekti lirik shprehet në trajtën e shumësit – *ne*, si zëri i drejtëpërdrjetë i bashkësisë që kërkon dhe zbulon gjysmën e vetvetes:

*A ju kujtobet detin e zbuluam
kur dhëmbët na u ndërruan
Dhëpra kur harroi udhën
në Pyll të kthejë
...kur ngritëm
shkollat tona
kur vjershën e parë shkruam
për lirinë Skënderbenë*

Rrethanat, faktorët, rruga e gjetjes së vetvetes etni janë shndërruar në metafora dhe simbole origjinale.

Kur dhëmbët na u ndërruan është metaforë e kapërcimit të bashkësisë prej fëmijëri-adoleshencës në rini dhe në pjekuri, është metaforë e formimit të vetëdijes për të gjetur vetveten. Pikërisht, kjo është stina dhe mosha e zhvlerësimit të përrallave me *Dhëpra* të fëmijëve. *Dhëpra kur harroi udhën/ të kthejë në Pyll* është simbolikë në shkallën e alegorisë që përmbledh dinakërinë demagogji të përrallave politike me personazh kryesor *Dhëprën*. Por tanimë këto përralla nuk besohen: Dhëpra e *harroi* rrugën për në pyll. Ndërgjegjësimi për vetveten konkretizohet edhe më nëpërmjet metaforave dhe simboleve

më të thjeshtë, por me shumë kuptime. *Shkollat tona* (kur ngritëm shkollat tona) është simbol i dijes dhe, njëherësh, metonimi e gjuhës amtare shqipe, për rrjedhojë është edhe simbol i vetëdijes kombëtare. Po ashtu *nyersha e parë* është jo vetëm simbol i lirisë së shprehjes, por edhe i aftësisë së krijimit për vetveten. Liria e kësaj bashkësie është liria e etnisë-atdhe, prandaj njësohet me Skënderbeun që është simbol, madje është emblemë historike dhe tradicionale e bashkimit të shqiptarëve.

4) Përplekja e zbulimit ka qenë mbinjerëzore, kolombiane. Ashtu, kolombian është edhe gëzimi kur gjendet Atlantida që simbolizon pjesën tjetër, pjesën e humbur të etnisë-atdhe. Atlantida shqiptare metaforizohet edhe me *mrekullinë*, me më të bukurën dhe më të pabesueshmen. Vargu *atlantida atlantida atlantidaaa* është ndërtuar në përngjasim me britmat e detarëve kur shohin tokë, që, natyrisht, të kujton edhe britmat e detarëve të Kolombit kur zbuluan Amerikën. Ky varg fare i thjeshtë, i përbërë vetëm nga një toponim, që shqiptohet në trajtën e britmës për gjetjen e *mrekullisë* e ngre gëzimin e bashkësisë në shkallën e gëzimit epokal, më të madh, sikurse ishte gëzimi i zbulimit të Amerikës. I përsëritur dy herë, në mes dhe në mbyllje të poezisë *atlantida atlantida atlantidaaa* ka vlerën e refrenit simbolik të këngës korale të fitores.

5) Edhe pse poezia *Si e kemi zbuluar detin* është për rigjetjen e vetvetes etni-atdhe, përmes simbolit të Atlantidës është ndërfutur në të tragjedia e apokalipsit të dikurshëm që e përmbyti atë. Atlantida shqiptare nënkupton edhe përmbytjen biblike shqiptare, të ngjashme me përmbytjen tokësore që fundosi ishullin e Atlantidës. Copëtimi i etnisë-atdhe, që metaforizohet me *humbjen*, po ashtu, simbolizohet me Golgotën e Kryqëzimit të saj:

Harroni edhe rënien tatpjetë Golgotës

Shqipëria e pafajshme dhe me të drejtën qiellore u *kryqëzua* në Golgotën e saj, që, në mënyrë eliptike, nënkuptohet fakti i njohur historik – Traktati i Londrës 1913. Kështu, shëmbëlltyra e humbjes shqiptare merr përmasa të jashtëzakonshme përmes dy simboleve

ndër më të fuqishmit në kulturën botërore. Njëri është *Atlantida*, simbol i përmbytjes tokësore më të madhe, kurse tjetri *Golgota*, simbol me shumë kuptime: simbol i dënimit me vdekje torturuese, simbol i dënimit me vdekje i pafajësisë, simbol i mëkatit të pashlyeshëm dhe i marrëzisë njerëzore.

Tërësia shqiptare gjendet në histori. Iliria është simbol i tërësisë dhe i plotërisë, prandaj edhe i ribashkimit të etnisë-atdhe. Pyetja retorike *A e gjeta rrugën për në Iliri, Nëno (Aletë e Korçës)* pohon rrugën e ribashkimit. Subjekti lirik me këtë pyetje retorike nuk pohon se ka gjetur rrugën për të vajtur në Ilirinë e lashtë, tridhjetë shekuj më parë, por pranon se rruga e Ilirisë së madhe është rruga e tërësisë, por dhe e ribashkimit, sikurse ka qenë në Iliri. Kurse metonimikisht, meqënëse Iliria ka qenë para dyndjeve sllave, pyetja retorike mund të përmbajë edhe kuptimin e një tërësie shqiptare, pa sllavë e pa pushtime sllave.

Domosdoshmërinë e tërësisë dhe të ribashkimit e thekson *humbja* në histori, që përsëritet si refren:

*Aleve të pafund të Korçës
si aleve të harruara të Ilirisë
ç'm'u shfaq harta e humbjeve të mia*

6. Pamundësia groteske e qenies

Copëtimi, gjymtimi është i padurueshëm, prandaj te *Etyd për Shqipërinë* skajohet, duke u paraqitur si pamundësi e qenies. Edhe pse me një ligjërim retorik dhe patetik, *Etyd për Shqipërinë* është e pasur në shtresat kuptimore dhe figurative. Ajo është një poezi aforistike si për rëndësinë e madhe të mendimit që sintetizon, ashtu edhe për formulimet poetike të shkurtëra, lehtësisht të citueshme dhe të recitueshme. Poezia është shestuar në trajtën e monologut të subjektit lirik përpara Shqipërisë, i cili ligjëron metaforikisht për *trupin* shqiptar, d.m.th. drejtëpërdrejt për marrëdhëniet jetike midis hapësirave shqiptare. Shqipëria shtetërore përmendet shprehimisht, duke u lënë për t'u nënkuptuar pjesa tjetër e trupit shqiptar. Këtë e lehtëson subjekti lirik që paraqitet në pozicionin e birit, që është njësuar me autorin, kurse autori njësohet me vendlindjen. Nëpërmjet autorit-bir

nënkuptohet vendlindja e tij, Kosova, që është pjesa tjetër e trupit shqiptar.

Ideja poetike kalon nëpërmjet një shkallëzimi ngjitës që pohon domosdoshmërinë e tërësisë së trupit shqiptar, atë që i mungon atij.

Në strofën e parë, nëpërmjet një litote groteske paraqitet pafuqishmëria, anormaliteti dhe shëmtimi i Shqipërisë, ashtu siç është:

Xhuxhe je
Xhuxhe je moj
Pa mua

Në botën e kombeve-shtete, ajo që njihet si Shqipëri është tepër e vogël, tej normalitetit, sepse nuk është e plotë. Ajo është e papërfillshme. Metaforikisht ajo është *xhuxhe*, jo vetëm e vogël dhe e pazhvilluar, por edhe e shëmtuar. Metafora *xhuxhe*, e përsëritur dy herë, dhe e shoqëruar me pashirmën, moj, që përmban edhe vuajtje-qarje, edhe ankesë, edhe mospëlqim, është pasojë e një gjendjeje emocionale padurimi dhe mospranimi për portretin e saj, pasi dhe i biri ndihet i nënvleftësuar dhe i shpërfilluar po për shkak të saj. Metafora *xhuxhe*, e huazuar nga përrallat me padrejtësi shtrigash dhe me vuajtje të të pafajshmëve, vetiu të kujton shtrigat politike që krijuan këtë xhuxhe të Evropës.

Subjekti lirik, që njësohet me autorin dhe me vendlindjen, po nëpërmjet një litote groteske, është *kurrkushi*, pa asnjë vlerë, pa asnjë rëndësi, madje i duket se ka mbetur pa përkatësi:

Dhe kurrkush jam moj
Jam kurrkushi
Pa ty

Përsëritja e përemrit të pakufishëm *kurrkushi* ngjan si refren i shpërfilljes së subjektit lirik prej të tjerëve. Përdorimi i tij në trajtën e shquar vë në dukje se përkatësia e subjektit lirik, para të tjerëve, emri dhe mbiemri i tij, është *kurrkushi*.

Shqipëria është xhuxhe *pa* subjektin lirik, metonimikisht *pa* Kosovën, ndërsa subjekti lirik ose Kosova *pa* Shqipërinë është *kurrkuashi*. Pjesëza *pa*, e përdorur në dy strofat e para ka një funksion kuptimor të veçantë. Ajo thekson heqjen, zbritjen, mbetjen, shkëputjen, mungesën e trupit të Shqipërisë. Me pjesëzën *pa* është ndërtuar edhe përftesa logjike e poezisë, në mënyrë që, duke theksuar mungesën të pohojë tërësinë. *Asnjëra* nuk ka fuqi, vlerë, rëndësi dhe bukuri *pa tjetrën*. Prandaj logjikisht *me njëra tjetrën* ato janë gjithçka.

Në strofën e katërt ligjërimi është pavetor, pra, më i përgjithshëm. Në të jepet përfundimi, finalja e mendimit. Shqipëria në këtë strofë është në një rrethanë tjetër, në atë të domosdoshmërisë së qenies:

*Shqipëri moj
Pikë uji
Në shuplakë të t'eturit*

Kështu, në mënyrë të shkallëzuar, nga *pamundësia e qenies*, në dy strofat e para, kalohet në *domosdoshmërinë e qenies*, në strofën përmbyllëse. Domosdoshmëria e qenies së *trupit dhe të shpirtit shqiptar* pohohet nëpërmjet kontrastit grotesk: *pikë uji/ i etur*

Shqipëria, natyrisht, ajo e vërteta është tepër e çmuar, është burim i jetës, siç është uji. Por nëpërmjet një litote metaforike është *pikë uji* përballë domosdoshmërisë së qenies, përballë etjes për të jetuar normalisht, etjes-dëshirë, etjes-ideal. I etur është idealisti që gjithmonë e ka dashur dhe e ka kërkuar Shqipërinë e vërtetë, por edhe gjithmonë i ka munguar, prandaj ka mbetur i etur. Ai ende nuk është nginjur me ujin Shqipëri, me idealin e ujit Shqipëri.

Poezitë e Ali Podrimjes, edhe pse, kryesisht, janë poezi të *pasojave*, në to shpesh janë edhe *shkaqet* e këtyre pasojave, në trajta metonimike dhe metaforiko-simbolike.

Në strofën e tretë, në një pyetje retorike shënohet metaforikisht *shkaku* përse Shqipëria është xhuxhe:

*Frymë e trup
Kush na i nami
Nën kupë të gastartë*

Pyetësi *kush*, në këtë pyetje retorike, nënkupton atë *dikush* që *na i nami* si trupin ashtu edhe shpirtin, frymën, vetëdijen. *Namja*, e dhënë në turqisht, është *mallkimi*, ndofta, që nga koha e Turqisë. *Namja*, *mallkimi* është metaforë e fatit të keq, të përcaktuar prej dikujt, por që është kaq i fuqishëm dhe i pashmangshëm, sikur të ketë rënë prej zotave të qiellit. Shqipëria *shuxhe* dhe subjekti lirik *kurkushi* janë pasojë e kësaj *name*, e këtij mallkimi që është shkaku. Shprehja përsëri është metonimike dhe metaforike. Duke kaluar nga rrafshi metonimiko-metaforik, në kuptimin e drejtëpërdrejtë historik dhe politik, nëpërmjet *pasojës konkrete*, që është *Shqipëria e zvogëluar dhe e shëmtuar*, mund të përcaktohet *shkaku konkret, që e gjymtoi Shqipërinë*.

Të tilla janë poezitë e Ali Podrimjes, sintetizuese dhe shumë-shtresore, që, në pak vargje, ndryjnë një histori a periudhë historike të qenies shqiptare, me rrethanat, shkaqet dhe pasojat.

Elegji dhe himn

Zhbërja e disa pjesëve të etnisë-atdhe, si Çamëria, dhe *tjetërsimi* apo *humbja e përkatësisë*, sikurse ka ndodhur me masën më të madhe të diasporës arbëreshe, është një tragjedi vajtimtare. Prandaj poezitë me këto motive janë përshpirtje dhe vaje.

Janina e sotme joshqiptare përngjason me *pyllin e prerë*. Por metafora e *pyllit të prerë* vetvetiu projekton *pyllin e harlisur të dikurshëm*, kur Janina me Ali Pashën ishte kryeqendra e Shqipërisë Jugore. *Pylli i harlisur*, që nuk shënohet por rindërtohet imagjnativisht, është shëmbëlltyra kryesore e kësaj metafore shumë-shtresore. *Pylli është jeta shqiptare e lulëzuar* në ato treva, është *landia* e tyre. *Prerja* e tij është *tragjedia*. Prandaj poezia *Requiem për pyllin e prerë* është *requiem*, është *përshpirtje* nderimi për të humburit e vdekur dhe përshpirtje qetësimi për të humburit e gjallë. Të gjitha poezitë për Çamërinë e zhbërë, të përmbledhura te cikli *Requiem për pyllin e prerë*, përbëjnë një requiem të

madh. *Pylli i prerë* metonimikisht është krejt Çamëria, sepse ajo është njëloj e rrafshuar, sikurse kryeqyteti i saj Janina. Dhe, po ashtu, requeim, përshpirtje dhe vaje janë edhe poezitë për Çamërinë, si tërësi metaforash metonimike për humbjet e pakthjera.

Karakteri tragjiko-vajtimtar i këtyre poezive, përveç lëndës, që është e vërteta historike, theksohet edhe me një varg figurash dhe shenjash karakteristike për vajet dhe përshpirtjet: *qyqja, korbi, qiparisi, vajtojcac, veshja e zezë e grave, varret, pasthirrmat*, etj. Në të vërtetë, këto të fundit, janë figura të ndërtuara me pasthirrma ose janë figura që kanë marrë edhe funksionin e pasthirrmave. Vetori *U* (unë), te *Guri i Prevezës*, që është në trajtën e vjetër, nga ana tingullore ka edhe funksionin e pasthirrmës së vajit, të gjëmës që ushton anembanë:

Oh ç'm'u këput litari te Guri i Prevezës

Joni ynë

Mjerë

U

Por vetori *U* (unë), natyrisht, ka edhe funksione të tjera, më të rëndësishme. Ai *përcakton* vendin e tragjedisë dhe të gjëmës, përcakton Çamërinë, pikërisht, aty ku u këput litari që e lidhte atë me trugun amë. Dhe e përcakton Çamërinë me anë të vetorit *U* (Unë), që përdoret edhe sot në të folmen e çamërishtes. Vetëvetori *U* (Unë), i shqiptuar në vajin e subjektit lirik, po ashtu, e *përgjithëson* tragjedinë e Çamërisë, e shndërron atë në tragjedi të mbarë kombit, meqë *U* (Unë) ka qenë trajta e lashtë e mbarë shqipes, në Jug e në Veri. *U* (Unë) edhe e *historizon*, i jep edhe ngjyresë lashtësie, si tragjedisë ashtu edhe vajit për të.

Nga ana tjetër, poezitë me motive të *zhbërjes* dhe të *tjetërsimit* janë edhe *burime burrërimi*, pasi zhbërja dhe tjetërsimi erdhën pas bëmave heroike dhe pas një lavdie historike, që kujtohet brez pas brezi. Kështu, përmes toneve vajtimtare, ndërfiten tone heroike dhe legjendare. Boçari, Bubulina, Xhavella, Mjauli janë *qiparisa* që kanë mbuluar krejt Morenë. *Pyll qiparisash* është vendi i arbërorëve në Greqi. Ky është *pyll* i shenjave të *vdekjeve të madhbërishme*, por dhe i një *pikëllimi*

të përjetsbëm, që është mbjellë përmbi dhé. Ky është një pyll i shenjave të një *landie të madhe*, por edhe *të humbur*, *plot dhembje e brengë*, pasi ka qenë lavdi për të tjerët. Ajo gjelbëron Morenë.

Këto poezi të një dhembjeje, brenge dhe pikëllimi të paparë në poezinë shqipe, janë edhe poezi të metaforave tepër përfshirëse e sintetizuese.

Thukëti e elipsës

Poezia e Ali Podrimjes është e thukët (koncize) dhe tepër e thukët jo vetëm se është metaforiko-simbolike, sikurse është pohuar, por edhe se është *eliptike*, mungesore. Në të gjithmonë *mungon* diçka: emra, folje, ndajfolje, përemra të llojeve të ndryshëm (vetorë, lidhorë, dëftorë, të pakufishëm), lidhëza, pjesëza, parafjalë, madje rrokje dhe tinguj fjalësh. Elipsa gjuhësore dhe stilistike është e dendur, gati, në çdo poezi, madje mund të jetë disa herë në të njëjtën poezi, pse jo disa herë edhe në të njëjtin varg. Ka elipsa që përjashtojnë njëherësh disa fjalë ose që një fjali-mendim e përmbledhin në një fjalë-figurë të vetme. Mungesa e një fjalë-figure ka raste që është mungesë (elipsë) e një dukurie universale të simbolizuar, prandaj vektori logjik i elipsës drejtohet kah kumtime të mëdha universale. *Kthebu në vargun e Homerit*, thuhet për kalin e Trojës, i cili kërcënoi njerëzimin edhe në shekullin XX. Kali i Trojës, mishërim i tradhtisë politike dhe i shkatërrimit prej dinakërisë demagogjike, përmendet vetëm diku, në titullin e ciklit, për t'u nënkuptuar larg, në një poezi me titullin *Kthebu në vargun e Homerit*. Vargjet me një ose me dy fjalë-figura, që mbartin një mendim të plotë e të rëndësishëm, nuk janë aq të rrallë: *Dashuria, fjalët; Parisi, vendlindja; Myshku, emri; Gjarpri, bukuria; Format origjinal; Formë ndërron, peisazh*.

Këto lloj vargësh shpesh kanë trajtë *aforistike*, ndërkohë që disa prej tyre në mjedise shkrimtarësh qarkullojnë si aforizma poetike. Karakteri i theksuar aforistik i kësaj poezie përftohet posaçërisht nëpërmjet elipsës.

Elipsa në këtë poezi nuk është thjesht gjuhësore, nuk është vetëm mungesë e një gjymtyre gjuhësore, por më tepër, është mungesë e një apo e disa gjymtyrëve të mendimit të shenjuar, të cilat

plotësohen imagjativisht, sikurse është edhe mungesë të dhënash, që nënkuptohen nëpërmjet të dhënave të paraqitura. Kjo elipsë, më tepër se figurë fjale, është figurë e mendimit, d.m.th. është *mungesë e mendimit të shkruar* ose *prani e madhe e mendimit të passhkruar*. Kështu, poezitë shpeshherë kanë trajtën e një përftese eliptike që bashkon skajet e elipsave të ndryshme, duke rrëzuar e hequr përbërësit e brendshëm, ndërmjetësues të tyre, të cilët pastaj nëpërlexohen. Dhe, në tërësi, këto *mungesa të mendimit të shkruar* ose *prani të mendimit të passhkruar* në sistemin e tyre përbëjnë përftesën eliptike të saj, sistemin e vazhdueshëm të elipsave që e ngre thukëtinë në shkallë të lartë.

Poezia e Ali Podrimjes, duke qenë një elipsë e madhe, pra, duke qenë një mungesë e madhe e mendimeve të shkruara apo një prani e madhe e mendimeve të pashenjuara mund të përfytyrohet edhe si një metaforë e madhe e mendimeve të panumërt të nënkuptuar ose të nëpërlexuar midis atyre që janë të shkruar. Mungesat e mendimit të shkruar janë të llojeve të ndryshme, por më e rëndësishmja është mungesa e rrethanave të shenjuara, të cilat nënkuptohen, madje ato janë pjesë përbërëse e kumtimit të poezive.

Elipsë e rrethanave

Poezia lirike, të paktën, sipas Gëtes, Hegelit dhe Elyarit është poezi e rrethanave. *Poezitë e mia*, ka thënë Gëte, *janë të gjitha poezi të rrethanave*. Madje ai e ngre në parim, kur thekson se *është e domosdoshme që poezitë të jenë gjithmonë poezi të rrethanave, d.m.th. që realiteti të japë si rastin, shkasin ashtu edhe lëndën e tyre*.¹⁾ Hegeli, megjithëse e ngushton ndërvarësinë e poezisë prej rrethanave, përsëri ato i shikon si shkak që *poeti të shprehë vetveten me gjendjen e tij shpirtërore*.³⁾ Ndërsa Elyari, duke e rimarrë idenë e Gëtes, një shekull e gjysëm më vonë, gati, postulon se *vepra është funksion i rrethanave të jetës së poetit*.⁴⁾

Pavarësisht nga ndryshimi që kanë mendimet e tyre për rolin e rrethanave në poezi, ndërvarësia e saj prej rrethanave mbetet e

^{2,3,4)} *Figures du sujet lirique*, PUF, 1996, faqe 51-52; 113; 51-52

pandryshueshme. Prandaj poezia, në një rën ose në tjetrën mënyrë, do t'i mbartë dhe do t'i shprehë ato.

Poezia e Ali Podrimjes është nga gjedhet e përkryera të asaj që quhet *poezi e rrethanave*. Kritika shqiptare këtej kufirit e ka pasur të vështirë interpretimin e kësaj poezie, sikurse edhe poezinë e Azem Shkrelit, Rrahman Dedajt, Sabri Hamitit, etj, pikërisht, sepse nuk i ka njohur aq apo nuk i ka pasur aq parasysh rrethanat që i kanë përfutur ato, sidomos nuk ka pasur parasysh rrethanat që ato mbartin në vetvete. Poeti është i vetëdijshëm për këtë, përderisa sqaron se *poezia ime është një pyll simbolesh, siç ka thënë një kritik, por aty shumë lehtë mund të hybet; mjafton të ndalesh dhe të shfletosh historinë e popullit*⁵⁾.

Leximi i simboleve poetike nëpërmjet përqasjes me historinë e popullit, siç këshillon poeti, nuk do të thotë vetëm se simbolet e tij janë të ngjashme me ato të historisë, por edhe se ato simbole e mbartin historinë, dmth mbartin rrethanat që e kanë karakterizuar dhe përcaktuar atë në periudha të ndryshme.

Në një poezi rrëfimore të drejtëpërdrejtë, retorike, rrethanat mund të paraqiten, ndërsa në këtë poezi metaforiko-simbolike, sidomos në atë pjesë të saj që është shkruar në vitet '60-'80 të censurimit serbomadhi, *rrethanat nuk paraqiten*, madje rrallë shenjohen. Për këtë arsye, poezia e Ali Podrimjes, në këtë kuptim, mund të quhet poezi e *rrethanave munguese* ose, ndryshe, mund të quhet poezi e *elipsës së rrethanave*. Mund të quhet poezi e *rrethanave munguese*, sepse rrethanat nuk paraqiten, nuk shenjohen.

Përftesa poetike *eliptike* e saj krijohet, kështu, nga mungesa e këtyre rrethanave që nuk paraqiten, nuk shenjohen, porse *nënkuptohen* ose *rikerijohen* metonimikisht, metaforikisht apo simbolikisht. Nënkuptimi dhe rikrijimi i këtyre rrethanave të munguara është pjesë e domosdoshme e leximit të kësaj poezie. Nëpërmjet këtyre rrethanave, *kobore* dhe *vendore*, metonimitë, metaforat dhe simbolet, etj., jo vetëm konkretizohen dhe qartësohen, por edhe "pasurohen" mjaft në lëndën e tyre. Vetëm në një tërësi me rrethanat e munguara, vetëm

⁵⁾ Revista *Universi shqiptar i librit*, 1999/ 1 (9), po aty.

nëpërmjet elipsës së rrethanave mund të receptohet shterueshëm kumtimi potencial i kësaj poezie.

Datat kur janë shkruar poezitë, që shpesh shënohen poshtë tyre, janë të dhëna e para që mbartin me vete, pikërisht, rrethanat që u mungojnë atyre shprehimisht. Vitet kur janë botuar librat janë të dhëna të tjera, edhe më të rëndësishme, që ndihmojnë në nënkuptimin ose në rikrijimin e këtyre rrethanave munguese. Motivet e poezive, mënyrat e shprehjes së tyre, si edhe figurat më të pëlqyera, gjithashtu, konkretizojnë rrethanat munguese, mjafton që poezitë, në kohën e leximit, të afrohen dhe të përquasen me rrethanat politike nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Madje poezitë mund të grupohen mbi bazën e rrethanave që mbartin në vetvete apo që projektojnë qark vetes, si edhe mbi bazën e rrethanave historike, kur ato janë shkruar.

Edhe ciklet e përmbledhjes së zgjedhur *Litari i ankthit*, në një masë të madhe janë shënuar sipas rrethanave munguese apo sipas elipsës së rrethanave.

Figurat shpeshherë shestohen mbi një kontekst historiko-shoqëror mungues, por që, në poezi ndihet tërësisht, pra, ato shestohen mbi rrethana politiko-shoqërore që *nuk paraqiten shprehimisht*, por *nënkuptohen* ose *rikerijohen* nëpërmjet leximit analitik. Poezitë e shestuara mbi elipsën e rrethanave, të cilat janë më të shumtat, përbëjnë, sipas mënyrës së shprehjes, sipas përftesës së tyre poetike, një lloj poezie të veçantë, *tepër eliptike*. Këto, natyrisht, edhe për shkak të elipsës së rrethanave, janë ndër më metaforiket, dhe, po ashtu, shquhen për thukëtinë e tyre. Poezia *Në nofulla të një kobe* është vështirë të lexohet pa pasur parasysh rrethanat mbi të cilat është shestuar, që, në të vërtetë, janë rrethanat politiko-shoqërore kur është shkruar. Vetë fjala *kobë*, që është në titull, parakupton *rrethana*. Prej atyre rrethanave shenjohet vetëm *dashuria*, kur subjekti lirik dhe bashkëjetuesi i tij *thoshin* se e donin njëri-tjetrin. Ajo ka qenë kohë e dashurisë, ato kanë qenë *rrethana dashurie*. Ndërsa prej dashurisë së asaj kohe dhe të atyre rrethanave shënjohen *pasojat e rënda: dhëmbët në lëkurën e subjektit lirik, beshjtja* që përtypin të dy, subjekti lirik dhe bashkëjetuesi i tij, dhe, *rreziku i gllabërimit* të tyre, pasi që të dy kanë përfunduar *në nofullat e një kobe*.

Këto pasoja *rikerijojnë si dashurinë* e tyre, ashtu edhe *rrethanat* e asaj dashurie. Ata që thoshin se e donin njëri-tjetrin nuk kanë qenë të dashuruar, por armiq prej së lashti, prej kohëve parake, pasi njëri është *bishë* dhe tjetri *pré* e saj. *Dhëmbët e mbetur në lëkurën e subjektit lirik*, natyrisht, nuk janë shenja dashurie, por urrëjtjeje, armiqësie, sulmimi. Ato janë pasojë e një *kafshimi shtazarak*, janë pasojë e *një dhune* parake aq të madhe saqë *dhëmbët e bishës* kanë mbetur në *lëkurën e fortë të presë*.

Në mes të asaj dashurie *një mot gjarpri krye qiti*. *Gjarpri* ka qenë përherë midis tyre, rrinte i struktur. Në një rrethanë tjetër, *një mot tjetër* ai nxorri kryet. *Gjarpri*, metonimikisht, përmes mjetit të tij – *helmit* vdekjeprurës, është *pabesia* dhe *vdekja* e sigurt prej pabesisë. Nga dashuria e fjalëve: *Kur më the se më do/ kur të thashë se të dua*, doli *dhuna parake* dhe *pabesia vdekjeprurëse*. Atëherë duket qartazi që dashuria e fjalëve fshihte *dhunën* dhe *pabesinë*, që në politikë quhet demagogji.

Një poezi e tillë metaforiko-alegorike, e shkruar në vitet '70, është shestuar mbi rrethanat politike që kanë përjetuar shqiptarët me të ashtuquajturin bashkim-vëllazërim i kombeve në ish Jugosllavi. Demagogjia e bashkim-vëllazërimit apo *dashuria e fjalëve* ishte mjegulla që fshihte *dhunën policore* dhe *propagandën kozmopolite tjetërsuese*. Në mes të kësaj dashurie fjalësh demagogjike, shqiptarët ishin preja më e pambrojtur, prandaj në lëkurën e tyre u ngulën fort si *dhëmbët e dhunës* ashtu edhe *helmi i gjarprit*. Konteksti historik, rrethanat historike konkretizohen prej titullit *Në nofulla të një kobe*, dhe sidomos prej përmbylljes së poezisë: *Në nofulla të një kobe/ beshtjen tani përtypim*. Vetë *koba*, metaforë animizuese e sistemit shoqëror të viteve '70 në Kosovë, është *bishë* gllabëruese e pamëshirshme. Në nofullat e kësaj *bishe sistem* nuk ka rënë vetëm subjekti lirik, por edhe bashkëjetuesi, armiku i tij. Të dy viktimat, meqënëse rrezikohen për t'u gllabëruar bashkërisht nga *nofullat e kobës*, janë duke përtypur *beshtjen* që metonimikisht nënkupton *urrëjtjen, armiqësinë e beshtur*. Urrëjtja e heshtur ka qenë karakteristikë kryesore e bashkëjetesës në vitet '60-'70 midis shqiptarëve dhe serbëve, pikërisht kur është shkruar poezia. Pra, si përfundim, ajo nuk ka qenë kohë dashurie dhe ato nuk kanë qenë rrethana dashurie. Përkundrazi, ajo ka qenë kohë e urrëjtjes dhe ato kanë qenë rrethana *të urrëjtjes, të dhunës dhe të mashtrimit*. Janë rrethanat e

asaj kohe dhe të atij sistemi shoqëror që konkretizojnë dhe qartësojnë plotësisht metaforikën dhe simbolikën e poezisë.

Rrethanat e metaforizuara

Në një lloj tjetër poezish, rrethanat paraqiten shprehimisht, veçse jo në trajta të drejtëpërdrejta. Në këtë lloj poezish, rrethanat metaforizohen, simbolizohen, dhe, herë-herë marrin trajta alegorike, prandaj përsëri duket sikur mungojnë.

Heshnja dhe *guri* jo rastësisht janë dy nga figurat më të përdorura në poezinë e Ali Podrimjes të viteve '70-'80, pasi janë përftuar në rrethanat politike të *heshjtjes së madhe* dhe të *qëndresës* dhe *kundërshtimit të madh të heshtur*.

Heshnja të *Poema e heshjtjes* është një *pasojë* që mund të kuptohet konkretisht vetëm në bashkëvajtje me *shkakun* e vet. E, meqënëse logjikisht nuk ka *pasojë* pa *shkak*, atëherë *heshnja* vetvetiu e përmban edhe *shkakun*, që është parësori dhe e përcakton *pasojën*.

Heshnja, që është *pasojë*, metonimikisht nënkupton patjetër edhe *shkakun* e vet, që është *censura*, *ndalimi i mendimit dhe i veprimit të lirë*. Kështu, metafora e *heshjtjes*, duke parakuptuar edhe *censurën*, edhe *ndalimin e mendimit dhe të veprimit të lirë*, është një shëmbëlltjërë e plotë e rrethanave politike në Kosovë në vitet '60-'70, kur ishte e pamundur shpallja haptas e mendimeve, dhe, aq më tepër ishte i pamundur kundërshtimi haptas i piramidës shtetërore sunduese. *Heshnja* është, gjithashtu, metaforë e mbijetesës shqiptare dhe e kundërshtimit masiv të heshtur, prandaj të *Poema e heshjtjes*, që përbëhet nga dhjetë poezi, ajo himnizohet dhe, gati, mitizohet. *Poema e heshjtjes* nuk është vetëm himnizim dhe mitizim i mbijetesës dhe i qëndresës që mori fytyrën e heshtjes, por metonimikisht, brenda kësaj metafore të madhe, është edhe himnizim e mitizim i kundërshtimit të censurës, i kundërshtimit të ndalimit të mendimit dhe veprimit të lirë.

Guri që metaforikisht është *qëndresë*, *mbijetesë*, *palëvizshmëri e pandrysbueshmëri*, *durim* dhe *mosfolje*, gjithsesi është *pasojë*, prandaj në krejt ciklin *Guri* nënkuptohet edhe *shkaku* i tij. Vetja-etni është shndërruar në *gur qëndresë* pikërisht për të përballuar rrethanat e trysnisë së madhe

të tjetërsimit dhe të rreziqeve të shumta të zhbërjes, të cilat metonimikisht janë *shkake i gurit qëndresë*. Prandaj metafora e *gurit-qëndresë* është gjysmake pa rrethanat e trysnisë së madhe të tjetërsimit dhe rreziqet e zhbërjes, të cilat nënkuptohen brenda kësaj metafore tjetër të madhe. Dyvargëshi për gurin: *askujt s'i falem/ sa forcës sate te poezia Pesha jote më tërheq kab toka*, në pamje të parë, duket estetizant dhe i kërkuar, madje formalist e i vrazhdë, ndërsa i kuptuar bashkë me *rrethanat-shkake* të trysnisë së madhe të tjetërsimit, që mbart metonimikisht në vetvete, dyvargëshi del bindshëm se është përfutur prej atdhetarizmit karakteristik shqiptar dhe prej vetëdijes poetike karakteristike shqiptare, që njëjtëson veten me etninë dhe me tiparet e relievit të atdheut.

Kur poetët sllavë i këndonin parajsës së tyre në ish-Jugosllavi, Ali Podrimja i këndonte gurit, *shkëmbinjtë* dhe *shkrepare shqiptare*, sepse atje e gjente vetveten dhe shëmbëllimin e vet. Prandaj subjekti lirik shpall me përgjërëm dhe krenari se *askujt nuk i falet*, veç gurit-vetvete, gurit-etni dhe qëndresë. Po kështu, të njëjtat rrethana të trysnisë së jashtëzakonshme nënkuptohen metonimikisht te simboli himnizues dhe mitizues *i kullës*, që është banesa-kështjellë e shqiptarit, sikurse nënkuptohen po metonimikisht ato rrethana trysnie te metafora e kultit të *fjalës*, që është njëherësh, *gjuha shqipe, letërsia shqipe, liria e krijimit* dhe e *shpirtit të lirë, përkatësia kombëtare*, etj.

Poezia *Loja e pakryer* është një metaforë e gjerë, me përmasat e tablosë, e rrethanave tepër armiqësore në të cilat mbijetonin shqiptarët në ish-Jugosllavi. *Loja e pakryer* është loja e fshehtë, është strategjia demagogjike për zhbërjen e shqiptarëve nëpërmjet zhdukjes, dëbimit, emigracionit, etj. Në këtë metaforë është edhe strategjia biologjike e shqiptarëve për shtimin (shumimin) e madh të popullsisë së tyre. *Loja* përcaktohet e *pakryer*, sepse shqiptarët ende nuk janë zhbërë dhe se strategjia serbe ende nuk është kryer plotësisht. Gjithashtu është e *pakryer*, sepse është *lojë* e brendshme, psikologjike dhe mendore midis kundërshtarëve. Vargu përmbyllës i poezisë: *Planeti bosh dhe kokat plot varre* nënvizon se kjo është lojë në vetëdije, në mendje e në shpirt, prandaj dhe poezia zhvillohet në formën e monologut të subjektit lirik ku dy vetat, *Unë* dhe *Ata* për çdo motiv përjashtojnë njëra-tjetrën. *Unë*

është subjekti lirik në njëjës që nënkupton *pakië*, ndërsa *Ata* janë kundërshtarët në shumës, që nënkupton *shumicë*.

Loja e pakryer metaforikisht është *lufta e pakryer*. Nuk është vetëm fjala *lojë* që shpie tek *lufta*, por edhe fjalët: *pushkë, vras, varros, varre, humbës, triumfues* janë shenjat simbolizuese të luftës. Poezia e shkruar në fillim të viteve '70 është metaforë e thukët e atij skajimi psikologjik dhe e asaj armiqësie të brendshme që parashënonte luftën e vërtetë shqiptaro-serbe, prandaj në kuptimin e mendimit, ajo ka qenë profetike.

Ndërsa poezitë e përfshira nën titullin *Natë as ditë s'tregon ora* mbartin rrethana krejt të tjera. Ata mbartin rrethanat e armiqësisë dhe të ndeshjes së hapur. Poezitë e këtij cikli, po të parafrazonim metaforën e poetit, përbëjnë *Lojën e kryer*, kur armiqësia është shpalosur tërësisht, madje edhe në trajtën më të egër, në trajtën e luftës. Varret, që, sipas asaj poezie të viteve '70, ishin *në kokat e njerëzve*, sipas poezive të viteve '80-'90, janë varre të njëmendëta, që u hapën anembanë Kosovës.

Rrethanat e vartësisë dhe të kushtëzimit të jetës prej *dikujt* të *Maca e zezë* kanë trajtë alegorike. Macja e zezë, kur të del përpara në rrugë, sipas mendësisë popullore, është shenjë e keqe. Ajo parathotë keqvajtjen e punëve. Subjektit lirik, macja e zezë jo vetëm i ka dalë në rrugë, por edhe e ndjek atë pas në udhëtimin e tij të jetës, duke i paracaktuar keq gjithçka: *Orën e fatit ajo dikton*. Subjekti lirik, që metonimikisht shpreh edhe bashkësinë e vet të shqiptarëve, e përjeton shfaqjen e *Maces së zezë* si mishërim të mohimit, të ndalimit dhe të shkeljes së të drejtave të tij jetike, sikurse janë simbolikisht: *kënga, drita e syve, udhëtimi i lirë dhe ëndrra*. Ajo është përcaktuese e fatit të tij të keq, ajo i ka në dorë fijet e fatit të tij.

Këto rrethana të metaforizuara, të simbolizuara apo edhe në trajta alegorike, që duket se mungojnë, por që, në të vërtetë, në poezinë e Ali Podrimjes shpeshherë janë të pranishme, përbëjnë një përmasë të veçantë e tepër të thukët të kumtimit të saj.

Një trajtë shqiptare e modernitetit

Në letërsinë shqipe janë të paktë poetët që kanë krijuar një poezi moderne në kuptimin evropiano-perëndimor. Poezia e Ali Podrimjes është një prej tyre. Ajo është moderne jo vetëm në tërësinë e poezisë shqipe, por edhe në atë evropiano-perëndimore, pasi ka një varg tiparësh të atij moderniteti që zuri fill në mesin e shekullit XIX me Bodlerin, u formësua me Rembonë e Malarmen, dhe mbizotëroi në poezinë evropiane të shekullit XX me Apolinerin, Quazimodon, T.S. Eliotin, G. Traklin, Lorkën, Ungaretin, J. Gillenin, Valerium, etj. Dhe ajo është moderne, d.m.th. e afërt dhe e ngjashme me poezinë evropërendimore jo aq në botëvështrimin dhe botëpërjetimin e saj, në lëndën dhe në mendimin e saj, sesa në konceptet dhe konceptimet poetike, në disa konvencione dhe në funksionet e tyre, në shprehjen poetike, veçanërisht në rregullat e vjershërimit.

Poezia e Ali Podrimjes është moderne, sepse është, në radhë të parë, metaforike, simbolike dhe eliptike. Gjuha e saj, sikurse gjuha e poezisë moderne evropërendimore, ka një funksion paradoksal⁶: ta shprehë mendimin dhe, njëherësh, ta fshehë atë, madje, herë-herë dhe me një lloj errësimi, por që nuk arrin në hermetizëm. Në të mbizotëron vargu i lirë, më shpesh pa shenja pikësimi dhe pa shkronja të mëdha për të detyruar një lexim logjik tepër të vëmendshëm, pasi, paramendohet që ato t'i vendosë vetë lexuesi.

Vargu i tij ka thyerje të jashtme, d.m.th. grafike dhe thyerje të brendshme, d.m.th. të mendimit. Thyerjet e brendshme e bëjnë atë ndryshe nga vargu tradicional që ka një sintaksë të rregullt. Ato krijojnë mospërputhje midis mendimit, sintaksës së vargut dhe paraqitjes së tij grafike që përbën edhe sintaksën e çrregulluar të poezisë moderne. Gjysma e vargut të dytë, p.sh., grafikisht kalon në vargun e parë, dhe, po ashtu, gjysma a një pjesë e vargut të tretë kalon në vargun e dytë, dhe, kështu, radhazi, duke krijuar një vijimësi mendimi të pandërprerë, pra, një lumë mendimi. Këto gjysma apo

⁶ Hugo Friedrich *Structure de la poésie moderne*, Librairie Générale Française, 1999, faqe 255

copa vargësh që, grafikisht ndahen, por që logjikisht janë një, janë dykuptimshme meqënëse kuptimisht lidhen si me vargun paraprijës ashtu dhe me vargun pasues. Dykuptimësia e tyre rrit ndjeshëm dëndurinë e mendimit.

Stili është i larmishëm. Ai kalon prej stilit nominal në stilin verbal. Më i theksuar është *stili verbal* në të cilin përdoren shumë folje, si, p. sh., te *Loja e pakryer*, *Liria ime është e tmerrshme*, etj. Stili verbal shpreh një lëvizje të madhe të mendimit në kohë, duke i dhënë atij shtrirje të gjerë. Por ka edhe poezi me pak folje, madje edhe pa asnjë folje, bie fjala, *Xhirimi i një filmi sekret*, *Kur të prajnë* ose *Pa folje*. *Stili nominal* i këtyre poezive, në të cilat zotërojnë emrat, mbiemrat, etj., i jep thellësi mendimit.

Në këto poezi nuk mungojnë një sërë figurash karakteristike të poezisë moderne evropërendimore, sikurse janë: *ëndrra*, *ylli*, *fryma*, *shpirti*, *dritarja*, *qielli*, *pasqyra*, *errësira*, *varri*, *kaltria*, *bummera*, *rrenja*, *etja*, *uria*, *uji*, *dashuria*, *shkretëtira*, *zbrazhtësia*, etj., por, me disa pak përjashtime në truallin shqiptar ato kanë marrë, përgjithësisht, kuptime të tjera. Vetëm *ylli*, simbol i idealitetit, *dritarja* dhe *pasqyra*, simbole të vështrimit dhe disa të tjerë ruajnë edhe në këtë poezi kuptimin evropërendimor.

Kjo poezi është e afërt apo dhe e ngjashme me poezinë evropërendimore moderne edhe në disa motive, bie fjala, *vetmia*, *ankthi*, etj., veçse *të kuptuara dhe të përjetuara ndryshe*, sipas botëvështrimit dhe botëpërjetimit shqiptar.

*Vetmia*⁷⁾ në poezinë moderne evropërendimore është gjendje e brendshme e individit apo dhe e vetë poetit që nuk gjen asnjë lidhje me shoqërinë dhe me mjedisin, pasi ndihet i shkëputur dhe i huaj. Edhe *ankthi*⁸⁾ i saj është ankthi i individit dhe i vetë poetit që nuk sheh derë shpëtimi, përkundrazi, qenia e tij shkatërrohet përballë idealitetit fort të dëshiruar, i cili shkon në zbrazhtësi.

Kurse në poezinë e Ali Podrimjes *vetmia* dhe *ankthi*, si edhe të gjitha gjendjet e tjera të ngjashme me të poezisë evropërendimore, nuk janë thjesht gjendje të individit dhe më pak vetëm të poetit. Ato janë

7, 8) Hugo Friedrich *Structure de la poésie moderne*, Librairie Générale Française, 1999, faqe 251; faqe 47

gjendje të kombit shqiptar ose shumë herë janë posaçërisht gjendje të bashkësisë së shqiptarëve të Kosovës. E, natyrisht, këto janë edhe gjendje të individit dhe të vetë poetit si pjesëtar tepër i ndjeshëm i kësaj bashkësie. Si të tilla, këto gjendje karakteristike janë tepër të *sboqërizuara* dhe të *kombëtarizuara*.

Ankthi është tepër i përgjithësuar. Ai është ose gjendje psikologjike e kombit shqiptar ose është gjendje e mbarë njerëzimit. Te poezia *Litari i ankthit* (shkruar në vitin 2000) është dukuri kombëtare. Është gjendja mjaft e shqetësuar e shqiptarëve që me padurim dhe me pasiguri presin të nesërmen e lirë në Kosovës:

E lirë Kosova dhe e pavarur
Me një litar rreth qafe
Kërkon degën më të lartë
E s' e lëshon as e mban një litar

Litari, që është simbol i vartësisë tragjike të kombit shqiptar prej të tjerëve, qysh kur atë e copëtuan, njësohet me dënimin e tij më të rëndë, me varjen. Prandaj dhe ky është *ankthi* i kërcënimit të një kombi me vartësi ose me varje në litar. Ankthi i tij është i hershëm, por sot ka arritur kulmin. Te poezia *Pa falje* (shkruar në vitet '70) është *po ky litar rreth kokës* së subjektit lirik, që pret ta varin. Ndërsa te *Tatëpjetë gologotës* (shkruar në vitin 1998) subjekti *lirik luhetat në litar*, pra, është i varur prej kohësh, pasi e *dënuan njerëz të gabuar*.

Ankthi për qenien e rrezikuar, si karakteristike e jetës së kombit shqiptar cilësohet haptas te *Evropa përmes grilave*:

Në dhomën akustike hyn Evropa përmes grilave
dhe më del ëndrra
pëshpëris vitet: 1878, 1913, 1924, 1945

ja erdhi edhe viti 1992
kongreset e anktheve e pabesive
Po unë ende marr frymë

Ankthi i shqiptarëve në të gjitha këto poezi shkaktohet prej ngjarjeve politike ndërkombëtare dhe pikërisht prej *kongreseve të pabesive*, duke shenjuar me to mbledhjet diplomatike të Fuqive që copëtuan Shqipërinë dhe vazhdojnë ta ruajnë atë copëtim, duke krijuar ankthin e përhershëm të shqiptarët.

Te *Shoferët e vdekjes* në ankth është tërë bota. Ankthi i saj është pasojë e shkaqeve të mëdha politike dhe shoqërore, është pasojë e rrezikimit të njerëzimit prej teheve vezulluese të luftës. Shoferët e vdekjes përngjajnë me politikanët e Luftës së Ftohtë të shekullit XX, sidomos me krerët e vendeve ish-komuniste që nuk i ndjenin çarjet që po mbytnin anijet e tyre. Prandaj këta drejtues shoferë, këta politikanë shoferë, që e shpien botën drejt rrëzimit dhe luftës, janë shoferë të vdekjes, siç paralajmëroi poeti që më 1978.

Edhe *vetmia* nuk është vetmia e brendshme e individit që s'gjen lidhjet me shoqërinë, siç është në poezinë evropërendimore, por është vetmia e kombit shqiptar. Te poezia *Pa folje* është largimi dhe mospërfillja e botës ndaj tragjedisë shqiptare që luhet në Kosovë:

*dhe prapë vetëm
nën këtë qiell
mbi këtë planet t'zgjebosur
po ky litar
rreth kokës*

Edhe pse të braktisur në tragjedinë e tyre, shqiptarët mbahen *rreth flakës*, metonimikisht rreth vatrës, shtëpisë, vendlindjes, atdheut. Ata mbahen me veten e tyre dhe me shpresën e tyre.

Kështu, dukuritë, gjendjet dhe rrethanat që në poezinë evropërendimore karakterizojnë njeriun apo shoqërinë, në poezinë e Ali Podrimjes janë shndërruar vetiu, nëpërmjet botëvështrimit dhe botëpërjetimit të tij, në dukuri, gjendje dhe rrethana të qenies së bashkësisë së shqiptarëve. Prandaj ngjashmëria e kësaj poezie me poezinë evropërendimore nuk është aq në lëndë dhe në mendim se sa në konceptimet, figurshmërinë dhe vjershërimin e saj.

Gjuha-ideal dhe vetmohim

Ali Podrimja, edhe pse përditë flet gegërisht, madje një gjakovarishte të thellë, poezinë, përgjithësisht, e ka shkruar me kujdes e përpikmëri në shqipen e njësuar letrare. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe. Ai që e ka kërkuar gjithandej etninë e bashkuar, që e ka rikrijuar dhe plotësuar atë edhe atje ku shekujt e kanë cunuar e copëtuar shqipen letrare, si nyjen kyçe të njësimit të vet shqiptarëve, e ka më parë ideal dhe qëllim, pastaj mjet të shprehjes poetike. Si çdo ideal madhor, edhe ideali i njësimit të shqiptarëve e ka çmimin e vet të vetmohimit. Ky është një vetmohim gjuhësor, psikologjik, shpirtëror dhe krijues letrar, që shkrimtarit të vetëdijshëm i jep kënaqësinë e pazëvendësueshme të arritjes së idealit. Gjuha letrare e njësuar kudo është arritur përmes vetmohimit të atyre pjesëve të kombit që u bie të përshtaten më shumë me gjuhën e njësuar. Dhe ato pjesë të kombit nuk i janë shmangur dhe as i janë frikësuar një vetmohimi të tillë kur kanë qenë të vetëdijshme se frytet e tij janë më të rëndësishme se vetmohimi i tyre.

Shkrimtarët shqiptarë, si në të gjitha kombet e qytetëruara, i kanë prirë këtij procesi vetmohues që është sublimuar në vlera të mëdha morale e kulturore, të gdhendura në altarin e mirënjohjes atdhetare, ndërkohë që, vetmohimi i shkrimtarëve është sublimuar edhe në vlera letrare gjithëkombëtare. Megjithatë, poezia e Ali Podrimjes, sikurse krejt letërsia e shkruar në Kosovë dhe në troje të tjera shqiptare jashtë shtetit amë, ka edhe një varg fjalësh dialektore dhe motërzime dialektore të fjalëve, të cilat nuk janë përdorur pavetëdijshëm, por me vlera stilistike të veçanta. Fjalët dialektore dhe motërzimet dialektore të fjalëve, duke shenjuar posaçërisht mjedisin e krijimit, Kosovën, e drejtojnë leximin e poezisë kah kuptimi i saktë dhe konkret i tërë atyre rrethanave, gjendjeve, përjetimeve që janë ndryrë në të. Nga ana tjetër, fjalët dialektore dhe motërzimet dialektore, duke njëjtësuar prejardhjen vendore të poetit, lehtësojnë zbulimin e atyre "fshehtësive" të figurave që lidhen me subjektin lirik ose me vetë poetin. Po ashtu, ato, përderisa shënojnë mjedisin e krijimit dhe nënkuptojnë edhe rrethanat e krijimit, përftojnë edhe

ngjyresa emocionale të veçanta. Te lexuesi i atyre anëve ato përftojnë një afri shpirtërore më të madhe, ndërsa te lexuesi i anëve të tjera përftojnë kënaqësinë e përjetimit të të dëshiruarës, të largtës dhe të panjohurës. Por në këtë botim nuk janë ruajtur të gjitha motërzimet e fjalëve dialektore, sikurse janë në botimet e Prishtinës. Disa pak prej tyre janë zëvendësuar, vetkuptohet, me pëlqimin e autorit, me motërzimin e përgjithësuar letrar. Janë qortuar disa pak motërzime dialektore të fjalëve me kuptime abstrakte, që vijnë prej fushës së mendimit filozofik ose ligjërit libror, por që gjatë përdorimit janë përshtatur në trajtat dialektore pëkatëse, bie fjala, Satani për Satana. Madje, disa motërzime të tilla fjalësh që janë qortuar, edhe në botimet e Prishtinës hasen në dy trajta, ta zemë, *hapsi* dhe *hapësirë*. Kuptohet që është ruajtur trajta e përgjithësuar *hapësirë*. Por, për arsye stilistike, nuk janë prekur motërzime të tilla dialektore si *maca*, *fqiu*, *engjuj*, etj.

Shqipja letrare e njësuar në veprën e Ali Podrimjes, sikurse edhe në veprën e autorëve të tjerë të Kosovës, është shumë e rëndësishme, sepse është nga përbërësit kryesorë të lëndës së saj kombëtare. Shqipja letrare e njësuar ndoshta nuk është më pak e rëndësishme se vlerat e saj poetike, pasi vetë ajo është një vlerë poetike e madhe meqënëse afron rreth vetes dhe ndikon mbi të gjithë shqiptarët si me gjedhen poetike kombëtare, ashtu dhe me gjedhen gjuhësore të njësuar, që i përket nivelit më të lartë kulturor e qytetërues të shqiptarëve.

BASHKIM KUÇUKU

PËRMBAJTJA

LITARI I ANKTHIT	7
Maca e zezë	9
ME PERËNDI TË FLAS.....	10
A do të ketë kohë.....	10
Kur do të flasësh o Ali Podrimja	11
Ç'po ndodh me mua	14
Kur rrjedh	15
Pa folje	16
Gri	17
Nuk e pranoj se kam jetuar.....	18
KUSHEDI PREJ KAH.....	19
Dëftore	19
ASKUJT S'I FALEM SA FORCËS SATE	24
I. Guri	24
1. (Pesha jote më tërheq kah toka)	24
2. (Të jesh ti).....	25
3. (Assesi të mësoj fshehtësinë)	26

II. Guri.....	28
1. (Pres me ditë tres përditë)	28
2. (Ç'guron guri).....	29
3. (Nga ëndrrat nga ujërat hapësirën ta ruaj)	30
4. (Merreni këtë gur).....	31
III. Guri.....	32
1. (E guri im rrokulliset.....	32
Koha e gurit.....	33
Teksti ynë.....	34
Mbreti im i vdekur Dioklecian.....	35
Me një rrënjë guri.....	36
A do ta shoh Shkodrën	37
Kënga e ngrysur	38
Vdekja e kullave	39
Droja.....	40
Shqiptarët.....	41
Pa titull	42
Dritarja e hapur.....	43
Dita që ma kujton vdekjen	44
Livadhi.....	46
Pazari i vdekur.....	47
 UDHA E PANJOHUR MË ÇON.....	48
Kulla.....	48
1. (Hap derën mbyll peizazhin).....	48
2. (Hija ime shëtit pa mua)	49
3. (Po guri im ç'ka)	50
 GJUHA E NJERIUT TË GOZHDUAR NË SHKËMB.....	51
Poema e heshtjes.....	51
(Emra ka harruar)	51
(Në nofulla të një kohe).....	52
(Metafora e jetës sime)	53
(Eci rrugës sime ajo më ndjek pas).....	54
(Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë)	55

(Si e harruam njerinë në fushë të bardhë)	56
(Shi në një legjendë)	57
(Shtat lëshon një lulkuq)	58
(Një ditë)	59
(Pas rënies pas ngjadhënjimit).....	60
LOJA E PAKRYER	61
Emrat tanë.....	61
Baladë për dhëmbin e ujkut.....	62
Loja e pakryer	64
A gjuhen pëllumbat.....	65
Unë do të kisha atdhe.....	67
Njerëzit e akullt	68
Dumvenio	70
Si të këndojmë kur gjithçka liruam	71
Të kam pasë thënë një ditë	72
Katrori magjik.....	73
Molla e kuqe.....	74
Fajtor është shqiptari	75
A nuhatet vdekja	76
Udhëtim me ujq.....	78
Ode Anteu.....	79
Monstrumi.....	81
Minjtë.....	83
Loja me vdekjen	85
Uji i madh vjen	86
Magjia e Kosovës	87
Mos është njeriu	88
Unë jam egërsirë.....	89
NATË AS DITË S'TREGON ORA	91
Relike të fundshekullit.....	91
Kjo ka ndodhur para Krishtit.....	92
Kur të prajnë.....	93
Promovimi i Satanit	94

Xhirimi i një filmi sekret	96
Në mesnatë	99
Një i vdekur i zakonshëm	100
Drithmë	101
Klithje në shkretëtirë	102
Fundi i lojës.....	103
Një ditë tepër shumë	104
Përditshmëria ime	105
Liria është e tmerrshme.....	106
Ato nuk janë varre	107
Poezinë që nuk do ta kryej kurrë	108
Lament për lirinë e njeriut	109
Frika I	110
Frika II.....	111
Eklipsi.....	112
Djaloshi në këmishë të Gostivarit	113
Shikimi nga dritarja	116
Drenica	117
Reçaku	119
Marshi	120
Frikë e Mall	121
Do të ik me zhig pa e parë një film	123
Në mbretërinë e hazardëve	125
Shkëlqimi verbues	126
REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË	127
Te guri i Prevezës.....	127
Ura e Artës	129
Boçarët.....	130
Rekuiem për pyllin e prerë.....	132
Fluturim i përgjakur	133
Vajtojcat e Rekës	134
Fusha e Atikës	135
Kthimi në Antikë	136
Moreja.....	137
Dinozaurët	138

DRITARE E VETMUAR DHE E HAPUR PËRHERË	139
A ju dëgjon harrimi.....	139
Arbëreshi dhe deti.....	140
Te De Rada në Maki.....	141
Zefi ynë.....	143
Idilë	144
Fshatrat arbëreshe.....	145
Valle arbëreshe	146
Kush do ta vrasë ujkun	147
Hora e Arbëreshëve.....	148
Duke lexuar pikëllimin e Hana D.	149
ÇELËSI NË PERLAT E TUA.....	150
Si e kemi zbuluar detin	150
Itaka.....	152
Ishulli	153
A ju kujtohet.....	154
E nata i ka mbuluar gjurmët dhe klithjet	158
Rozafati.....	160
Ndjenja	161
Kruja	162
Skënderbeu.....	163
Hapja e një poezie në kohë trishtimi.....	164
Ujkani.....	165
Atdheu, dhembje.....	166
Beteja e Kosovës	167
Nëse	168
Rrënimi i përmendores së turpit.....	169
Fotografia jonë, etnia.....	170
Revolta e rokerit të dheut të shqipeve	171
Kulla e Balshajve.....	174
Në majë të Tomorrit.....	175
Atdheu i mbërthyer në arkë.....	176
Përmendorja e viçit.....	178
Troku mortar	180

Beteja e askujt	181
Aletë e Korçës	182
Korbi.....	184
Tatëpjetë Golgotës.....	185
Shtëpia pa zot	186
Kur u zgjuam	187
Ishulli Albania.....	188
Varri nën ullinj.....	189
Me qenë	191
Vdekjes ia luaj syrin	192
Pasqyra e thyer.....	195
Rektimë.....	197
Robi i Zotit	198
Krijesë e verdhë.....	199
Ishuj të vegjël ëndrrash	200
Vdekja e njeriut apo e ullirit	201
Evropa përmes grilave.....	202
Do të shaloj atin, vdekjen	204
Gjumë të mirë e dashur.....	205
SHPIRTIN E HUMBUR KËRKOJ	206
Një dru digjet në fushë të shurdhët.....	206
Do t'i them të njëjtat fjalë	208
Një fyell e një yll në një pyll.....	210
Gjarpri, bukuria	211
Nënat	212
Bukuria.....	213
Dashuria e humbur	214
E panjohura	215
Përflakja e trupave.....	216
Ëndërrimtarët	217
Zoti nuk është mace	218
Gazela	219
Gruaja	220
Shpirti i humbur	221

Fjalë për dashurinë.....	222
Universi i pikës	223
Dhembja.....	224
Format, origjina.....	225
Dashuria, fjalët.....	226
Zoti i lakuriqar.....	227
DUKE NDJEKUR ENGJËLLIN E ZI.....	228
Nuk kam bërë kurrgjë për Lumin.....	228
Kërkon atë që nuk mund ta gjej.....	234
Ekzistenca	235
Derisa s'e ka zënë nata	237
Me jetue	238
Në dhomën e vdekjes	241
Vishkull.....	242
Parisi, vendlindja	243
Nën dritare digjej Parisi.....	245
Të duan Lumi	250
Të shkosh në Bejrut.....	251
Vdekja ishte më e shpejtë se unë	252
Fletë e bardhë	253
E ti i vdekur	254
Pikëllimë	255
Unë nuk jam ai	256
Fillikat vetëm	257
Fragment	258
Myshku, emri	259
E klith në ëndërr	260
NJERIU ME PLAGË NË KOKË.....	261
Uji i madh.....	261
Dalje nga rrethi.....	262
Harrimi	263
Zari.....	264
Shenja.....	265

Vetmia.....	266
Shoferët e vdekjes	267
Vapa	268
Flaka e vjedhur	269
Vdekja.....	270
Dallimi	271
Hija ime	272
Hapësira.....	273
Njeriu me plagë në kokë	274
Fëmija vdes në bodrum.....	276
VETËM PARA VETES.....	277
Mora udhën të takoj një njeri	277
Për dashuri të reja jeta është tepër e vjetër.....	278
Në mbarim të shekullit.....	279
Torzo	280
Baladë për një qen.....	281
Ndjesë.....	282
Nga “Cungu”.....	283
Rënia s’është humbje.....	284
Midis xhunglës së betonit	285
Në teatrin e ri.....	286
Nga “Kali i Trojës”.....	287
Vetëm ose Hamlet i sëmurë	288
HIJA E TOKËS	290
Epika.....	290
1. (Unë biri yt)	291
2. (Shtëpia pa qetësi).....	292
3. (Hija e tokës)	293
4. (Përtej dhembjes).....	295
5. (Ardhësi)	296
6. (Rrëfimi).....	297
7. (Një natë nga netët pa gjumë).....	298
8. (Kah rridhte gjaku)	300

9. (Varre lanë pas).....	301
10. (Dua të jem)	302
KURRKUSHI JAM PA TY.....	303
Litari i ankthit	303
Etyd për Shqipërinë	304
Shqipëria nuk është fjalë goje.....	305
Koha mos është me shkue engjëlli im.....	306
Shqipëritë.....	308
Në kohë kaosi.....	309
Guaska	310
SHPREHJA MODERNE E ETNISË	311

ALI PODRIMJA

VEPRA

Vëllimi i gjashtë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqosja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 21.87 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 6 : Litari i ankthit : poezi e zgjedhur / Përgatitur nga Bashkim Kuçuku. - 350 f., portreti i autorit

Shprehja e moderne e etnisë : f. 311-340

1. Kuçuku, Bashkim

ISBN 978-9951-615-14-3

ISBN 978-9951-615-20-4